

1 E hënë, 6 dhjetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari Haradinaj u paraqit përmes  
4 videolidhjes]

5 [I akuzuari Gucati hyri në sallën e gjyqit]

6 --- Seanca fillon në orën 09.30

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

8 Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur të gjithëve.

9 Zonja Sekretare, ju lutem thërrisni çështjen.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i  
12 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Prokuror,  
14 ju lutem a mund të prezantoni anëtarët e ekipit tuaj.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.  
16 Në emër të ZPS-së janë të pranishëm Alex Whiting,  
17 Zëvendësprokuror; zoti James Pace, Prokuror i Asociuar; zoti  
18 Matthew Halling, Prokuror i Asociuar; zonja Line Pedersen, që  
19 është Menaxhere e Çështjes dhe e Provave; dhe unë jam Valeria  
20 Bolici, Prokurore.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

22 Faleminderit, zonja Prokurore.

23 Zoti Rees.

24 Z. REES: [Përkthim] Unë jam Jonathan Rees dhe së bashku  
25 me mua është dhe bashkëmbrojtësi zoti Huw Bowden, Eleanor

1 Stephenson është gjithashtu me mua. Dhe të pranishëm kemi edhe  
2 zotin Gucati.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
4 Faleminderit.

5 Z. WORBOYS: [Përkthim] Përshëndetje, të nderuar Gjykatës.  
6 Ne jemi të pranishëm sot së bashku me zonjën Miriam Boxberg,  
7 zonja Chelsea Qu. Në ekran kemi gjithashtu edhe zotin Cadman,  
8 zotin Buckley dhe zotin Berisha.

9 Dëshiroj të them që zoti Cadman dëshiron që t'ju  
10 drejtohet të gjithëve sa i takon aspekteve shëndetësore të  
11 ekipit tonë. Dhe me lejen tuaj, do t'i jap fjalën zotit Cadman  
12 për të bërë këtë parashtrim, por përndryshe jam në dispozicion  
13 të Gjykatës për t'ju ndihmuar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të  
15 vazhdoni, zoti Cadman.

16 Ju lutem ndizni mikrofonin, zoti Cadman.

17 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Përshëndetje.  
18 Uroj që të më dëgjoni të gjithë, sepse e kam pak zërin jo të  
19 stabilizuar sot në mëngjes.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju  
21 dëgjojmë goxha mirë.

22 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Siç e tha  
23 zoti Worboys në prezantimin e vet, sepse unë po ju ndjek në  
24 distancë, sepse fatkeqësisht jam testuar pozitiv nga COVID-19  
25 dhe kam filluar të kem simptoma goxha të rënda që prej kësaj

1 kohe, që prej seancës së të premtës.

2 Pra, kam probleme sa i takon marrjes frymë, kam ndonjë  
3 herë ethe, kam mungesë energjie dhe kam mungesë aftësie për  
4 t'u përqendruar. Dhe më tej, në bazë të komunikimit me email  
5 dhe njoftimeve që kemi marrë në fundjavë, unë dua formalisht  
6 që të kërkoj që të shtyhen procedurat aktuale në bazë të  
7 përkohshme, derisa të kem mundësi të marr udhëzime nga zoti  
8 Haradinaj.

9 Siç e dini, edhe zoti Haradinaj është në karantinë. Nuk  
10 kam pasur mundësi që të flasë me zotin Haradinaj gjatë  
11 fundjavës. Kam kërkuar që të paktën të flasë me të në telefon,  
12 në mënyrë që të mund ta informojë për gjendjen time aktuale  
13 shëndetësore.

14 Situata është agravuar më tepër nga fakti që zoti  
15 Buckley, i cili është më Mbretërinë e Bashkuar, vajza e tij ka  
16 testuar pozitiv për COVID-19 dhe ai nuk lejohet që të  
17 udhëtojë për dhjetë ditë. Bashkëshortja e tij po ashtu po  
18 tregon simptoma, kështu që edhe mund të ndodhë që edhe zoti  
19 Buckley, në vetvete, të mund të shfaqë simptoma me kalimin e  
20 kohës. Kështu që ne mendojmë që zoti Buckley nuk do të ketë  
21 mundësinë që të jetë i pranishëm në Gjykatë.

22 Kjo, në vetvete, tregon goxha vështirësi për ne.  
23 Ndërkohë, siç mund ta shikoni, zoti Gjykatës, kemi anëtarë të  
24 tjerë të ekipit të cilët po ndjekin procedurat në distancë por  
25 nga hoteli. Pavarësisht që nuk kanë shfaqur simptoma deri

1 tani, për shkak të periudhës së inkubimit për disa ditë, për  
2 katër ditë, mendoj që është në interes të të gjithëve që të  
3 mos sjellim ndonjë rrezik në Gjykatë dhe duhet të presim deri  
4 në ditën e katërt përpara sesa të bëjnë testin për COVID-19  
5 për të parë në qoftë se ata janë pozitiv apo jo.

6 Të nderuar Gjykatës, ka pesë arsye të thjeshta, të cilat  
7 do t'i kaloj sa më shpejtë të jetë e mundur.

8 Në këtë fazë, unë po kërkoj thjesht një shtyrje të  
9 përkohshme në mënyrë që të mund të kontaktoj me zotin  
10 Haradinaj dhe në mënyrë që të marrë udhëzime të plota nga zoti  
11 Haradinaj në qoftë se ai dëshiron që ne të vijojmë apo në  
12 qoftë se është pro shtyrjes. Pra, kjo është një situatë e  
13 paparashikuar dhe është rrethanë përjashtimore. Së pari, dua  
14 të them që zoti Haradinaj nuk është i pranishëm, ka qenë e  
15 pamundur që të kontaktoj me zoti Haradinaj. Dhe ndërkohë, edhe  
16 në qoftë se zoti Haradinaj do të jetë në gjykatë nesër,  
17 përkthyesi ynë dhe hetuesi nuk është në gjendje që të jetë në  
18 Gjykatë nesër për shkak të kohës që duhet të presë për testin  
19 PCR.

20 Dhe nuk ka qenë e mundur për mua që të kontaktoj me zotin  
21 Haradinaj dhe kjo është një gjë thelbësore, e cila është shumë  
22 me rëndësi për neve. Pra, siç e thashë, ekipi ynë, siç mund ta  
23 shikoni dhe vetë, është i kufizuar sa i takon pranisë së tij  
24 në Gjykatë dhe njëri prej tyre është bërë pjesë e ekipit vetëm  
25 kohët e fundit në tetor të vitit 2021. Kështu që nuk është gjë

1 e duhur që ai të mbajë barrën apo të vazhdojë në mungesën time  
2 që të përfaqësojë zotin Haradinaj.

3 Atëherë siç e dini, unë nuk do të kem mundësi që të ndjek  
4 këto procedura në seanca private dhe do të kem mundësi që të  
5 identifikoj vetëm atë çfarë është thënë në seancë private kur  
6 të shikoj transkriptin e procedurave. Edhe kjo në vetvete e  
7 bën shumë të vështirë që unë të ndjek procedurat siç duhet.

8 Nuk ka garanci që anëtarët e tjerë të ekipit nuk do të  
9 kenë simptoma të tjera dhe nuk mund të garantojmë që asnjë  
10 prej tyre nuk do të ketë simptoma të mëtejshme edhe kjo është  
11 arsyeja që pse ne po kërkojmë shtyrje dhe ky është pozicioni i  
12 Mbrojtjes përpara Gjykatës.

13 Së dyti, ndërkohë që unë jam avokati, unë jam vetëm  
14 përgjegjës sa i takon procesit gjyqësor dhe jam drejtuesi i  
15 Mbrojtjes për sa i takon zotit Haradinaj. Por unë aktualisht,  
16 duke filluar nga sot, është e pamundur që të mbroj zotin  
17 Haradinaj.

18 Ndoshta kushtet e mia do të përmirësohen. Megjithatë, siç  
19 janë gjërat deri tani, është e pamundur për mua që ta  
20 përfaqësoj siç duhet zotin Haradinaj. E kam pasur të pamundur  
21 që të kontaktoj me zotin Haradinaj siç duhet. Dhe jam  
22 informuar sot, që mbështetur në kërkesat e qeverisë, pra, në  
23 momentin që ke simptomat e para, të duhen shtatë ditë të tjera  
24 pas ditës së raportuar të sëmundjes, që të lejohesh që të  
25 dalësh nga karantina.

1 E kuptoj, është fatkeqe fakti që situata është e tillë,  
2 megjithatë do kërkoj një shtyrje për të gjithë këtë javë. Dhe  
3 ajo që është më e rëndësishme, ndërkohë që unë po e ndjek  
4 seancën në distancë, nuk do të kem mundësi të që të ndjek  
5 seancat private. Dhe ky është pozicioni i Mbrojtjes së zotit  
6 Haradinaj.

7 Ajo çfarë do të them më tepër është, që nuk ka paragjykim  
8 të Mbrojtjes sa i takon shtyrjes së shkurtër.

9 Sa i takon Mbrojtjes, dua të them që do të marrë udhëzime  
10 specifike nga zoti Haradinaj, pra, do të dua të kontaktoj me  
11 të për të ditur në qoftë se ai kërkon ose është dakord që të  
12 shtyhet procedura ose në qoftë se nuk ka ndonjë problem që të  
13 vijohet më tej në këto rrethana aktuale. Ndërkohë, aktualisht,  
14 nuk e them dot këtë gjë sepse nuk kam pasur mundësi ta  
15 diskutoj këtë gjë me të. Pra, së pari, më duhet të them që  
16 deri sot në mëngjes nuk kam pasur asnjë lloj mundësie që të  
17 komunikoj me zotin Haradinaj.

18 E kuptoj që shtyrja e shkurtër nuk kundërshtohet nga  
19 palët dhe sërish, siç e thashë, do të dua që të diskutoj me  
20 zotin Haradinaj përmes zotit Berisha në mënyrë që mund të  
21 marrë udhëzime të plota sesi do të vijohet më tej.

22 Pra, shkurtimisht, më duhet të them: Që nuk ka asnjë  
23 arsye që Trupi Gjykses të mos miratojë shtyrje të procesit.  
24 Pra, mendoj që është e rëndësishme që të marrim parasysh  
25 elementin e sigurisë por gjithashtu, është e rëndësishme që të

1 marrim parasysh edhe interesat e drejtësisë, procesin e  
2 rregullt ligjor.

3 Dhe mendoj që kjo kërkesë është e justifikuar. Pra, po  
4 kërkoj këtë shtyrje shkurtër.

5 Është një çështje të cilën mendoj, domethënë, që të mos  
6 vijohet që prej tani, në mënyrë që të mund të marrë udhëzime  
7 formale nga zoti Haradinaj dhe pastaj t'i raportoj Gjykatës.

8 Domethënë, nuk mendoj që është më mirë të filloj dhe pastaj të  
9 shtyhet.

10 Këto janë parashtrimet e mia përmbledhëse, Gjykatës i  
11 nderuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Prokurori.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Disa gjëra. Na vjen keq që zoti  
16 Cadman është në situatën që është dhe i urojmë shërim të  
17 shpejtë.

18 Ne nuk jemi kundër një shtyrjeee shumë të shkurtër në  
19 mënyrë që avokati të mund të komunikojë me klientin e vet dhe  
20 të marrë udhëzime të tjera të mëtejshme. Ne shpresojmë që këto  
21 komunikime të mund të organizohen orën në vijim. Dhe  
22 shpresojmë që të kemi mundësi që të marrim informacion të më  
23 tejshëm nga zoti Cadman sa i takon kërkesave specifike dhe do  
24 të përgjigjemi në momentin kur të na formulohen më qartë këto  
25 kërkesa.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Zoti Rees.

4 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne duam që të  
5 vijojmë sa më shpejt të jetë e mundur, por nga ana tjetër e  
6 kuptojmë pozicionin e zotit Cadman. Ai parashtrojë kërkesën e  
7 tij që të kontaktojë me klientin e vet dhe kjo është një  
8 kërkesë jo e paarsyeshme.

9 Si zonja Bolici, ne shpresojmë që konferenca ose le të  
10 themi kontaktimi në distancë ndërmjet zotit Cadman edhe zotit  
11 Haradinaj të mund të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur  
12 dhe ndoshta do të ishte mirë që të rifillojmë, të kemi  
13 mundësinë që të rifillojmë së shpejti, ndoshta brenda orës,  
14 pasi të ketë komunikuar zoti Cadman me zotin Haradinaj.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

16 Faleminderit, zoti Rees.

17 [Anëtarët e Trupit Gjygues këshillohen]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do të  
19 bëjmë pushim për një orë.

20 Zoti Cadman, Sekretari na tha që mund t'i bëjë  
21 organizimet përkatëse për të kontaktuar. Ndërkohë që do të  
22 bëjmë një pushim prej një ore dhe do të bashkohemi sërish në  
23 seancë në orën 11.00. Dhe duke shpresuar që ju të gjithë do të  
24 bëheni më mirë së shpejti. Atëherë do shikohemi sërish në  
25 seancë në orën 11.15.



1 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Faleminderit,  
2 të nderuar Gjykatës.

3 --- Pauza fillon në orën 09.43

4 --- Seanca rifillon në orën 10.45

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Uluni, ju  
6 lutem.

7 Në rregull, Z. Cadman, jemi përsëri në seancë. A mund të  
8 na përditësoni lidhur me diskutimet.

9 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit,  
10 i nderuar Gjykatës, faleminderit për kohën.

11 Pra, pata mundësi të shkurtër që të flisja me zotin  
12 Haradinaj sa i takon këtyre çështjeve. Zoti Haradinaj ka  
13 shprehur të njëjtat shqetësime si unë sa i takon të qenit në  
14 gjendje që të vijojmë siç duhet me këtë çështje. Ai beson se  
15 ai do të vazhdojë të qëndroje në karantinë për dy - tre ditët  
16 në vijim.

17 I shpjegova atij situatën time në hollësi dhe i shpjegova  
18 faktin që unë nuk jam i pranishëm, zoti Buckley nuk është i  
19 pranishëm dhe një pjesë domethënëse e ekipit tonë nuk do të  
20 ketë mundësi që të marrë pjesë në ditët në vijim të seancës.

21 Pa diskutim zoti Haradinaj, si të gjithë neve, dëshirojmë  
22 që të vijojmë me këto çështje dhe shpresoj që kërkesa që po  
23 bëj të mos interpretohet në asnjë mënyrë si vonesë e  
24 çështjeve.

25 Zoti Haradinaj shprehu dëshirën e tij që procedurat të

1 mund të vijojnë sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe do të  
2 mundohemi që ta tregojmë këtë gjë me kalimin e kohës.

3 Por sigurisht, i vetmi aspekt që të nderuar Gjykatës ju  
4 duhet të keni dhe Gjykata duhet të ketë është që zotit  
5 Haradinaj t'i garantohet një proces i rregullt ligjor dhe për  
6 këtë arsye gjëja me e rëndësishme është që të merret parasysh  
7 procesi gjyqësor i rregullt për zotin Haradinaj dhe fakti që  
8 nuk është se jemi të pranishëm e vë në diskutim këtë gjë.

9 Nuk po kërkohoj që të vonoj këtë çështje më tej.  
10 Bashkëmbrojtësi, zoti Worboys ka qenë në kontakt me Gjykatën.  
11 Mund të ketë mundësi ndoshta që të më sigurohet një laptop  
12 duke pasur parasysh që mund të ndjek, le të themi, seancat  
13 private, por ky është një ndër shqetësimet kryesore për mua.

14 Ne duam që gjërat të vijojnë por duam që të marrim  
15 udhëzime dhe duam që të sigurojmë që zoti Haradinaj të marrë  
16 pjesë aktivisht në procesin gjyqësor. Kështu që në këto kushte  
17 do të kërkoja që të shtyhet procedura për dy ditë të tjera,  
18 domethënë deri të mërkurën, në mënyrë që të përmirësohet  
19 situata ime shëndetësore dhe shpresojmë që zoti Haradinaj do  
20 të ketë dalë nga karantina, zoti Berisha do të ketë mundësi që  
21 të jetë i pranishëm po ashtu dhe duam që zoti Haradinaj të  
22 jetë i pranishëm në Gjykatë.

23 Shpresojmë që kjo të mos jetë kërkesë jo e arsyeshme dhe  
24 dua që t'ju kërkoj që këtë kërkesë ta merrni shumë seriozisht.  
25 Domethënë e kemi të pamundur që të vijojmë në këto rrethana

1 dhe ne po kërkojnë një shtyrje shumë të kufizuar. Në qoftë se  
2 nuk jeni dakord me neve, pa diskutim që ne mund t'ju  
3 drejtohem sërish sepse mund të ketë edhe mënyra të tjera, për  
4 të ndrequr situatën. Kjo është kërkesa ime që seanca të mund  
5 të shtyhet deri të mërkurën.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

7 Faleminderit, zoti Cadman.

8 Prokuroria, doni që të përgjigjeni ju?

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Prokuroria  
10 vëren se në çështjen Haradinaj kemi dy bashkëmbrojtës që janë  
11 të disponueshëm. Njëri që e ndjek online, dhe një tjetër që  
12 është i pranishëm në Gjykatë. Bashkëmbrojtësi, i cili është në  
13 gjykatë, ka mundësi që të ndjekë seancat private. Për këtë  
14 arsye, nuk ka justifikim për shtyrjen e seancave të  
15 planifikuara.

16 Megjithatë, ja lëmë në dorë Trupit Gjykes për të  
17 vendosur sa i takon kësaj çështjeje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

19 Faleminderit, Znj. Bolici.

20 Z. Reese, keni ndonjë gjë për t'u përgjigjur?

21 Z. REES: [Përkthim] Siç e thashë edhe më përpara, më vjen  
22 keq për pozicionin e zotit Cadman. Ne në fakt mezi po presim  
23 që të vijojmë dhe në qoftë se shqetësimi kryesor është  
24 paaftësia e zotit Cadman dhe e personave të tjerë të cilët po  
25 na ndjekin online për të ndjekur seancat private, neve kemi

1 një përgjigje të thjeshtë. Domethënë që e gjithë seanca të  
2 mund të organizohet apo të realizohet në seancë publike, pra,  
3 jo në seancë private.

4 Ne parashtrojmë që prova e zotit Gucati duhet që të  
5 dëgjohet në seancë publike dhe për këtë arsye ne mund të  
6 vazhdojmë që mbi këtë bazë mund të vijojmë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
8 gjë tjetër, zoti Cadman?

9 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Të nderuar  
10 Gjykatës, unë vazhdoj të kem të njëjtin qëndrim që nuk është e  
11 përshtatshme për ne për të vijuar në këto rrethana. E mbaj të  
12 njëjtin qëndrim dhe në qoftë se Gjykata do të vijojë në këto  
13 rrethana, vërtetë jam i shqetësuar. Aj çfarë tha zoti Reese pa  
14 diskutim që është shumë e rëndësishme sepse ne kemi theksuar  
15 të dy, si në emër të zotit Haradinaj dhe të të akuzuarit  
16 tjetër, që ne jemi të interesuar që proceset të jetë sa më të  
17 shpejta që të jetë e mundur. Mendoj që nuk ka asnjë arsye sa i  
18 takon provës së zotit Gucati që të shkojë në seanca private,  
19 megjithatë kjo është diçka e cila nuk është e parashikueshme.

20 Megjithatë duhet të them që unë kam të njëjtin pozicion.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Duke që  
22 pengesa kryesore janë seancat private. Megjithatë, zoti Reese  
23 kjo varet nga ju. Domethënë ju dje keni përmendur disa emrat  
24 të cilat ne nuk do t'i lejojmë sërish. Megjithatë, në qoftë se  
25 ju do t'i përmendni këto emra dhe për të thënë të drejtën nuk

1 e kuptoj se këto emra janë të rëndësishëm mbrojtjen tuaj, ne  
2 do të duhet që të shkojmë në seanca private.

3 Pra a synoni ju që të ngrini çështje të cilat në mënyrë  
4 të arsyeshme do ta çojnë Trupin Gjykues që të shkojë në seancë  
5 private?

6 Z. REES: [Përkthim] Pozicioni im është se me aq sa mund  
7 të parashikoj në mënyrë të arsyeshme, prova e zotit Gucati,  
8 dëshmia e zotit Gucati, do të dëgjohet në seancë publike.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] A mendoni  
10 ju se do të përdorni emra të palëve ose të personave, emrat e  
11 të cilëve janë shfaqur së pari në paketat me informacion?

12 Z. REES: [Përkthim] Të gjitha emrat të cilët do të  
13 përmenden janë emrat të cilat mund të përmenden në publik  
14 plotësisht, domethënë që janë pjesë e artikujve publikë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Nuk është  
16 pyetja ime kjo.

17 Pyetja ime është kjo: a mendoni ju që do të përdorni  
18 ndonjë emër në marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje, të cilët  
19 janë emra që përfshihen në materiale në paketat e  
20 informacionit të nxjerrë?

21 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se do të më ishin treguar se  
22 çfarë përmbajnë paketat do të kisha mundësi që t'ju jepja  
23 përgjigje. Por nuk i kam parë ato kështu që nuk mund t'ju them  
24 me siguri po apo jo.

25 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti  
2 Cadman, Trupi Gjykses nuk e pranon kërkesën tuaj për arsyt e  
3 mëposhtme:

4 Së pari, është e dukshme që ju mund të komunikoni me  
5 klientin tuaj përmes telefonatave ose përmes lidhjeve në Zoom.  
6 Së dyti, ju mund të merrni pjesë në këto seanca në distancë.

7 Ky institucion përfshirë Trupin Gjykses dhe Zyrën e  
8 Administrimit, kanë detyrën që të sigurojnë sigurinë dhe  
9 efikasitetin e proceseve gjyqsore. Një aspekt i kësaj detyre  
10 është që të sigurohen që informacioni konfidencial dhe jo  
11 publik të mbrohet gjatë gjithë kohës. Gjatë seancave ne  
12 shkojnë në seanca private për të mbrojtur një informacion të  
13 tillë. Gjatë seancave private, Zyra e Administrimit duhet që  
14 të sigurohet që informacioni konfidencial të mos ekspozohet në  
15 asnjë mënyrë. Zyra e Administrimit mund ta bëjë këtë në  
16 lidhje me seancën e gjyqit sa i takon videolidhjeve, siç  
17 parashikohet në Udhëzuesin e Punës por nuk mund ta bëjë këtë  
18 gjë përmes lidhjeve me Zoom sepse nuk mund të jetë i pranishëm  
19 në anën tjetër kurdo që mund të jetë ana tjetër për të kryer  
20 një vlerësim siç bëhet në rastin e videolidhjes.

21 Ne prezumojmë se ju e kuptoni situatën që në këto  
22 rrethana asnjë staf i Zyrës së Administrimit nuk mund të  
23 ekspozohet që të vijë në vendin tuaj, aty ku gjendeni juve,  
24 për të bërë organizimet dhe lidhjet me videolinkun.

25 Përderisa Zyra e Administrimit nuk mund të sigurojë që

1 vendi ku ju jeni duke ndjekur online seancat, nuk është i  
2 ekspozuar në asnjë mënyrë, ne nuk mund t'ju lejojmë juve të  
3 merrni pjesë në seancë private.

4 Po ashtu, Trupi Gjykses e kupton që ju keni qasje në  
5 transkriptimin në kohë reale dhe mund të ndiqni atë se çfarë  
6 ndiqet në seancat private.

7 Së fundi, ju keni të pranishëm bashkëmbrojtësin,  
8 përgjegjësia kryesore e të cilit është që të përfaqësojë  
9 klientin pavarësisht kohës se kur është caktuar për ta bërë  
10 këtë gjë. Ne e dimë gjithashtu që ju keni mundësi që të  
11 shkëmbeni emaile me kolegët tuaj, në seancë, gjatë seancave  
12 private, dhe për t'ju dhënë atyre udhëzime.

13 Gjithashtu, ne shpresojmë që nuk do të jetë shumë e  
14 nevojshme për të bërë shumë seanca private gjatë ditëve në  
15 vijim, kështu që ne do të vazhdojmë siç ishte planifikuar.

16 Zoti Reese, të premtën në deklaratën hapëse ju përmendët  
17 disa emra, emra të të cilëve janë parë në dokumentet e  
18 sekuestruara në paketa të ndryshme. Trupi Gjykses vendosi që  
19 këto emra nuk mund të përmenden në seancë publike dhe ne mund  
20 të vijojmë më tej me deklaratën hapëse. Gjithsesi, ju bëjmë me  
21 dije që do të ishte mirë që të mos përmenden këto emra, me  
22 përjashtim të zotit Vukoviç, gjendja dhe bashkëpunimi me TFHS-  
23 në është publike.

24 Fakti në qoftë se këta emra janë të mbrojtura apo jo  
25 është diçka që do të duhet që ta vendosë Trupi Gjykses në fund

1 të kësaj seance. Kështu që le t'i marrim gjërat njëra pas  
2 tjetrës.

3 Më tej ne vërejmë që Prokuroria duket sikur nuk ja  
4 problem me sugjerimin tuaj që të disa prej individëve që ju  
5 keni përmendur, kanë bashkëpunuar ma TFHS-në dhe me hetimet e  
6 ZPS-së dhe janë identifikuar si dëshmitarë në këtë kontekst.  
7 Ju keni avokati me përvojë kështu që jam i sigurt që do të  
8 keni mundësi që të bëni pyetje pa përmendur emrat. Kur të  
9 nxirrni një dokument, kërkojini dëshmitarit ta lexojë atë dhe  
10 ju lutem bëjeni pyetjen duke mos përmendur emrat dhe pikat  
11 tuaja do të ngrihen edhe pa përmendur emrat.

12 Në qoftë se përmes pyetjeve di të zbuloni identitetin e  
13 personave, do të na duhet që të kalojmë në seancë private por  
14 do të mundohemi që ta minimizojmë këtë sa më shumë të jetë e  
15 mundur, duke pasur parasysh edhe parashtrimin e Mbrojtjes së  
16 zotit Haradinaj.

17 A jemi të qartë? Të gjithë të qartë lidhur me këtë  
18 çështje? Zoti Reese?

19 Z. REES: [Përkthim] Po, e qartë, të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Më tej,  
21 gjatë seancës së përgatitjes së Mbrojtjes, ne i ftuam ekipet e  
22 Mbrojtjes që të jepnin mocionet me prova të drejtpërdrejta për  
23 Trupin Gjygues. Neve ju kërkuam që të thoshit faqen specifike  
24 dhe numrin përkatës të paragrafëve të dokumenteve dhe të  
25 përdorni ato pjesë specifike të dokumentit që është i



1 rëndësishëm për dëshmitarin. Ne i kërkuam avokatëve të të dyja  
2 anëve që të kenë parasysh faktin që e kemi përsëritur disa  
3 herë që ne nuk jemi këtu për të diskutuar për luftën e drejtë  
4 rreth krimeve të kryera gjatë konfliktit në Kosovë. Si  
5 rezultat, ne do të donim t'ju kërkonim edhe një herë që  
6 pyetjet të kenë të bëjnë me çështjen e cila është në shqyrtim  
7 përpara Trupit Gjykues.

8 Përpara se sa të vijojmë, do të jap një urdhër me gojë sa  
9 i takon kërkesës së Mbrojtjes së zotit Gucati sa i takon  
10 dëshmisë me videolidhje.

11 Me 15 nëntor 2021 Mbrojtja e Gucatit depozitoi një  
12 kërkesë për të thërritur dhe dëshmitarë të paidentifikuar,  
13 përmes videlidhjes.

14 Me 29 nëntor të vitit 2021 Mbrojtja e Gucatit informoi  
15 Trupin Gjykues që e tërhoqi njërin prej dëshmitarëve për të  
16 cilin kishte bërë kërkesë për të dhënë dëshmi me videolidhje.

17 Më 3 dhjetor të vitit 2021 Trupi Gjykues përjashtoi  
18 dëshminë e propozuar të dëshmitarit të Mbrojtjes 1253.

19 Trupi [Gjykues] vëren se kërkesa për videolidhje lidhur  
20 me dëshmitarin e Mbrojtjes 2053 dhe kjo deklaratë, apo dëshmia  
21 e dëshmitarit në fjalë, është e pa nevojshme. Trupi Gjykues  
22 planifikon që të punojmë pesë ditë të kësaj jave, ndoshta sot  
23 do të kemi një ditë më të shkurtuar sa i takon kohës që dhamë  
24 për zotin Cadman për të diskutuar me klientin e tij me  
25 videolidhje.

1 Javën që vjen ne do të jemi në proces, pra do të jemi në  
2 Gjykatë me 16 dhe 17 nëntor [sipas përkthimit], pra të enjten  
3 dhe të premten. Të premten e kësaj jave ne do jemi të mbledhur  
4 vetëm për dy seancat e para. Për ndonjë ndryshim në program,  
5 ju lutem ne do të vazhdojmë që të mbetemi në kontakt dhe do  
6 t'ju informojmë.

7 Zonja Sekretare, ju lutem a mund ta shoqëroni zotin  
8 Gucati në bankën e dëshmitarit.

9 Zoti Gucati, ju lutem, a mund të vini këtu?

10 [I akuzuari Gucati hyn në sallën e gjyqit]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
12 vijoni të qëndroni në këmbë, zoti Gucati.

13 Asistentja e sallës do t'ju japë tani tekstin e  
14 deklaratës.

15 Mirëdita, zoti Gucati. Asistentja e sallës ju ka dhënë  
16 tekstin e deklaratës solemne të cilën do ta bëni tani, në  
17 përputhje me rregullën 141 të Rregullores. Ju lutem, mund të  
18 lexoni

19 I AKUZUAR GUCATI: [Përkthim] Mirëdita. I ndërgjegjshëm  
20 për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësisë sime ligjore,  
21 deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të  
22 vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të  
23 fshehtë asgjë, për të cilën kam dijeni. Beto hem në plagët e  
24 mia të trupit që vetëm të vërtetën do ta them.

25 DËSHMITARI: HYSNI GUCATI

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

2 Faleminderit, zoti Gucati. Mund të uleni.

3 Zoti Gucati, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj.

4 Mendojmë se kjo do të zgjasë të paktën dy ditë. Siç e dini,

5 Avokati juaj në fillim do t'ju bëjë pyetje. Mbasi të mbarojë

6 ai, pastaj ka të drejtën Prokuroria që t'ju bërë pyetje. Mbase

7 edhe avokati i Mbrojtjes së zotit Haradinaj mund të dojë të

8 bëjë pyetje dhe në fund fare edhe anëtarët e Trupit Gjykses.

9 Avokati i Mbrojtjes mendon se pyetjet që do t'ua bëjë

10 mund të jenë dy deri në tre orë. ZPS-ja mendon rreth dhjetë

11 orë, Trupi Gjykses gjithashtu mund të ketë pyetje. Ne e dimë

12 që është ju keni probleme me këmbën dhe herë pas here është e

13 nevojshme që të ngriheni në këmbë. Nëse do të ngriheni në

14 këmbë, ju lutem flisni në atë mënyrë që të jeni sa më afër

15 mikrofonit.

16 Ju lutem t'ua përgjigjeni pyetjeve qartë me fjali të

17 shkurtra nëse nuk e kuptoni pyetjen, lirisht mund t'i kërkonte

18 personit që ua bën pyetjen që ta përsërisë pyetjen apo mund të

19 kërkonte sqarim.

20 Gjithashtu, ju lutem të tregoni se nga e dini përgjigjen

21 apo faktet, apo rrethanat për të cilat ju bëhet pyetja.

22 Flisni afër mikrofonit dhe përpiguni që të prisni rreth

23 pesë sekonda përpara se t'ua përgjigjeni pyetjes dhe flisni

24 ngadalë në mënyrë që përkthyesit të mund t'ua përkthejnë.

25 Gjatë këtyre ditëve që do të jepni dëshmi në Gjykatë, nuk

1 ju lejohet që të diskutoni për përmbajtjen e dëshmisë suaj,  
2 përfshirë këtu edhe avokatin tuaj. Por me avokatin mund të  
3 flisni për çështje që s'kanë lidhje me dëshminë që do jepni  
4 këtu në sallë. Nëse ndonjë person ju bën pyetje lidhur me  
5 dëshminë, ju lutem na vini ne në dijeni.

6 Zoti Reese, ju planifikoni që të paraqisni si provë  
7 materiale edhe deklaratën e dëshmitarit në fund të pyetjeve?

8 Mund të vazhdoni atëherë.

9 Z. REES: [Përkthim]

10 Py. Mund ta filloj duke kërkuar që deklaratë e zotit Gucati  
11 të jetë në dispozicion, fillon me numrin DHG0472. Për zotin  
12 Gucati kemi versionin në gjuhën shqipe që është edhe ai i  
13 përfshirë në listën e provave, DHG0455. Mund t'ia vendos në  
14 dispozicion ju lutem zotit Gucati?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

16 [Mikrofoni çaktivizuar].

17 Pyetje nga z. Reese:

18 Py. Zoti Gucati, ju lutem shihni në fund, shkoni në fund të  
19 deklaratës. Në faqen e fundit, ka një nënshkrim, ka një firmë,  
20 kështu?

21 Pë. Po, vërtetë.

22 Py. Dhe ky është nënshkrimi juaj, apo jo?

23 Pë. Po, i imi.

24 Py. Dhe data e deklaratës është 30 nëntor 2021, apo jo?

25 Pë. Po.

1 Py. Dhe e keni nënshkruar për të deklaruar se përmbajtja e  
2 deklaratës është e vërtetë.

3 Pë. Çdo send që shkruhet në deklaratë është e vërtetë dhe  
4 nënshkrimi është i vërtetë.

5 Py. Deklarata pasqyron ato që ju do të thoni këtu, gjatë  
6 pyetjeve qo do t'ju bëj unë apo jo?

7 Pë. Po.

8 Py. Le të filloj atëherë me disa çështje të thjeshta që kanë  
9 të bëjnë me historikun. Datëlindja juaj është 30 mars 1976.  
10 Kështu?

11 Pë. 1967. 30 i tretit, 1967, e vërtetë.

12 Py. Keni lindur në fshatin Morinë në komunën Skënderaj?

13 Pë. Po.

14 Py. Jeni i martuar prej vitit 1985 me bashkëshorten tuaj. Sa  
15 fëmijë keni, zoti Gucati?

16 Pë. Unë kam pas 8 fëmijë, një më ka vdekur në 2006-ën prej  
17 një leukemie. Tash kam shtatë.

18 Py. Dhe fëmija më i madh në moshë, ç'moshë ka?

19 Pë. Fëmija më i madh në moshë ka 35 vjet, është e martume.

20 Py. Po fëmija më i vogël në moshë, ç'moshë ka?

21 Pë. Tash e kam djalin më të vogël, Korabin, rreth moshës 25  
22 vjeçare.

23 Py. Jeni rritur në Pejë, kështu?

24 Pë. Po, qysh se i vogël, diku në vitin 1968 babai ka punu në  
25 Pejë dhe ne kemi jetu në Pejë, pej 1968-ës.

1 Py. Dhe pasi përfunduat shkollën, vazhduat studimet e larta  
2 për studime komerciale, kështu?

3 Pë. Po, e vërtetë është.

4 Py. Jeni martuar në vitin 1985, ku u vendosët me familjen?

5 Pë. Në vitin 1983 ne jemi shpërngul rpej Peje, jemi ardhur në  
6 fshatin Morinë, komuna e Skënderit, aty ku kam lind. Jam  
7 martuar me 1 shtator të vitit 1985.

8 Py. Dhe familja, shtëpia që kishit në Morinë, çfarë lloj  
9 shtëpie ishte?

10 Pë. Ishte shtëpi dy katëshe, me 6 dhoma banimi.

11 Py. Vazhdoni të jetoni në të njëjtën shtëpi?

12 Pë. Jo, se ne shtëpinë që ka ndërtuar babai në luftën e  
13 fundit është djegur, siç është djegur tërë fshati, më është  
14 djeg edhe shtëpia ime. Në vitin 1998, me 3 gusht 1998, është  
15 djeg shtëpia ime dhe tërë fshati Morinë.

16 Py. Nga viti 1989 deri në vitin 1991 keni punuar?

17 Pë. Po, unë kam punuar një kohë në Mitrovicë dhe në vitin  
18 1991 kam qenë gjenerata e fundit që kam shkuar në ushtrinë  
19 jugosllave që më kanë marrë me dhunë forcat serbe në atë kohë,  
20 forcat policore. Më kanë marrë në vendin e punës, ku isha tu  
21 punuar në Mitrovicë dhe më kanë dërguar në ushtrinë  
22 jugosllave.

23 Py. A ju është kërkuar që të luftoni në një moment të caktuar  
24 për armatën jugosllave?

25 Pë. Po.

1 Py. Ku?

2 Py. Unë kam qenë pjesëtar i ushtrisë jugosllave, JNA në atë  
3 kohë që asht qujt. Me 21 shkurt të vitit 1991 dhe na është  
4 kërku që -- unë isha ushtar në kazermën e Varazhdinit në  
5 Kroaci, kazerma quhej "Kalnički partizan" [fonetikisht] të  
6 asaj kohe dhe na është kërku që ne na kanë çu në -- gjoja që  
7 të mbrojmë Jugosllavinë nga forcat e huaja, nga shtetet e  
8 huaja në Slloveni. Dikun ka qenë rreth qershorit 1991.

9 Py. Sa kohë qëndruat në ushtri?

10 Pë. Unë në ushtri kam qëndruar diku -- rreth afër 9 muajve,  
11 mund të them, diku në 8 muaj. Kam dezertuar -- jo, më fal,  
12 afër 6 muaj, se kam dezertuar me 28 korrik të vitit 1991.

13 Py. Pse e bëtë këtë?

14 Pë. Këtë e kam bo për arsye se tu e pa politikën e  
15 Millosheviçit dhe politikën serbe që donte të pushtonte vendet  
16 e Ballkanit, sidomos Slloveninë, Kroacinë dhe në fund Kosovën,  
17 unë s'kam dasht të jem armik i asnjë populli në Ballkan apo në  
18 Evropë, kështu që kam dasht që të largohena prej ushtrisë  
19 jugosllave, të dezertoj prej ushtrisë se nuk dojsa të jem  
20 viktimë e Serbisë apo të bëj viktima në të kundërtën.

21 Py. Ku shkuat pasi u larguat nga kazerma e ushtrisë?

22 Pë. Mbas kam dezertu, unë me disa shokë shqiptarë të asaj  
23 kohe që kemi dezertu nga ushtria jugosllave, unë kam shkuar te  
24 një i afërmi im në Slloveni, ku kam nejt afër 6 javëve, dhe  
25 pas atyhit jam kthyer në Kosovë, në vendin tim, te familja

1 ime.

2 Py. Nga viti 1991 deri në vitin 1994, keni jetuar rehat, në  
3 paqe si të thuash në shtëpinë tuaj në Kosovë?

4 Pë. Jo vetëm unë që s'kam jetuar rehat në Kosovë, se në atë  
5 kohë ishin masat e dhunshme të Serbisë, masat e kasapit të  
6 Serbisë, Millosheviçit, i cili vendosi masa ekstreme në  
7 Kosovë. Jo vetëm unë që kam ik nga shtëpia, por kanë ik shumë  
8 të rinj që kanë lëshuar Kosovën, kanë dalë jashtë, dhe shumë  
9 qytetarë të vendit tim kanë qenë të maltrajtuar. Kështu që  
10 shtëpia ime është bastisur dy herë, në vitin 1992, hera e parë  
11 që më kanë kërkuar mua të më çojnë në Nish në gjyqin ushtarak,  
12 për arsye pse kam dezertu dhe hera e dytë ka qenë në vitin,  
13 1994, kur më është maltrajtuar babai, mixha dhe djali i axhës.  
14 Py. Zoti Gucati, përkthyesja ka kërkuar që të ngadalësoni kur  
15 të flisni më tutje.

16 Pë. Faleminderit.

17 Py. Po babait tuaj çfarë i ndodhi?

18 Pë. Babain e kanë marrë në stacionin -- në atë kohë u qujke  
19 Serbica, tash quhet Skënderaj, ku mbi 72 orë e kanë mbajtur në  
20 stacionin policor dhe e kanë rrahur aq fortë saqë ka hup edhe  
21 vetëdijen. Në të njëjtën kohë e kanë marrë edhe xhaxhain,  
22 Shabanin dhe djalin e tij, Shahinin, ku të dy janë të  
23 maltrajtum, domethënë tre prej familje janë të maltrajtum.

24 Py. Përmendët më herët se fshati juaj u dogj. Ju kujtohet  
25 viti kur është djegur?



1 Pë. Po, fshati është djeg në 3 gusht të vitit 1998. Atë ditë  
2 ka qenë një ofensivë shumë e madhe e forcave serbe  
3 paramilitare, çetnike, të cilat sulmuan fshatin Morinë,  
4 Erezallë, Makremal, Prishevc, Gjerene, Gjikovc.  
5 Py. Serbët a u kthyen në fshat vitin e ardhshëm.

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse mundet,  
7 dëshiroj që të ngre një çështje që ka lidhje me këtë pistë të  
8 pyetjeve, lidhur edhe me udhëzimet që ka dhënë Trupi Gjykues  
9 sot më herët. Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]

11 Zoti avokat, ju kemi lejuar hapësirë por do të donim që  
12 të fokusoheshit te përmbajtja materiale e deklaratës së  
13 dëshmitarit dhe jo te natyra e luftës e cila nuk është se ka  
14 shumë lidhje me procedurën sot.

15 Z. REES: [Përkthim] Unë parashtroj se ka rëndësi për  
16 zotin Gucati sepse një pjesë e këtij procesi për ta thirrur  
17 një dëshmitar të japë dëshmi që ju si Trup Gjykues mësoni se  
18 kush është dhe në bazë të saj të mund të gjykoni besueshmërinë  
19 në bazë të njohurive që keni ju lidhur me këtë person.

20 Prandaj unë nuk synoj që t'ju zë shumë kohë por do të  
21 doja që të vazhdoja edhe pak kohë për t'i dhënë mundësi  
22 dëshmitarit të shpjegojë kush është, nga është --

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Prandaj  
24 edhe unë ju thashë që ju lamë hapësirë por mendojmë se do ta  
25 mbyllni këtë pjesë të pyetjeve në mënyrë që të vazhdoni në

1 pjesën tjetër të deklaratës.

2 Z. REES: [Përkthim] E kuptojmë, do të përpiqemi.

3 Py. Zoti Gucati, dua t'ju rikujtoj edhe një herë që të është  
4 shumë e rëndësishme që të flisni ngadalë ku të jepni  
5 përgjigjet tuaja se mendoj se përkthyesit nuk kanë kapur një  
6 emër që u përmend më përpara. Ju lutem ngadalë.

7 Edhe një herë ja u bëj pyetje: a u kthyen serbët vitin  
8 pasardhës në fshatin tuaj?

9 Pë. Po, serbët janë kthyer. Është vrarë Zenel Mziu, një koleg  
10 i imi, janë plagosur katër persona dhe është vrarë një  
11 qytetare, Hajrie Mziu, rreth moshës 94 vjeçare, po atë ditë.

12 Py. A u kyçët në UÇK ju vetë?

13 Pë. Po, është e vërtetë. Unë jam kyç në Ushtrinë Çlirimtare  
14 të Kosovës në fund të vitit 1997.

15 Py. Ke qenë ushtar gjatë luftës?

16 Pë. Po.

17 Py. A keni luftuar në ndonjë betejë në vetë fshatin Morinë?

18 Pë. Po, kam marrë pjesë personalisht në ofensivën e 3 gushtit  
19 të vitit 1998.

20 Py. Keni pasur ndonjë humbje gjatë kësaj beteje të datës 3  
21 gusht 1998?

22 Pë. Po, të nderuar, kemi pas humbje siç thamë edhe më herët,  
23 është vrarë dëshmori i kombit tash që është, një koleg i imi,  
24 Zenel Mziu. Ka qenë student i vitit të fundit të fakultetit.

25 Është vrarë një qytetare e Morinës, Hajrie Mziu, shumë e

1 moshuar. E paralizuar ka qenë, në krevat, ku është prerë koka  
2 me sëpate. Kjo është vërtetë, që e kam parë me sytë e mi dhe  
3 Zenelin e kam tërhjek me duart e mia, kështu që në fshatin  
4 Morinë janë të vramë gjithsej 13 për qind të qytetarëve, do të  
5 thotë 39 të vramë, 11 të zhdukur, ku një ndër këta të  
6 zhdukurit e kam djalin e xhaxhait të babait, Halim Gucatin.  
7 Py. Po ju vetë, ti vetë, a pësove ndonjë lëndim gjatë luftës?  
8 Pë. Po, unë jam plagos me 2 qershor në ofensivën e fundit të  
9 vitit 1999 nga njësitë i Frenkit në malet e Berishës, te vendi  
10 i quajtur Guri i Vogël, mbi Llapushnik.  
11 Py. Në ç'vend të trupit i patët këto lëndime?  
12 Pë. Unë jam i plagosur në këmbën e djathtë, të femurit, si i  
13 thotë mjekësia dhe unë jam i operum 27 kam gjithsejt.  
14 Py. Ku keni marrë trajtim?  
15 Pë. Trajtimin e kam marrë ditën e parë në spitalin tonë të  
16 improvizuar në bjeshkë, në malet e Berishës. Dhe trajtimin e  
17 dytë e kam marrë në spitalin ushtarak në Tiranë me 8 qershor  
18 ku më kanë dërguar forcat angleze, të cilat kanë pru ndihmë me  
19 8 qershor në malet e Berishës. Kanë pru ndihmë ushqim për  
20 banorët aty që ishin, për qytetarët dhe mu dhe dy të tjerë të  
21 plagosur na kanë dërguar në Tiranë.  
22 Py. Qëndruat në Tiranë gjatë gjithë trajtimit që morët apo  
23 jo?  
24 Pë. Jo në Tiranë kam qëndruar diku deri kah mesi i korrikut  
25 të vitit 1999. Kam ardhur në Prishtinë, më kanë marrë, familja

1 ime më kanë marrë dhe kam qëndruar në spitalin e Prishtinës,  
2 diku afër tre ditë dhe mbas tre ditësh më kanë dërguar në  
3 Gjermani, në Munih.

4 Py. Na thatë se keni bërë disa operacione, një sërë  
5 operacionesh në këmbë, apo jo?

6 Pë. Po, e vërtetë, 27 operacione i kam bërë gjithsej.

7 Py. Gjatë cilës periudhë janë bërë këto operacione?

8 Pë. Fundi i korrikut dhe i tërë viti 1999 deri në dhjetor --  
9 diku afër 11 operacione, 12, i kam bo në Gjermani sa isha, po  
10 në të njëjtin spital. Mbas viti 2000 -- prapë në vitin 2000 më  
11 prunë prapë në Gjermani dhe kam vazhduar operacionin tani në  
12 Turqi, në Stamboll, në spitalin e turko-amerikan dhe e kam --  
13 në 2016 apo 2015 mujt ka boj këtu -- se kam shumë operacione -  
14 - kam operacionet e fundit në Kosovë.

15 Pë. I vuani ende pasojat e atij lëndimi?

16 Pë. Po, unë kisha që edhe vitin e kaluam të bëj një operacion  
17 -- të ndërhyj, po s'pata fatin se erdha këtu në paraburgim në  
18 Holandë.

19 Py. Pra jeni ende në pritje të një operacioni tjetër në  
20 këmbën e djathtë, kështu?

21 Pë. Këtë e kanë dëshmuar edhe mjekët holandezë që kam qenë në  
22 spital, tash që ca ditë që këtu i bëj kontrollet në spitalin e  
23 Londrës. Kjo është reale, këtë mund ta vërteteni me  
24 dokumentacione që kam nevojë që të operohena edhe një herë.

25 Py. Pas trajtimit në Gjermani dhe pas kthimit në Kosovë në

1 vitin 2001, a u përfshitë në OVL UÇK-në?

2 Pë. Po, pasi u ktheva nga Gjermania në vitin 2001-2002 unë  
3 për herë të parë jam zgjedh Kryetar i Veteranëve të Luftës për  
4 zonën operative të Drenicës.

5 Py. Sa kohë e kryet këtë rol?

6 Pë. Në Skënderaj kam qenë deri në vitin 2015 Kryetari i  
7 Veteranëve të Luftës, domethënë tre mandate.

8 Py. Organizata e Veteranëve të Luftës ka ndonjë komitet  
9 qendror?

10 Pë. Po në organizatë është kryesia, është këshilli drejtues  
11 dhe është kuvendi që mbahet dhe janë ato strukturat që i kemi  
12 ne në organizata.

13 Pë. Dhe selia ma merr mendja ndodhet në Prishtinë apo jo?

14 Pë. Po, selia qendrore është në Prishtinë, ne jemi degë, do  
15 të thotë jemi filiale të qendrës që Kosova -- të gjitha  
16 qytetet e Kosovës janë degë e Organizatës së Veteranëve.

17 Py. A ju kujtohet kur jeni përfshirë edhe në organizimin  
18 qendror, pra edhe në qendër, krahas strukturave rajonale në  
19 Drenicë?

20 Pë. Po. Në vitin 2002 isha edhe anëtar i Kryesisë në nivelin  
21 qendror në Prishtinë.

22 Py. Prej atëherë jeni anëtar i atij komiteti qendror?

23 Pë. Deri në vitin 2017 isha anëtar i komitetit qendror. Në  
24 vitin 2017, me 15 tetor jam Kryetari i Veteranëve të nivelit  
25 qendror.

1 Pë. Kjo pozitë është një pozitë me zgjedhje apo me caktim?

2 Domethënë zgjidhesh dhe jeni zgjedhur apo ju kanë caktuar?

3 Pë. Jo, kjo pozitë është me anë të Kuvendit nëpër të gjitha

4 degët e Kosovës, zgjidhen delegatët e Kuvendit, dhe vijnë

5 delegatët në kuvend dhe aty votohet në kuvend. Prej delegatëve

6 të kuvendit zgjidhet kryetari i organizatës së veteranëve të

7 ushtrisë çlirimtare të Kosovës.

8 Py. Cilat janë detyrat e përgjithshme të kryetarit të OVL

9 UÇK-së në përditshmëri?

10 Pë. Këtu isha shumë në vija të trasha, nëse ka mundësi, se

11 mund me u lshuna në të gjitha vija, por Kryetari i Organizatës

12 së Veteranëve të Luftës ka të bëjë pikërisht për mbrojtjen dhe

13 interesin e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka

14 të bëjë me gjendjen ekonomike dhe sociale të veteranëve të

15 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka të bëjë me takime me

16 institucione të Kosovës, qeveri, President, Parlamentin e

17 Kosovës, kemi të bëjë me nxjerrjen e ligjit të veteranëve të

18 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kemi të bëjmë me akademi që

19 organizojmë për dëshmorët e kombit dhe kemi shumë punë që e

20 ngarkon Kryetarin e Veteranëve të Kosovës dhe kryesinë e

21 veteranëve.

22 Py. Deri ku kryetari i ndihmon veteranët në nivelin

23 individual, domethënë kur them kryetari e kam fjalën për

24 kryetarin dhe për organizatën në përgjithësi. Pra si i ndihmon

25 veteranët në veçanti?

1 Pë. Ne realisht jemi të regjistruar si Organizatë jo  
2 qeveritare, se Organizata e Veteranëve të Luftës është e  
3 regjistruar si organizatë jo qeveritare dhe ne zakonisht bëjmë  
4 kërkesa pranë zyrës së Kryeministrit apo të Presidentit apo të  
5 Ministrit të Financave që të ndihmojnë veteranët sidomos, për  
6 shërim jashtë vendi që i çojnë veteranët me u shëru jashtë  
7 vendi, apo ata veteranë të cilët ken në gjendje të rëndë  
8 ekonomike dhe sociale. Këto janë ato ndihma që Kryetari e ka  
9 si barrë kryesore mbi supet e veta, por edhe nxjerrjen e  
10 ligjeve nga deputetët që ne ju bëjmë presion. Jo presion në  
11 atë aspektin negativ, por presionin për të mirën e shokëve  
12 tonë, që të dalin ligjet nga ai kuvend, ligjet për vlera t e  
13 luftës dhe për veteranët që t'i gëzojnë të drejtat e veta.

14 Py. Organizata e Veteranëve të Luftës është anëtare e  
15 Federatës Botërore të Veteranëve, kështu?

16 Pë. Po, është e vërtetë. Mbi dhjetë vjet kemi që jemi  
17 anëtarët të organizatës së veteranëve botërorë ku unë jam  
18 anëtari i asaj organizate dhe jam anëtar i këshillit të asaj  
19 organizate.

20 Py. Ju keni mbajtur dhe një fjalë në selinë qendrore të kësaj  
21 Federate Botërore të Veteranëve si anëtar i këshillit të asaj  
22 organizate, kështu?

23 Pë. Po, se Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë  
24 Çlirimtare të Kosovës jemi anëtarë e barabartë në atë  
25 organizatë me të gjitha shtetet që mbin 170 shtete aty dhe mua

1 m'u jap rasti që unë të marr një fjalë rasti në atë kuvend dhe  
2 në atë kuvend unë kam folur edhe për Gjykatën Speciale që ju  
3 ka imponu Kosovës.

4 Py. Dhe roli juaj si kryetar përfshin edhe takimet me  
5 oficerët të KFOR-it që përfaqësojnë NATO-n, kështu?

6 Pë. Po, është e vërtetë, ne kemi takim me KFOR-in në Kosovë,  
7 sidomos KFOR-in anglez, KFOR-in amerikan, francez, austriak,  
8 po kemi takim edhe me ambasada të ndryshme të vendit, të  
9 vendeve të ndryshme që janë në Kosovë. Takimet tona më të  
10 shpeshta janë me ambasadën amerikane, angleze, franceze,  
11 kështu që do të thotë kemi takime me të gjitha vendet e NATO-  
12 s, kemi takime me to. Edhe takime me KFOR-in gjerman, me të  
13 gjithë, do të thotë me të gjitha shtete që [e pa kuptueshme]  
14 që këtu, të cilat janë Kosovë ne kemi takime.

15 Py. Dhe sa shpesh ndodhte që të takoheshit me përfaqësues të  
16 ambasadave kombëtare?

17 Pë. Real, takimet më të shpeshta i kemi me ambasadën  
18 amerikane, ambasadën angleze. Kemi edhe me ambasadën franceze,  
19 i kemi pas disa takime, domethënë, qashtu. Kemi takime, po në  
20 vjet mund të jenë dy deri në tre takime me ambasada të  
21 ndryshme.

22 Py. Po takimet me oficerët e KFOR-it sa shpesh ndodhin  
23 takimet të tilla?

24 Pë. Takimet me KFOR-in i kemi pothuaj se të rregullta. Kemi  
25 takime me KFOR-in gjerman, kemi takime çdo dy muaj. Kemi



1 takime me KFOR-in anglez, kur kemi shumë marrëdhënie të mira  
2 bilaterale me ta, do të thotë kemi edhe neja që na ftojnë  
3 drejtë drekë KFOR-i anglez edhe na ftojnë në sport që [e pa  
4 kuptueshme] me ta e kemi përbashkët. Kemi me austriakët, kemi  
5 edhe me karabinierët italian dhe mund ta kemi -- domethënë  
6 kemi takime -- kështu me KFOR-in kemi takime, zakonisht.

7 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a do bëjmë  
8 ndonjë pushim në këtë pikë apo jo?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Po  
10 mundohesha që të gjeja një moment të përshtatshëm. Jo në fakt  
11 nuk do të bëjmë tani por do të bëjmë pushimin e drekës në orën  
12 12.30 dhe do të kthehemi në orën 14.00 dhe do të vazhdojmë nga  
13 ora 14.00 deri në orën 16.00 me procedurën.

14 Z. REES: [Përkthim]

15 Py. Pra ju keni pasur edhe pozicionin si këshilltar i  
16 zgjedhur apo jo?

17 Pë. Po në vitin 2007 jam zgjedh asamblesë së komunës së  
18 Skendarajt, kam qenë i dyti më i votuar, me 508 vota në atë  
19 kohë. Kam qenë dy vite anëtar i asamblesë komunale të qytetit  
20 tim.

21 Py. Kjo periudhë ishte nga 2007-2009, apo jo?

22 Pë. Po se ish periudha 2007-2009 për shkak që Kosova ka  
23 shpall pavarësinë në vitin 2008 dhe tani kalojnë disa  
24 kompetenca në kuadër të qeverisë dhe Presidentit dhe ne e  
25 kishim atë mandat vetëm dy vjeçar.

1 Py. Dhe gjithashtu ju keni punuar edhe si sekretar në një  
2 shkollë lokale fillore në Skënderaj. E saktë është kjo?

3 Pë. Po në atë shkollë punoj prej qershorit të vitit 2007, kam  
4 vazhduar punën deri sa isha Kryetar se pa dalë në një pozitën  
5 -- se është e drejtë ligjore që të ngrihet pozita dhe deri në  
6 -- kam punuar dhe sot kam kontratë në atë shkollë prapë. Por  
7 për momentin është e ngrime pozita.

8 Py. Më lejoni t'ju pyes atëherë për datën 7 shtator të vitit  
9 që shkoi, pra 7 shtator të vitit 2020. A e mbani mend kohën  
10 kur shkuat në zyrat e OVL UÇK-së?

11 Pë. Po, me 7 shtator diku rreth orës 08.00-08.30 unë pi kafe  
12 zakonisht përballë punës ku punoj, një kafe e vogël, me kolegë  
13 të punës. Kah ora 08.30 kam pirë kafe, dhe pak para 09.00 kam  
14 shkuar në zyrën time.

15 Pë. A mundeni që të përshkruajmë pak vendin se ku gjenden  
16 këto zyrat tuaja. Pra, zyrat janë të vendosura në një ndërtesë  
17 me disa kate. A është kështu?

18 Pë. Shumë e vërtetë.

19 Py. Sa kate ka ndërtesa?

20 Pë. Pesë kate.

21 Py. OVL-ja e UÇK-së zyrat e veta i ka në të gjithë ndërtesën  
22 apo jo?

23 Pë. Jo ne kemi katin e katërt dhe katin e pestë, ku në katin  
24 e pestë janë sallat e takimeve.

25 Py. Çfarë biznesesh të tjera janë të vendosura në ndërtesë?

1 Pë. Aty është Shoqata e Invalidëve të Luftës, Shoqata e  
2 Familjeve të Dëshmorëve, përfundi në katin përdhes është një  
3 bankë, nëse s'e gaboju, ProCredit-i, mund të gaboju, ProCredit-i  
4 nëse s'gaboju është edhe janë disa organizata jo qeveritare që  
5 nuk di për ato organizata se s'kam takime edhe realisht  
6 Shoqata e Veteranëve të Luftës së II Botërore të vitit 1945,  
7 janë edhe një grup i tyre që kanë mbet gjallë, shumë pak, por  
8 edhe ajo është në ndërtesë.

9 Py. Pra, vendi ku shkuar për të pirë kafe në mëngjes, sa larg  
10 ose ku është i pozicionuar ky vendi, kjo kafeteria ose  
11 kafeneja, krahasuar me zyrat e OVL së UÇK-së?

12 Pë. Real me metra s'e kam mat por përafërsisht nja 22 metra  
13 hiç s'është ma larg prej ku punoj unë dhe kafja e vogël ku pi  
14 kafe aty.

15 Py. Pra është një tjetër biznes i cili e ka vendin e vet të  
16 ushtrimit të biznesit në godinën ku e ushtron aktivitetin OVL-  
17 ja e UÇK-së, kështu është?

18 Pë. Jo, nuk është një kafe tjetër, por kafja e mëngjesit ku  
19 pi unë kafe në mëngjes është jashtë objektit tonë. Kjo kafe që  
20 është në objektin tonë është afër aty, e kemi diku -- veç  
21 korridorin na ndan.

22 Py. Kë takove ti atje rreth orës 08.30 atë mëngjes?

23 Pë. Zakonisht aty takohena me pastrueset që pinë kafe, Faton  
24 Klinaku, Taibe Miftari, sekretarja teknike. Sekretari teknik  
25 që i punon ID-të e veteranëve, që punon, ato takova. Kështu me

1 shokë të punës, bashkëpunëtorë që punoj, me ta pi kafe

2 gjithmonë, zakonisht kafën e parë të mëngjesit.

3 Py. Po Nasim Haradinaj a ishte i pranishëm kur ti arrite në  
4 orën 08.30 atë ditë?

5 Pë. Nasimi ka ardhur nëse s'gaboj, dhe s'besoj se muj me  
6 gaboj -- ka ardhur diku rreth orës 09.00, pak para nëntës në  
7 zyrën time. Kur kam shkuar në zyrë, Nasimi ka ardh dhe kemi pi  
8 kafën e dytë në zyrën time. Po është e vërtetë.

9 Py. Ndërkohë që po pinit këtë kafe me Nasimin, a u vure ti në  
10 dijeni të ndonjë gjëje të pazakontë që po ndodhte?

11 Pë. Jo, si gjithmonë, rutinën e punës për çdo ditë që kemi  
12 pas -- ashtu. Asgjë s'kam vënë re.

13 Py. A mësuat që atë mëngjes kishte ndodhur diçka e pazakontë?

14 Pë. Jo në atë orë, deri në orën 09.30 asgjë s'kam vënë re  
15 diçka të zakonitë -- që ka ndodh diçka.

16 Py. Çfarë ndodhi në orën 09.30 atë mëngjes?

17 Pë. Për ne kjo ka ndodhur përherë të parë dhe na ka befasuar  
18 të gjithëve që s'ka ndodh kurrë për 20 vite e ca që në  
19 Organizatën e Veteranëve ka ardhur një paketë e dyshimtë, ku  
20 ajo paketë është lënë në zyrën e sekretares, Taibe Miftari, te  
21 recepcioni, mbi tavolinë.

22 Py. Ku keni qenë ju kur ka ndodhur kjo, domethënë momentin  
23 kur janë lënë paketat me informacion?

24 Pë. Unë e thashë edhe ma herët, unë isha në zyrën time. Unë,  
25 Nasimi, Fatoni, ishim në zyrën time duke pirë kafet dhe duke

1 ndarë detyrat e ditës, se pikërisht atë ditë kishim disa  
2 takime me qeveritarë. Po si e morët ju vesh se ishin sjellë  
3 disa dosje në OVL-në e UÇK-së ?

4 Pë. Po në atë moment Taibja i ka ra derës shumë me forcë, se  
5 është frigu. Ajo është frigu shumë. Se s'ka ndodh, thashë më  
6 herët, në organizatën tonë dhe me një bërtim, një zëni që ende  
7 e ndij në veshin tim, që është -- ka mendu se ka ndonjë bombë  
8 në paketë dhe ka ardhur na u ka drejtu: "Ka erdh një person i  
9 maskum dhe e ka lanë një paketë mbi tavolinën time dhe ka ik".  
10 Kjo ka qenë e tëra në ato moment.

11 Py. A e mësuat ju se çfarë kishte thënë burri që i kishte  
12 sjellë kutitë me dosje në momentin që e kishte lënë kutinë  
13 përpara recepsionit?

14 Pë. Mbas asaj kohe ne e kemi mësuar se ai kishte thënë që "do  
15 t'ju sjelli prapë paketa dhe këtë paketë është për ata që  
16 flasin në televizion". Kështu ka qenë.

17 Py. A e pe ti vetë me sytë tuaj korrierin, burrin që solli  
18 paketën?

19 Pë. Jo, personin e kam parë vetëm në kamera që Organizata e  
20 Veteranëve -- ne e i kemi kamerat në korridor. Prej liftit kur  
21 del, dhe mrena në korridor. Edhe tek sekretaria i kemi kamerat  
22 dhe atë e kam parë në kamera. Se jo ashtu, live, s'e kam pa.  
23 Kurrë s'e kam pa.

24 Py. Pra, Taibja të thotë ty që ka ardhur një kuti. Ti në këto  
25 momente shkove për -- a ju afrove kutisë?

1 Pë. Reale edhe ne kishim frikë. Tash, të jemi të sigurtë se  
2 ishte rasti i parë që kishte ndodhur kjo. Ishte një befasi.  
3 Dhe i kemi afruar paketës shumë ngadalë dhe ndoshta për ju  
4 është pak si në humor, por unë do të them kjo që ka ndodhur e  
5 vërtetë, kjo mund -- është në kamera. Me një shtag e kemi  
6 shpalu paketën, kemi hjek një pjesë dhe e kemi pa që ka  
7 dokumentacione se s'kemi guxu t'i afrohem paketës për shkak  
8 të frikës që të mos ketë ndonjë bombë se dihet që Kosova ende  
9 rrezikohet nga armiqtë e saj që ka, kështu që ne jemi tut se  
10 mos ka pru dikush, ka montu ndonjë bombë që mund të eksplodojë  
11 ndërtesën tonë.

12 Py. Kur arrite që të shikonit çfarë kishte brenda, a e mësuat  
13 se çfarë në fakt kishte brenda kutisë?

14 Pë. Real, brenda kutisë kish pas materiale por ne s'i kemi pa  
15 ato se kish qenë një letër e bardhë mbi to, një letër e bardhë  
16 dhe një shkrim që unë ta kisha ditë atë, e kisha rujt, por kam  
17 gabu shumë që e kam humbur -- për shkak të dëshmisë me e rujt  
18 atë -- ku shkruke në atë letrën e bardhë që "do ti sjellim mbi  
19 7000 dosje" dhe ne e kemi marrë paketën dhe e kemi çu në zyrën  
20 time. Kjo është e vërteta.

21 Py. Çfarë ndodhi me këtë shënimin, me këtë fletën e bardhë që  
22 ishte shkruar ky shënimi që sapo na përmendët?

23 Pë. Unë këtë shënimin e parë, e kam marrë atë fletën e  
24 bardhë, e kam ba guzhëm dhe e kam çu në një shportë të  
25 bërðhokut, që kam mendu -- po them sinqerisht, shumë kam

1 gabuar, pse s'e kam ruajt për dëshmi atë, me e pa edhe Trupi  
2 Gjykues. Unë e kam çu atë në shportë, se tuj e llogarit se  
3 s'vlen kurrëgjë. Përjashtim se ishte një shkrim shumë i  
4 thjeshtë, me dorë i shkrum, që shkurke "do t'i sjelli edhe  
5 7000 dosje". Asgjë tjetër s'ka pas të shkrume në atë letër.  
6 Pë. Duke u hedhur për momentin me datë 17 dhjetor 2020 kur  
7 një hetues i ZPS-së ishte i pranishëm. Në qoftë se -- ju lutem  
8 do të shikoni paragrafin 15 të deklaratës që keni dhënë. Besoj  
9 se e shihni emrin e tij.

10 Pë. Tani personalisht mos ta kisha këtë personin -- ky nuk  
11 është një njeri që është -- të jetë i mbyllur dëshmitar apo të  
12 jetë sekret. [REDAKTUAR] ne e njohim të gjithë në Kosovë prej  
13 viteve të kalueme -- jo ata vetëm në vitin 2020, por e njohim  
14 edhe ma herët.

15 Py. Atëherë të ndalojmë këtu, sa i takon këtij hetuesi, ju  
16 vetë a folët me këtë hetues lidhur me këtë fletën e bardhë me  
17 shkrimin e dorës kur je takuar me të me datë 17 shtator të  
18 vitit 2020?

19 Pë. Po. Me [REDAKTUAR] jam taku përherë të parë kështu  
20 personalisht ka ardhur në zyrën time, me 17-ën, që e përmenda  
21 edhe datën dhe më pyt për këtë letrën dhe i them: "me  
22 keqardhje unë e kam hudhur në koshin e bërðhokit për arsye se  
23 s'e kam dit se vlen diçka. Dhe po të them singerisht kërkoj  
24 falje pse e kam ngju atë letër se te e kisha ditë, do ta kisha  
25 ruajt për shkak të provave.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se  
2 mundem, ndoshta avokati nuk e ka informuar klientin e vet që  
3 emrat e stafit të ZPS-së nuk duhet që të përmenden në seancë  
4 të hapur. Mbase është mirë që t'ja kujtojmë këtë gjë të  
5 akuzuarit.

6 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju besoj e dini  
7 që unë nuk e pranoj këtë propozim. Unë e di pozicionin e Trupi  
8 Gjykues ndërkohë që aktualisht vetë nuk shoh ndonjë arsye se  
9 pse emri i këtij hetuesi nuk duhet që të përmendet në publik.  
10 Megjithatë, si gjithmonë jam në duart e Trupit Gjykues.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Ajo çka  
12 është e rëndësishme, zoti Reese, është ajo që është e  
13 rëndësishme për Trupin Gjykues se Trupi Gjykues ka thënë që  
14 nuk duhet të përmenden emrat e përveçëm. Ua thamë këtë gjë dhe  
15 shpresojmë që këtë gjë ta keni të ditur, t'ja bëni të ditur  
16 klientit tuaj.

17 Z. REES: [Përkthim] Zoti Gucati sigurisht që ka qenë, i  
18 ka dëgjuar me vëmendje të gjitha shprehjet dhe të gjitha  
19 udhëzimet që ka dhënë Trupi Gjykues sa i takon kësaj  
20 çështjeje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Mendoj  
22 dhe shpresoj që ai ta ketë kuptuar këtë gjë tani.

23 Ju lutem të redaktojmë, të heqim emrin nga procesverbali.

24 Z. REES: [Përkthim]

25 Py. Atëherë ku kërkoj ndjesë që ju solla sërish me 17



1 shtator. Do t'i referohemi sërish datës 7, pra jemi në një  
2 situatë ku Taibja ju tha juve që ka ardhur një kuti dhe që i  
3 është lënë kjo kutia në zonën e recepcionit, në tavolinën e  
4 saj të punës, aty ku ulej ajo. Ti shkon dhe e shikon se çfarë  
5 ka kutia ndërkohë që kutia ishte e vendosur te tavolina e  
6 recepcionit. A e latë aty kutinë me dokumente apo e dërguat  
7 diku tjetër?

8 Pë. Jo, kutinë ne e morëm në zyrën time.

9 Py. Kush ishte i pranishëm në zyrën tuaj në momentin që u  
10 soll kutia?

11 Pë. Isha unë, Nasimi, Fatoni, punëtorët teknikë që kishin  
12 ardhur deri te dera për kureshtje, veç të kqyrnin se çka po  
13 ndodh. Ishin edhe dy - tre anëtarë të Kryesisë , nëse s'gabo  
14 ishte edhe Çela, kështu që ishim punëtorët, zakonisht që punoj  
15 me ata në punë. Fatoni, që mos të gabo me emra. Po.

16 Py. A i kaluat, a i patë dokumentet ju?

17 Pë. Shumë pak, shumë pak. Arsyeja pse pamë shumë pak se nuk  
18 na ka, hiç as në punë me na interesu. Kemi pa logon e Gjykatës  
19 Speciale, kemi pa disa dokumente në gjuhën serbe, në gjuhën  
20 angleze. Kjo ka qenë, po shumë pak. Se s'kishim ma kohë.

21 Py. Përpara se të vijojmë më tej, zoti Gucati, ca  
22 informacione të përgjithshme. A e lexoni gjuhën angleze, dini  
23 të lexoni në anglisht?

24 Pë. Me u bo real, jo nuk e di gjuhën angleze, shumë pak. Muj  
25 me thanë edhe fare, hiç.

1 Py. A flisni gjuhën angleze?

2 Pë. Jo, jo nuk e flas. Me keqardhje e thash që nuk e flas  
3 gjuhën angleze. Këtu kam qenë shumë i dobët në këtë drejtim.

4 Py. A flisni serbisht?

5 Pë. Real gjuhën serbe e kemi mësuar në ushtrinë jugosllave,  
6 po edhe me insistimin jugosllav kur ka qenë Kosova krahine e  
7 Jugosllavisë, në shkolla tona, në shkollën fillore dhe në  
8 shkollën e mesme, e kemi pas ka dy orë në gjuhën serbe. Dhe  
9 ashtu kam mësuar diçka nga gjuha serbe. Tani kam mësuar edhe  
10 sa isha edhe në shërbimin e ushtrisë të Jugosllavisë në atë  
11 kohë. Po, kam mësuar disa, po kuptoj. Por jo mirë, po kuptoj.

12 Py. Pra ju na thatë që patë disa dokumente në gjuhën angleze,  
13 disa dokumente në gjuhën serbe dhe nuk kishit shumë kohë që  
14 t'i kalonit të gjitha dokumentet. A kaluat çdo faqe të tyre  
15 apo jo?

16 Pë. Jo, s'kemi pas mundësi se të gjitha ato kopje që kanë  
17 qenë, ato është dash me nejt me orë të tëra për me i kontrollu  
18 të gjitha ato dokumentacione, është dash me orë të tëra të  
19 rrimë me ato apo me net, që të shfletohen gjithë ato  
20 dokumentacione.

21 Py. A diskutuat ju lidhur me atë se çfarë duhej bërë me  
22 dokumentet, me personat të tjerë?

23 Pë. Po. Ne kemi diskutuar me kryesinë e ngushtë se çka do të  
24 bëjmë me këto dokumentacione.

25 Py. Çfarë vendosët që të bënit me këto dokumentacione?

1 Pë. Real, me këto dokumentacione ne vendosëm që t'i ftojmë  
2 mediat e Kosovës, t'ia bëjmë një informim. Arsyeja ka qenë  
3 shumë e thjeshtë, pse kemi dasht ta bëjmë këtë informim përmes  
4 mediave.

5 Py. Cila ishte kjo arsye?

6 Pë. Arsyeja ishte shumë e thjeshtë për shkak që tuj mendu që  
7 këto dokumente kanë ardhur deri në Organizatën e Veteranëve ne  
8 kemi menduar që këto dokumente mund të jenë edhe në dorën e  
9 ndonjë matrapazi, i cili mund t'i shpërndajë nëpër qytete, apo  
10 nëpër lokale, apo nëpër shtylla elektrike, vendos diçka dhe ne  
11 që të mos ta marrim këtë barrë të këtyre dokumentacione, që të  
12 mos thotë dikush që Organizata e Veteranëve e ka pas në zyrë  
13 dhe i ka shpërnda këtë nëpër qytete apo në komuna të ndryshme,  
14 apo në vende publike. Dhe kjo ka qenë arsyeja pse kemi dasht  
15 ta hekim barrën tonë dhe përgjegjësinë, përmes medimeve të  
16 Kosovës apo ca do medime që do vijjnë atë ditë në konferencë.

17 Py. Si e thirrët konferencën e shtypit?

18 Pë. Po ne si organizatë kena të drejtë në çdo kohë, në çdo  
19 moment të bëjmë konferencë për media. Kështu që unë e kam  
20 autorizuar Fatonin, që edhe është sekretar Fatoni, sekretari i  
21 Organizata e Veteranëve dhe Fatoni me faqen zyrtare që e ka  
22 Organizata e Veteranëve kemi bo njoftimin që në këtë kohë dhe  
23 në këtë orë do të mbahet një konferencë e jashtëzakonshme.

24 Py. A u përcaktua ndonjë kohë e caktuar sa i takon kësaj  
25 konference për mediat?

1 Pë. Po, zakonisht gjithmonë caktohet orari dhe koha dhe vendi  
2 ku mbahen konferencat.

3 Py. Sa anëtarë të medias morën pjesë në konferencën për  
4 media?

5 Pë. Real me numër të saktë, unë nuk muj të them, se s'është  
6 përgjegjësia imja që marr me numër të caktuar. Atë e merr  
7 zakonisht sekretari kur i fton edhe -- veç e di që salla ka  
8 qenë e mbushur me media. Sa kanë qenë nuk e di numrin. Mund të  
9 jenë dhjetë, dymbëdhjetë apo njëzetë, kështu që numër të saktë  
10 nuk muj të jap. Po një numër ka qenë bukur i mirë.

11 Py. Përveç anëtarëve të OVL-së së UÇK-së edhe anëtarëve të  
12 medias, a ka pasur ndonjë person tjetër të pranishëm në  
13 konferencën për mediat?

14 Pë. Me sa e di unë dhe me sa kujtoj, jo. Kemi qenë vetëm në  
15 mediat. Diçka kështu -- mysafirë s'kemi pas.

16 Py. Në kohën kur u mbajt konferenca për median, ku  
17 gjendeshin, ku ishin dokumentet?

18 Pë. Në momentin -- të gjitha dokumentet kanë qenë në zyrën  
19 time dhe prej zyrës time i kemi çuar në sallën e konferencës.

20 Py. Ku ishin të vendosura dokumentet?

21 Pë. Të gjitha dokumentet ishin të vendosura në tavolinë.  
22 Ekziston edhe filmi, nëse s'gaboj. Transkriptimin e kemi, që  
23 të gjitha dokumentet kanë qenë mbi tavolinë të vendosura.  
24 Asgjë s'ka qenë e mshefur apo diçka e mbajtur sekrete nga  
25 Organizata e Veteranëve. Në çdo send kemi qenë transparentë

1 dhe kemi qenë të hapur. Të gjitha kanë qenë mbi tavolinë.

2 Py. A kishte kopje të dokumenteve?

3 Pë. Nga ana jonë nuk ka pas kopje. Ato kanë qenë -- të gjitha  
4 dokumentacionet kanë qenë në atë paketë. Të gjitha ato kanë  
5 qenë në tavolinë. Ato kanë qenë diku 6 tuba, muj të them  
6 përafërsisht, 900 apo 1000. Do të thotë kanë qenë afër 4000  
7 kanë qenë. Qysh kanë ardh në paketë. Kështu që ashtu kanë  
8 qenë. Ne s'kemi bo kopje.

9 Py. Pra askush në OVL-në e UÇK-së nuk bëri kopje të këtyre  
10 dokumenteve? E saktë është kjo?

11 Pë. Një milion për qind është e saktë. Këto e kanë vërtetu  
12 edhe vetë hetuesit e Gjykatës Speciale që e kanë marrë gjithë  
13 aparaturën tonë të organizatës së veteranëve dhe ata që  
14 mendojnë dhe thojnë që e ka pas kopje në Organizatë të  
15 Veteranëve është një gënjeshtër e madhe. Asnjë kopje, asnjë  
16 rresht, asnjë germë nuk ka qenë e kopjume në Organizata e  
17 Veteranëve të Luftës. Thashë edhe një herë, nuk ka qenë në  
18 interesin tonë të shumëzohet apo të bëjmë kopje. Këtë ma  
19 s'miri e di vetë Prokurori i Gjykatës Speciale që i kanë dalë  
20 ato dokumente nga zyra e tina. Për këtë punë, ai, duhet të  
21 mbajë përgjegjësi. Fare. Qysh kanë ardh në Kosovë.

22 Py. Por ju po thoni që ka pasur kopje të dokumenteve të cilët  
23 ishin pjesë e kutisë me dokumente që u sollën në OVL-në e UÇK-  
24 së, korrekte kjo?

25 Pë. Po, kjo është shumë korrekte. Ato çka ka -- aty kanë qenë

1 në atë paketë -- ku i kanë kopju ata zotnitë. Ku i kanë marrë.  
2 As që dua të di une. Unë e kam ba thirrje edhe me kohë  
3 Gjykatës Speciale, hetuesve të Gjykatës Speciale: ejani ta  
4 kapim personin kush po i sjell. Ata e dinë ku i kanë ba kopjet  
5 e këtyre dokumentacioneve. Ata e dinë qysh i kanë pru. E imja  
6 është që të tregoj realitetin, ça kam fol para mediave, dhe ça  
7 kam bo publike para mediave. Kjo është dhe këtu do ta thom  
8 vetëm të vërtetën.

9 Py. A mund të shihni ju lutem paragrafin 19 të deklaratës  
10 suaj, zoti Gucati. A mund të lexoni që keni thënë që ka pasur  
11 katër kopje identike të dokumenteve edhe a mund të na  
12 konfirmoni që është e saktë?

13 Pë. Me sa e kam parë me sy, dhe me sa di me lexu, kanë qenë,  
14 si të thashë edhe ma herët, katër kopje në atë paketë. Të  
15 lidhme kanë qenë dhe ato kanë qenë të lidhura dhe kanë qenë po  
16 të njëjtat kopje, thuaj.

17 Py. Dhe në konferencën për media ju përmendët që ishin rreth  
18 4000 faqen. Nga e nxorët shifër faqesh?

19 Pë. Ne kemi dhënë gjithmonë përafërsisht se ne nuk i kemi  
20 numëru se ato -- ka pas shumë. Kanë qenë trashësia e tyre,  
21 afër që kaq dhe në bazë të trashësisë ne kemi mendu që rreth  
22 1000 kopje secila i ka ato. Kështu ka qenë dhe kështu e kam  
23 dhënë edhe në deklaratën, kam deklaruar kështu para mediave  
24 kam thënë, rreth afërsisht 4000.

25 Py. Përpara se të fillonte konferenca a u shkruajt ndonjë

1 tekst që do ta lexonit në konferencën për shtyp, që do lexonit  
2 për konferencën për shtyp?

3 Pë. Jo, as unë, as Nasimi, as një anëtar i kryesisë s'kemi  
4 shkru tekst me shkrim se çka do të flas unë para konference,  
5 se gjithmonë ne nuk e dimë çka na pyesin gazetarët dhe kjo  
6 është arsyeja që nuk shkruajmë tekst kur ke -- kur thirr ti në  
7 konferencë gazetarët.

8 Py. U bë ndonjë diskutim se cili do të fliste në konferencën  
9 për shtyp përpara se të zhvillohej konferenca për shtyp?

10 Pë. Si zakonisht, mbasi kisha thirr konferencën unë, më binte  
11 mu se isha edhe kryetari i organizatës, po unë edhe me shëndet  
12 s'isha shumë mirë. Atë ditë, e dinë edhe shokët të gjithë,  
13 besoj edhe disa gazetarë, dhe kështu që unë e kam marrë  
14 fjalën. Muj të them janë kone rreth 5 minuta apo 7, a mund të  
15 jetë edhe më pak, nuk e di. Por fjalën hapëse e kam bo unë në  
16 atë konferencë dhe njoftimin, arsyen pse e kemi thirr  
17 konferencën e jashtëzakonshme.

18 Py. Mendonit që do të fliste edhe Nasimi gjatë konferencës?

19 Pë. Po, se ma herët i pata thanë që "do ta marrësh fjalën"  
20 Nasimit dhe kështu po. Nasimi, po i kam dhënë fjalën mbas  
21 meje, i kam dhënë Nasimit fjalën.

22 Py. U transmetua drejtpërdrejtë, apo jo. Kështu?

23 Pë. Kam dëgjuar që është transmetu nëpër disa media, po. Sa i  
24 ka pas ato edhe portali të shkrueme që kanë ardhur. Po. Ka qenë  
25 drejtpërdrejtë me sa di unë, ka qenë. Disa medime po.

1 Py. OVL UÇK-ja vetë e ka transmetuar konferencën për shtyp  
2 apo jo?

3 Pë. Ne s'kemi portal tonin. Organizata e Veteranëve s'kemi  
4 televizion tonin, as radio, kështu që nuk e besoj. Por përmes  
5 telefonit ka mujt dikush ta bëjë. Është incizimi dhe  
6 transmetimi. Po ne si organizatë nuk kemi as portal, as  
7 televizion po as radio tonën

8 Py. Konferenca për shtyp është regjistruar, është e incizuar  
9 dhe ju vetë e keni parë një tekst të zbardhur, transkriptim  
10 pra të konferencës për shtyp. Në fakt, e keni parë edhe ju  
11 vetë, kështu?

12 Pë. Po, masanej po. Mbase ka përfundu konferenca i kam pa  
13 xhirimet.

14 Py. Gjatë konferencën, gjatë vetë konferencës, a keni zbuluar  
15 dhe a keni shpërndarë informacion konfidencial jo publik?

16 Pë. Nuk e besoj, nuk ndodh, që i kam thënë dikujt "merre këtë  
17 dokument" apo leje ke dokumenti. Nuk e besoj. Janë  
18 transkriptimet që mund t'i shohim të gjitha. Njoftimi im ka  
19 qenë, që kam njoftu "ka ardh një paketë sot në orën 09.30  
20 afër, apo 09.40 minuta". Kam njoftu që ka ardh një paketë. Në  
21 këtë paketë ka dosje të Gjykatës Speciale. Rrjedhja e tyre ne  
22 nuk e dimë. Ky ka qenë njoftimi jem, dhe kjo është krejt.

23 Py. Gjatë kësaj konference për shtyp, a keni kërcënuar  
24 ndokënd?

25 Pë. Jo gjatë konferencës, po unë i kam 54 vite. Në jetë time



1 s'kam kërcënu kurrkënd, pavarësisht policisë, ushtrisë,  
2 paramilitarëve, çetnikëve serbë, me te kam pas kërcënim. Asnjë  
3 shqiptari, asnjë romi, asnjë boshnjaku, asnjë turku që jetojnë  
4 në Kosovë, pavarësisht paramilitarëve serbë, çetnikëve dhe  
5 ushtrisë serbe, me ta kam pas kërcënime, për vendin tim.

6 Py. Po a dëgjove nëse Nasimi zbuloi apo shpërndau informacion  
7 konfidencial jo publik gjatë konferencës për shtyp?

8 Pë. Unë s'besoj se Nasimi mund të bjen në atë nivel, tuj e  
9 ditë përvojën e tina dhe vujtjet e Nasimit, që familja e  
10 Nasimit ka qenë e dënuar politikisht mbi 37 vite burg dhe tuj  
11 e ditë aftësitë e Nasimit, nuk besoj se Nasimi Haradinaj mund  
12 t'ju ketë kërcënu ndonjë gazetari apo dikujna, që t'i thotë  
13 "merre këtë me dhunë dhe vëre publike". Kështu nuk besoj dhe  
14 unë s'e kam ndigju.

15 Py. Çfarë menduat se do të bënin gazetarët me këtë  
16 informacion?

17 Pë. Po ne menduam që gazetarët do ta qisnin në shesh një të  
18 vërtetë. Ato që ne kemi kundërshtu në Gjykatën Speciale, me  
19 kohë. Ky ka qenë arsyetimi ynë, që ne kemi dashur të tregojmë  
20 që Gjykata Speciale bashkëpunon me gjykatat serbe, bashkëpunon  
21 me disa kriminelë serbë, bashkëpunon me Vukçevipin,  
22 bashkëpunon me [REDAKTUAR]. Kjo ka qenë arsyeja jonë pse kemi  
23 dasht të tregojmë të vërtetën tonë pse ne kemi qenë  
24 kundërshtarë se ne i kemi pas probleme edhe në Kosovë me disa  
25 zyrtarë apo edhe disa persona të tjerë që na kanë thënë "pse

1 po e kundërshtonin Gjykatën Speciale". Dhe për t'i bindur  
2 qytetarët e Kosovës, për t'i bindur të gjitha, Parlamentin e  
3 Kosovës, se ç'a kanë votu, t'u tregojmë se kjo Gjykatë  
4 bashkëpunon me këta kriminelë serbë, sidomos me [REDAKTUAR].  
5 Por e tërë opinionin kosovar dhe serb e njohin kush është  
6 [REDAKTUAR]. Kjo ka qenë arsyeja jonë. Se ne s'jemi kundër  
7 drejtësisë, kam thënë gjithmonë me kohë, asnjë moment, 1  
8 milimetër s'jam kundër drejtësisë, se kam luftu për drejtësi.  
9 Se Kosova s'ka pas drejtësi kurrë se kemi qenë të shtypur prej  
10 serbëve dhe kundër drejtësie nuk jam. Jo unë, por asnjë  
11 qytetar i thjeshtë në Kosovë s'është kundër drejtësie. Po jemi  
12 kundër padrejtësisë dhe kjo ka qenë arsyetimi jonë, pse e kemi  
13 bërë publike këto dokumentacione.  
14 Py. A prisnit, a mendonit që ndonjë prej gazetarëve  
15 profesionistë të pranishëm do të kërcënonin ndokënd si  
16 rezultat i kësaj konference për shtyp?  
17 Pë. Unë s'besoj se ndonjë gazetar profesionist apo edhe  
18 amator apo edhe unë si Hysni Gucati apo edhe si Nasim  
19 Haradinaj, apo kryesia, që të jemi aq të marrun që të tregojmë  
20 një emër dëshmitari. Edhe kur kemi biseduar me gazetarët ne  
21 kemi thënë çdo send përmbylle, mund të deklaroj që këtu ka  
22 dokumentacione falso por jo të përmenden emra të dëshmitarëve  
23 se privatësia e çdo njeriut në botë është e mbrojtur dhe ashtu  
24 dëshmitarët duhet të jenë të mbrojtur. Këtë kam edhe nëpër  
25 transkriptime që mund t'i shihni, nëse i keni mund t'i

1 lëshojmë dhe t'i shohim. Se gjithmonë kam kërku që dëshmitë  
2 dhe dëshmitarët të mbrohen dhe të ruhen, pse të mos jem marrë  
3 e ndonjë keqpërdorimi të dikuj, kështu që kjo është shumë e  
4 vërtetë, se edhe mediat edhe ne kemi qenë shumë korrekt në  
5 këtë drejtim.

6 Py. Po atë ditë, më datë 7 shtator, keni dalë për intervistë  
7 në televizion. Ju kujtohet? Pas konferencës për shtyp.

8 Pë. Reale unë e kam bërë edhe me 7 shtator, por kam dalë edhe  
9 në shumë televizione të tjera. Tash nuk e di për në cilin  
10 televizion është fjala, por po, kam dalë, kam dalë në  
11 konferencë për shtyp. Është shumë e vërtetë.

12 Py. Atëherë, t'ju bëj një pyetje atëherë: a keni përmendur  
13 ndonjëherë një emër shqiptari në kuadër të këtij materiali,  
14 kur keni dhënë intervistë në televizion?

15 Pë. Unë nuk e besoj se kam përmendur ndonjë emër të ndonjë  
16 shqiptari. Ka mundësi që një shqiptar që e dëgjon, tërë  
17 populli i Kosovës, [REDAKTUAR],

18 [REDAKTUAR] që atë e njohin tërë populli i  
19 Kosovës dhe tërë opinionin e gjerë në Ballkan mund të them.  
20 Kështu që nuk kam frikë të përmend emrin e tina, që një njeri  
21 që ka marrë pjesë në një masakër të Mejës dhe kjo Gjykatë e  
22 merr për dëshmitar atë njeri, që ka dhunu bashkë me shokët e  
23 vet dhe me strukturat paralele serbe, mbi 20 mijë nënat tona,  
24 gratë tona, motrat tona dhe janë vrarë mbi 1,600 fëmijë, mbi  
25 14,000 qytetarë të vrarë, 460 masakra dhe unë sot atë njeri

1 s'mund ta mbroj.[REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR] kjo është e drejtë e imja. Unë kam luftu për  
4 fjalën e lirë dhe për mendimin e lirë ta kem. Kështu që ka  
5 mundësi të jetë emër. Tjetër emër nuk e besoj që ka -- mund të  
6 jetë. Nga shqiptarët e kam fjalën.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në lidhje me  
8 këtë përgjigje dhe pyetje të fundit, dëshiroj që ta nënvizoj  
9 që urdhri që dhatë ju i nderuar Gjykatës sot në mëngjes, ishte  
10 shumë i qartë. Do të donim që të bëj paralajmërim në këtë  
11 aspekt të mos përmenden emra.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Vetëm një  
13 emër u lejua sot paradite: Vukçeviç.

14 Z. REES: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, dhe zoti  
15 Gucati e ka dëgjuar këtë. Unë sigurisht, unë e bëra pyetjen.  
16 Ai iu përgjigj pyetjes, pa përmendur ndonjë emër shqiptari  
17 gjatë intervistës dhe ai tha që nuk ka përmendur që në fakt  
18 ishte e saktë. Zoti Gucati pa dyshim e ka dëgjuar të nderuarin  
19 Gjykatës, që do ta rikujtoj, që kur të zgjerohet në pyetjen e  
20 tij, të mos përmendë emra.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Zoti  
22 Gucati, kemi theksuar të mos përmendni emra. Nëse duhet të  
23 përdorni një emër, do t'jua bëj pyetjen avokati në mënyrë të  
24 veçantë për atë emër. Nuk m'u duk se e bëri pyetjen. Përveç  
25 dhunë dhe në fund e vrasin dhe e shtyjnë me dëshmu, me gënjy,

1 plakun e shkretë. Mbi 80 vjeçar. Incizimi ekziston, kështu që  
2 mund ta ndjekim, që forcat serbe e marrin plakun me dhunë, dhe  
3 marrin deklaratë të rrejshme dhe në fund e vrasin. Ky është  
4 një realitet që po them unë. Edhe është edhe e dyta, ku në ato  
5 që kam tregu në telefon, kam tregu edhe personin i cili është  
6 i vdekur dhe kanë marrë dëshmi nga ai njeri. Të njëjtin që unë  
7 e kam tregu, është i vrarë nga forcat serbe. Kjo është një  
8 realitet. Dhe unë këtë kam thënë gjithmonë që nuk duhet të  
9 merren nëse ka drejtësi të mirëfilltë. Nuk duhet të merret me  
10 gjind që rrejne, apo me gjind që japin deklaratë, të shkretit  
11 me dhunë, siç ka dhanë në Kosovë një pjesë e tyre gjatë luftës  
12 1998-1999.

13 Py. Pra, përmendët viktimat që kanë vuajtur prej duarve të  
14 autoriteteve serbe dhe theksuat që ZPS-ja dëshironte të  
15 bashkëpunonte me të njëjtat autoritete apo jo?

16 Pë. Mbase s'lejohej të përmenden emrat, kjo është reale mbi  
17 17-18 që i kërkon Interpoli, Gjykata Speciale, apo Zyra e  
18 Specializime apo kjo Gjykatë në Kosovë që thirren, në  
19 thonjëza, "të Kosovës" që ka bashkëpunu me kriminelët serbë,  
20 kjo s'ka dyshim. Janë emrat, janë mbiemrat, janë ato të cilët  
21 ju kanë pri ofensivave në Kosovë, në Mej, Prekaz, Likoshan,  
22 Qirez, Izbicë, Poklek, Qyshk i Pejës dhe shumë qytetet të  
23 Kosovës që tash s'muj t'i përmendi. Mbi 460 masakra në Kosovë  
24 janë ba. Ky është një realitet, këtë s'mund ta mohoj unë. Janë  
25 fakte, të gjitha.

1 Py. Keni përmendur në të njëjtin program televiziv  
2 vendndodhjet Vranje, Nish apo Beograd. Pse i keni përmendur  
3 këto vende?  
4 Pë. Po shumë e thjeshtë është përgjigja, i nderum, në këtë  
5 drejtim. Nëse kjo Gjykatë është formuar nga Parlamenti i  
6 vendit tim, nga deputetët e vendit tim, pse kjo Gjykatë mos  
7 t'i merrte këta dëshmitarë në pyetje në Kosovë, ku janë vende  
8 të caktume, por ti merr e ti çon në Serbi. Nëse ata janë  
9 qytetarë të Kosovës dhe viktimat, që supozon kjo Gjykatë,  
10 atëherë pse të mos merren në pyetje të gjithë ata dëshmitarë  
11 në Kosovë, po të shkojnë në një vend të huaj, në një vend të  
12 armikut tonë, i cili ne na ka sunduar. Serbia na ka vra, na ka  
13 bo masakra dhe na i ka dhunuar mbi 20,000 nënat tona, apo  
14 motra, apo gratë tona që thashë edhe më herët. Kjo ka qenë një  
15 kundërshtimi im. Pse kjo Gjykatë mos t'i merrte të gjithë  
16 dëshmitarët në pyetje në shtetin e Kosovës. Se kjo Gjykatë  
17 është e Kosovës dhe është e formume për ta mbrojtur interesin  
18 e qytetarëve të Kosovës.

19 Py. Më duket se thatë pakëz më parë se kur mësuat për  
20 dorëzimin e kutisë më datë 7 shtator, kujtuat se të njëjtat  
21 dokumente do të ishin dorëzuar edhe në vende të tjera, diku  
22 tjetër, apo jo?

23 Pë. Po, kjo ka qenë edhe frika jonë. Për këtë arsye ne kemi  
24 ba konferencën për media, që mos -- ndonjë matrapaz i caktum i  
25 cili ka pru te na ato dokumentacione, muj ti çonte edhe në një

1 vend të tretë dhe në një vend të katërt, dhe të shpërndahen  
2 ashtu dhe prapë të na hedhin fajin neve, që ne kemi qenë  
3 shpërndarësit. Dhe kjo ka qenë arsyeja pse e kemi thirr  
4 konferencën ne.

5 Py. Dhe thatë se ishte befasi e plotë kur jua sollën atë  
6 kuti, kështu?

7 Pë. Po, herae parë ka ndodhur në Organizata e Veteranëve të  
8 Luftës të sillet një paketë pa dëshirën tonë, apo pa  
9 paralajmërim.

10 Py. A dinit ndonjë gjë se si kishin dalë dokumentet nga zyrat  
11 e ZPS-së dhe kishin ardhur deri te zyrat e OVL UÇK-së?

12 Pë. Të jem i singertë, dëshira ime më e madhe është, e imja  
13 personale po unë besoj e shokëve të mi, që të zbulohet ky rast  
14 pikërisht nga Prokurorët e nderum, që kush i qiti këto  
15 dokumente nga zyrat e tyre. Mund të jetë ndonjë njeri i tyre,  
16 që këta s'duan ta bëjnë zbulimin, kështu që unë kam dëshirën  
17 më të madhe dhe i kam bërë ftesë publike në atë kohë hetueseve  
18 të Gjykatës Speciale, që ta zbulojnë njeriun i cili më qiti në  
19 kurth mu dhe Organizatën e Veteranëve të Luftës me ato  
20 dokumentacione. Unë këto e llogarit një kurth ndaj pjesëtarëve  
21 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndaj meje dhe Nasim  
22 Haradinajt dhe gjithë shokëve tonë. Kështu që kjo pyetje është  
23 mirë t'i bëhet Prokurorëve të nderum, këta që punojnë këtu,  
24 marrin paga këtu. Po unë të isha në vendin e tyre, unë jam unë  
25 jam kryetari i Veteranëve të Luftës. Vetëm një letër del nga

1 organizata e veteranëve, 24 janë shumë. Në 24 sekonda do të  
2 jap dorëheqje. Atëherë nuk do të rri aty kryetar, kur unë më  
3 dalin dokumente nga zyra ime. Këto ju betohem në zot.  
4 Njëzetekatër sekonda i thirri mediat dhe jap dorëheqje, që me  
5 pa dalë ky dokument nga zyra ime. Kjo le të jetë në  
6 ndërgjegjen e tyre, që punojnë në punë e me duar të pastra.  
7 Unë nuk do të merrem me atë punën e tyre, po unë këtë gjë s'do  
8 ta bëja për hir të moralit, për hir të etikës së punës, që kjo  
9 është Gjykatë e ndjeshme, kjo gjykatë ka ardh prej Kosove në  
10 Holandë, për shkak që ka pas siguri shumë të madhe. Dhe këtu  
11 del në fakt që kjo Gjykatë s'ka siguri fare.  
12 Py. Kur e thirrët konferencën e shtypit, dëshiruat që ta  
13 bënit të qartë publikisht që nuk dinit asgjë se si dokumentet  
14 kishin dalë nga zyrat e ZPS-së?  
15 Pë. Të jeni të bindur, thashë, se ne -- që nuk di fare,  
16 absolutisht, as e kam ëndërru, se jo mendu, po as ëndërr me pa  
17 se këto dokumente mund të dalin nga një Gjykatë super  
18 ekskluzive e mbrojtur dhe e sigurt. Super, që i thojnë vetit  
19 "super", ekskluzive e mbrojtur dhe e sigurt, të vijë ato  
20 dokumente në kryeqytetin tim, në vendit tim, në Prishtinë,  
21 sidomos në Organizatën e Veteranëve të Luftës, tuj e ditë  
22 Gjykata Speciale se ne jemi kundër kësaj kësaj Gjykate. E them  
23 një herë dhe njëmijë herë. Kam arsye të plota, objektive,  
24 shumë të forta, pse jam kundër kësaj Gjykate. Vetëm një  
25 shembull dua ta them: pse kjo Gjykatë Speciale nuk heton



1 rastin Panda në Pejë? Gjashtë qytetarë të rinj serb, të  
2 nacionalitetit serb, i kanë vra çetnikët serbë. Pse kjo  
3 Gjykatë nuk e zbulon atë rast? Dhe ata janë qytetarë të  
4 Kosovës, pavarësisht pse janë të nacionalitetit serb. Dhe këtu  
5 mua më ka humbur besimi. Kjo është arsyeja pse jam kundër  
6 kësaj Gjykate.

7 Py. Të kthehemi një hap pas, zoti Gucati. Dua t'ju kërkoj që  
8 ta dëgjoni me shumë kujdes pyetjen. T'i përgjigjeni vetëm  
9 pyetjes. Pyetja që ju bëra ishte: Kur e thirrët konferencën  
10 për shtyp, a dëshironit që ta bënit të qartë publikisht që nuk  
11 kishit dijeni se si kishin dalë këto dokumente nga ZPS-ja?  
12 Cila është kjo përgjigja juaj për këtë pyetje?

13 Pë. Po, i nderum, ne ishim -- ta bënim në dijeni se ne nuk  
14 kemi lidhje me këto dokumentacione, kah kanë dalë, kah kanë  
15 rrjedh, e qysh kanë ardhur në Organizata e Veteranëve.

16 Py. Me datë 8 shtator, pra të nesërmen, a ndodheshit në zyrat  
17 e OVL UÇK-së?

18 Pë. Jo, unë kisha planifiku pushimin tim, pushimin veror, si  
19 çdo njeri, apo qytetar i Kosovës që e planifikon apo e  
20 programon një jetë të vetën. Kështu që unë e kisha planifiku  
21 me 8 qershor kisha në pushimin veror, në det, në Shqipëri. Ku  
22 në orën 5 mëngjes kam udhëtu për Durrës.

23 Py. Pra, më falni zoti Gucati, thatë "qershor", datë 8  
24 shtator. Datë 8 shtator besoj bëhet fjalë.

25 Pë. 8 shtator, jo, jo. 8 shtator. Në mëngjes me ora 5.00 kam

1 udhëtu për Shqipëri.

2 Py. Me cilin, apo cilët udhëtuat në Shqipëri?

3 Pë. Vetëm unë dhe bashkëshortja ime kemi udhëtuar për

4 Shqipëri, me makinën time private.

5 Py. Sa qëndruat në Shqipëri?

6 Pë. Për realitet, me të tregu edhe hotelin e tregoj ku kam

7 banu, hotelin Fafa, vendi i quajtur Shkëmbi i Kavajës. Deri me

8 datën 14 shtator kam nejt në atë hotel dhe të 14 kam liru

9 hotelin, kam pushu te shtëpia me 14, 15 dhe me datën 16 kam

10 fillu punën.

11 Py. Po me zotin Klinaku, a keni biseduar më datë 8 shtator

12 2020?

13 Pë. Po, zoti Klinaku më ka shkru një mesazh, që unë e besoj

14 mesazhin e kanë pa edhe hetuesit e Gjykatës. Tani unë e kam

15 thirr në telefon zotin Klinaku dhe më thotë zoti Klinaku që

16 kanë ardh hetuesit e Gjykatës Speciale në Organizatën e

17 Veteranëve.

18 Py. A tha gjë ai diçka për një dokument që ja kishin dhënë?

19 Pë. Jo, zoti Klinaku vetëm - unë e kam pa dokumentin që më ka

20 thënë "Dorëzim pranimi i materialit". Asnjë dokument tjetër,

21 dhe atë e kam pas bile -- po ma ka çu në foto në telefon, ka

22 ardh, që më tregon që ky është dokumenti që ja kanë dorëzue

23 hetuesit e Gjykatës Speciale. "Dorëzim të pranimit të

24 materialit". Kjo ka qenë.

25 Py. A ju tha diçka për një urdhër të lëshuar nga Gjykata?

1 Pë. Me sa më kujtohet mua jo, në telefon jo. Edhe kur kam  
2 ardh prej pushimi, jo. Me sa më kujtohet, gjithmonë flas, veç  
3 unë di se nuk harroj. Jam pak i vetëdijshtëm se kjo ngjarje ka  
4 qenë një vit -- s'ka më shumë, një vit e dy tre muaj. Nuk e  
5 besoj se më ka thënë diçka, por zoti Klinaku mua më pyeti në  
6 telefon: "a tua jap materialin hetueseve të Gjykatës  
7 Speciale". Dhe unë i them: "Po, jepja materialin. Se ai  
8 material s'është i yni dhe ne s'na hyn në punë. Kështu që  
9 dorëzova materialin hetueseve të Gjykatës Speciale".

10 Py. Në lidhje me dokumentet, të cilat u dorëzuan -- që ju  
11 janë dhënë në datë 7 shtator, atëherë dhe të cilat u vunë në  
12 dispozicion gjatë konferencës për shtyp. Me sa keni ju dijeni,  
13 dikush tjetër a mori faqet e atyre dokumenteve, përveç datës 7  
14 shtator?

15 Pë. Me sa kam njohuri dhe dijeni, gjithmonë po flas për datën  
16 7 shtator, i nderum, përjashtim të mediave, dikush tjetër s'ka  
17 marrë dokumentacion në atë Organizatën e Veteranëve të Luftës.

18 Py. Faleminderit, zoti Gucati.

19 Ky është momenti i duhur për të filluar pushimin.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Në  
21 rregull atëherë, do të bëjmë tani pushimin për drekë. Ju lutem  
22 të rikthehemi në sallë në orën 14.00. Siç e thash edhe më  
23 herët, do të vazhdojmë nga ora 14.00 deri afërsisht në orën  
24 16.00 sot pasdite. Ndërpresim këtu seancën.

25 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofon gjykatësi.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] A kishit  
2 ndonjë gjë për të thënë, zoti Cadman?

3 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit,  
4 të nderuar Gjykatës, thjesht në vijim të asaj që u tha më  
5 përpara, do të duhet tani që të organizoj bisedë me zotin  
6 Haradinaj gjatë pushimit, kështu që i kërkoj Njesisë së  
7 Menaxhimit të Gjykatës që të organizojë një takim të tillë në  
8 Zoom.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Sekretari  
10 i Gjykatës do ta bëjë këtë organizim. Faleminderit.

11 --- Pushimi i drekës fillon në orën 12.30

12 --- Seanca rifillon në orën 14.03

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Rees,  
14 kur të jeni gati mund të vazhdoni.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për procesverbal, zoti Whiting  
16 nuk është i pranishëm në këtë seancë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kërkoj  
18 ndjesë. Duhet të kisha kërkuar që të thoni kush ishin të  
19 pranishëm.

20 A mungon ndonjë person tjetër tani në këtë seancë?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Të nderuar  
22 Gjykatës, në qoftë se mund të drejtohem kështu shkurtimisht.

23 Dua t'ju them që nuk kemi një tjetër anëtar, zonja  
24 Chelsea Qu, që është Menaxhere e Çështjes, partneri e saj po  
25 shfaq simptoma të COVID-it. Kështu që, në këto rrethana, ajo

1 është dërguar në spital [sipas përkthimit]. Domethënë do jetë  
2 në spital [sipas përkthimit] gjatë gjithë kësaj kohe.

3 Dhe një tjetër çështje që dua të ngre është që njësia e  
4 paraburgimit ishte e pamundur që të krijonte një lidhje në  
5 Zoom me zotin Haradinaj. Jemi munduar që ta zgjidhim çështjen  
6 dhe të kontaktojmë me zotin Haradinaj gjatë gjithë kohës, pra,  
7 gjatë pushimit të drekës, sipas pozicionit tonë, kjo është e  
8 papranueshme por në kushtet aktuale ne e kemi pasur të  
9 pamundur që të kemi asnjë lloj komunikimi me zotin Haradinaj.

10 Do t'ju kërkoja, të nderuar Gjykatës, që çfarëdo që të  
11 nevojitet të bëhet, të bëhet në mënyrë që t'i kemi kanalet e  
12 hapura për komunikim me zotin Haradinaj pavarësisht rrethanave  
13 përjashtimore.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pyeta dhe  
15 e di që po punojnë për këtë lidhje, videolidhje. Është e  
16 mundur që juve të flisni 15 minuta më pas dhe në qoftë se  
17 lidhemi besoj që mund të flisni me të për 15 minuta.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Për ca arsye  
19 ka disa ndryshime në lidhje. Nuk e di se çka ka ndryshuar që  
20 nga mëngjesi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk e di.  
22 Por personat përgjegjës po punojnë për këtë.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po e ngre dhe  
24 njëherë këtë çështje. Që ne nuk mund të vazhdojmë në këtë  
25 mënyrë në qoftë se nuk kemi mundësi që të komunikojmë me zotin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hysni Gucati (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Rees

Faqe 62

1 Haradinaj dhe më duhej që ta theksoj këtë gjë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A nuk bëtë  
3 një konsultim me telefon me të?

4 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, por nuk  
5 mund ta lidhja përkthyesin. Sepse nuk është mënyra e duhur kjo  
6 për të folur me klientin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në  
8 rregull.

9 Zoti Rees, mund të vazhdoni më tej.

10 Z. REES: [Përkthim]

11 Py. Atëherë zoti Gucati, më 15 shtator. Ju u kthyet në  
12 Prishtinë dhe shkuat në vizitë - më falni - vizituat ose  
13 shkuat në zyrë atë ditë; apo jo?

14 Pë. Po.

15 Py. Kur mbërritët në zyrë?

16 Pë. Unë zakonisht orarin e kam në ora 09.00-09.10 unë mbërrij  
17 në zyrë. Se zakonisht 08.30 pi kafe, siç theksova ma herët,  
18 përballë punës ku punoj.

19 Py. Përpara sesa të ktheheshit në zyrë, a vutë re ndonjë  
20 makinë, veturë të caktuar apo ndonjë gjë që të bëri  
21 përshtypje?

22 Pë. Jo.

23 Py. A u vutë në dijeni të faktit që dikush ndoshta po ju  
24 shikonte?

25 Pë. Mu më kanë përcjellë prej datës 16-17 e di që më ka

1 përcjellë një makinë. Po ditën që po flasim, për 15 shtatorin,  
2 jo, nuk kam vënë re në atë mëngjes. Nuk kam vënë re.

3 Py. Kur shkuat në zyrë, a diskutuat me ndonjë person tjetër  
4 në zyrë lidhur me makinat që ishin të parkuara në zonën  
5 përreth OVL-së së UÇK-së?

6 Pë. Është reale që mu ku e parkoj unë makinën time edhe  
7 shokët, mbrapa punës ku punojmë, mbrapa ndërtesës. Është një  
8 parkim privat. Një punëtor prej tyre më tregon që thotë  
9 makinën tënde e kanë fotografuar dy vetë. Atë ditë isha me  
10 makinën time personale në punë dhe më thotë që e kanë  
11 fotografu dy vetë makinën time, kështu që, hera e parë ka  
12 ndodhë që të më fotografohet makina nga dikush.

13 Py. Ditën tjetër, më datë 16 shtator, në çfarë ore keni  
14 mbërritur në punë, ju lutem?

15 Py. Mund të jetë e njëjta kohë kështu. Zakonisht, unë shumë  
16 jam i kujdesshëm në punë. Për arsye se kam një përvojë goxha  
17 të gjatë punës, si të thashë, kam punu edhe ma herët viteve  
18 1989, 1990 deri 1991, kështu që, kam qenë shumë i kujdesshëm  
19 në punë. Edhe përgjegjësia që më është dhënë, isha shumë i  
20 kujdesshëm. Që kështu do të thotë orarin s'ka ndodhë, veçse me  
21 qenë smut, ka mujtë orarin ta shmangi të punës.

22 Py. Kush ishte i pranishëm gjithashtu në zyrat e OVL-së së  
23 UÇK-së atë ditë?

24 Pë. Zakonisht me stafin që punoj, Fatoni, Taibja, pastruesja  
25 Tusha, është Çela që është shef i protokollit të punës, Çelë

1 Gashi. Zakonisht me këta punëtorët që punoj me ato, sekretari  
2 teknik që punon aty. Kështu që këta ishim në punë.

3 Py. Kur u vutë për herë të parë në dijeni që diçka e  
4 pazakontë kishte ndodhur në atë moment?

5 Pë. Saktë me orë ndoshta nuk muj e di, po mbas datës 15, 16,  
6 17 e kështu me rend, ne u vumë në dijeni që janë duke na  
7 përcjellur edhe është duke më përcjellë një makinë prej  
8 shtatorit, është fjala prej 7 shtatorit e këndeje, që mu më ka  
9 përcjellë një makinë rregullisht.

10 Py. E dëgjova këtë, por le të përqendrohemi për momentin më  
11 datë 16 shtator 2020. Në çfarë ore u vure ti në dijeni që  
12 diçka e pazakontë kishte ndodhur në zyrë atë ditë?

13 Pë. Orën e saktë ndoshta muj ta kem harruar të saktë. Po atë  
14 ditë, ka ndodhë në zyrë se na ka ardhë dhe një paketë, që ka  
15 ardhë paketa e dytë. Që unë e kam quajtur personin në fjalë  
16 Rrufeja 1, 2 dhe 3, se në fakt, ai personi ka ik ashtu shpejt  
17 ka ik gjithmonë, sa i ka dorëzuar ato dokumentacione, ka ik nga  
18 Organizata e Veteranëve të Luftës.

19 Py. Atëherë le të përqendrohemi tek Rrufeja 2, për momentin.  
20 Si e mësuat ju për herë të parë faktin që erdhi Rrufeja 2?

21 Pë. Ka qenë thujë se i njëjti stil i tina. Tash a ka qenë i  
22 njëjti person apo dikush tjetër nuk muj ta di se s'e kam parë.  
23 Veç çka kam pa në video çka kam pa. Ka qenë një me syza, me  
24 maskë të antikovidit, ka qenë me një kapele. Kështu që thujëse  
25 të njëjtin gjest e ka bë si herën e parë, po dhe të njëjtën



1 punë e ka ba edhe herën e dytë me paketën me dokumentacionin

2 që ishin në të. E ka dorëzuar [në] po të njëjtin vend.

3 Py. Në rregull. Le ta marrim hap pas hapi, në faza. Në qoftë  
4 se mund t'i përgjigjeni pyetjes hap pas hapi zoti Gucati. Për  
5 herë të parë si e mësove ti që erdhi Rrufeja 2?

6 Pë. Për herë të parë unë isha në zyrën time, është fjala më 7  
7 shtator. Nëse e ke fjalën më 7 shtator?

8 Py. Jo, e kam fjalën për 16 shtatorin. E flas për Rrufeja 2.

9 Si e more vesh ti për herë të parë që kishte ndodhur diçka e  
10 pazakontë në zyrë?

11 Pë. Po unë isha në zyrën time. Në zyrën e Nasimit ishin në  
12 takim, nëse s'gaboje, KFOR-i gjerman. Dhe i njëjti rast ka  
13 ardhë Taibja dhe më tregon. Vajza që thotë, prapë ka ardhë një  
14 person anonim me një paketë dhe e ka dërguar paketën në  
15 recepsion. Kjo ka qenë e tëra e njëjtë.

16 Py. Në rregull. Të bëjmë pak pushim këtu. Ju a e patë  
17 personin që e solli kutinë me sytë tuaj? E patë vetë?

18 Pë. Jo, se unë s'muj të vrapoj prej këmbë, që e dini tash  
19 edhe ju që unë jam i plagosur në këmbën e djathtë dhe kam  
20 probleme me këtë këmbë. Unë s'muj të vrapoj për me e pa atë.  
21 Kam dalë deri te dera ime e zyrës deri në korridor dhe nuk kam  
22 mujtë ta vërej personin, ta shohë se ai ka ik shumë shpejt.  
23 Kështu që po edhe për këtë arsye ja kam ngjitur emrin Rrufeja  
24 2.

25 Py. A kishte ndonjë person që e ndoqi këtë burrin, këtë

1 personin?

2 Pë. Me sa e di, nëse s'gaboju gjithmonë, po besoj se duhet të  
3 jem i sigurt edhe këtu, e di që Fatoni ka vrapu mbas tina deri  
4 dikund, deri tek kati i tretë i ndërtesës po ma poshtë nuk ka  
5 guxu për shkak se personi e ka çu dorën deri tek brezi dhe  
6 Fatoni është kthyer mbrapa. Që në atë rast edhe unë ndoshta  
7 isha kthi mbrapa, për shkak të sigurisë së vetë, që mund të  
8 ketë diçka me vete personi.

9 Py. Do të thuash mund të kishte një armë?

10 Pë. Po, mbasi s'e kam pa, po. Kur të çon njëri dorën në brez  
11 me siguri që mund të ketë ndonjë send. Dhe kështu Fatoni për  
12 shkak të sigurisë është kthi. Dhe ne i kemi bërtit Fatonit,  
13 unë edhe Nasimi dhe të gjithë kolegët, që s'ke nevojë të  
14 vraposh mbas askujt ti. Aty janë policia, për sigurinë e  
15 qytetarëve janë policia, jo ne.

16 Py. A patë nga dritarja e zyrës në drejtim të parkimit të  
17 makinave të cilat i përmende pak më parë?

18 Pë. Po, mbrapa zyrës time është banja dhe aty kam dalë unë me  
19 Fatonin. Kur më kanë lajmërua që ajo makina që më ka përcjellë  
20 mu është në parking, unë kam dalë dhe e kam fotografuar me  
21 telefonin tim makinën. Besoj që hetuesit e Gjykatës mu ma kanë  
22 marrë telefonin dhe e kanë nxjerrë atë fotografi që është  
23 fotografia në telefon timin. Kjo është shumë reale. Makina që  
24 më kanë përcjellë mu -- kanë qenë dy persona në atë makinë një  
25 burrë dhe një femër. Kështu që emrat nuk i di. Nuk i njoh kush

1 janë. Po është shumë reale, që ata persona ma kanë fotografuar  
2 makinën time dhe më kanë përcjellë.

3 Py. Pra, makina, të cilës i bëtë një fotografi më datë 16  
4 shtator, këtë makinë a e kishe parë ti më parë?

5 Pë. Unë kam dyshu në një makinë edhe ma herët, po unë, me sa  
6 besoj, kjo makinë mu më ka përcjellë kur kam ardhur prej  
7 Skënderajt në punë. Në fshatin Sllatinë, është një pompë  
8 benzine ku unë pi kafe aty zakonisht me disa kolegë të mi,  
9 ish-kolegë. Pimë kafe aty dhe ajo makinë është parku nja tri  
10 herë, ku kam parku makinën time unë. Do të thotë edhe pas  
11 datës 16, po unë besoj që edhe ma herët ka qenë.

12 Py. Hetuesit të cilit ju i treguat këtë fotografi, ishte i  
13 njëjti hetues, emrin e të cilit ju e përmendët sot paradite;  
14 është kështu?

15 Pë. Jo, me këtë hetues që e përmenda emrin e tina ma herët,  
16 jam taku për herë të parë më datën 17, nëse s'gaboju. Për  
17 makinë nuk e di a ka qenë. Nuk guxoj të jem i sigurt që të  
18 them ka qenë në makinë ky hetues, po ky hetues në zyrën time  
19 ka qenë.

20 Py. Nuk ju pyeta këtë zoti Gucati. Po ju pyes të konfirmoni  
21 në qoftë se hetuesi, të cilit i treguat fotografinë e makinës  
22 është i njëjti hetues, emrin e të cilit e përmendët sot  
23 paradite? Këtë pyetje të bëra.

24 Pë. Ajo është shumë e vërtetë. Këtij hetuesi unë ja kam japë  
25 fotografinë prej telefonit tim në telefonin e tina. Po shumë e

1 vërtetë është kjo. Unë edhe Fatoni ja kemi jepë fotografinë të  
2 dytë këtij hetuesi. Po shumë e vërtetë është.

3 Py. Çfarë kishte lënë personi në zyra më datë 16 shtator?

4 Pë. Kishte lënë disa materiale, që numrin e tyre nuk e di.

5 Një paketë me disa materiale të Gjykatës Speciale.

6 Py. A pe brenda këtyre paketave me informacione, me

7 dokumente, domethënë, brenda kësaj pakete që përmendët?

8 Pë. Po, kam pa informacione, sende po nuk i kam kontrolluar,  
9 si me thënë, në detaje diçka. Kam pa mbishkrimet që kanë qenë  
10 në gjuhën angleze, në gjuhën serbe. Kështu që kanë qenë të  
11 gjitha materiale të -- unë e kam supozu dhe shokët e mi se  
12 janë të Gjykatës Speciale.

13 Py. A e diskutuat me persona të tjerë në OVL të UÇK-së se  
14 çfarë do bënit lidhur me këto dokumente?

15 Pë. Po. Gjithmonë se ne bisedojmë me kryesinë e ngushtë. Që  
16 do të thotë edhe pse jam kryetar në kuvend, unë më autorizon  
17 kuvendi shumë vendime t'i marrë vet, po unë nuk marrë vendime  
18 kështu kokë më vete pa këshillat e shokëve, sidomos kryesisë  
19 së ngushtë, kemi bisedu dhe kemi marrë të njëjtin veprim për  
20 të njëjtat arsye që thashë paradite.

21 Py. Dhe çfarë vendosët të bënit ju?

22 Pë. Ne vendosëm, gjithmonë flas me i ftu mediat. Kam autorizuar  
23 Fatonin, sekretarin, që t'i ftoj mediat në orën e caktuar, në  
24 vendin e caktuar, që të kem një konferencë që t'i njoftoj  
25 mediat që prapë në organizatën tonë kanë mbërri disa

1 dokumentacione që për ne janë të panjofna. Dhe ne nuk do të  
2 ngulshim këmbë që ato janë të Gjykatës, por hetuesit e pranuan  
3 që janë të Gjykatës Speciale dhe ne thamë këto dokumente  
4 rrjedhin nga Gjykata Speciale.

5 Py. Ju lutem, a mund të shihni deklaratën tuaj në paragrafin  
6 26 [sipas përkthimit]?

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam  
8 kundërshtim lidhur me përdorimin e deklaratës së dëshmitarit  
9 përpara se t'i bëhet pyetja dëshmitarit lidhur me këtë çështje  
10 specifike. Pra, duhet të bëhet pyetja njëherë pastaj të  
11 tregohet deklarata.

12 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë kam kërkuar  
13 --

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E rrëzoj  
15 kundërshtimin mbështetur në përmbajtjen e paragrafit. Pra,  
16 mund të vazhdoni më tej, zoti Rees.

17 Z. REES: [Përkthim]

18 Py. Zoti Gucati, ju lutem shikoni paragrafin 36 të deklaratës  
19 suaj dhe, ju lutem, lexojeni me vete.

20 Në këtë paragraf përmenden dy emra serb që ju keni  
21 përmendur gjatë konferencës për shtyp dhe e kemi parë edhe  
22 transkriptin po gjithashtu edhe regjistrimin e konferencës për  
23 shtyp. Tani, pa i përmendur emrat, kush ose me fjalë të tjera,  
24 çfarë roli menduat juve se kishin luajtur këto dy emra të  
25 serbëve që keni dhënë në deklaratën tuaj?

1 Pë. Mbase s'më lejohet publikisht t'i përmend emrat, po këta  
2 dy emra janë të njoftun në të gjithë opinionin kosovar, po  
3 edhe serb ashtu, që e dinë punën dhe veprat e tyre që kanë bë  
4 në Kosovë. Dhe kjo më ka shti, arsyeja t'i përmendi këta dy  
5 burra, çetnik serb, të cilët kanë bë një masakër në masakrën  
6 Meja, në Gjakovë.

7 Py. Pra, na ndihmo pak më shumë lidhur me këtë: Çfarë  
8 pozicioni kanë ata? Çfarë pozicioni kanë pasur ata?

9 Pë. E di se këto dy figura janë figura publike, në atë kohë  
10 kanë qenë, tash për momentin nuk e di se çka punojnë. Po me sa  
11 di unë, me sa kem qenë të njoftum, kanë qenë me uniforma.  
12 Njëri prej tyre, mos gabofsha, nëse s'jam shumë i gabum, mund  
13 të jetë dhe shef policie të asaj kohe.

14 Py. Pra, të dy ishin zyrtarë publik. A menduat ju që ata mund  
15 të ishin dëshmitarë?

16 Pë. Po i pamë emrat në ato dokumentacione, ne menduam se mund  
17 të jenë dëshmitar. Njëri prej tyre edhe zyrtarë i lartë i  
18 gjykatave serbe për krime gjoja të luftës në Serbi. Kështu që,  
19 ne kemi mendu që nuk e kemi shkel ligjin, ku këta janë persona  
20 zyrtarë të Serbisë dhe i kemi përmend emrat e tyre.

21 Py. Si jeni ndier ju në kohën e konferencës për shtyp?

22 Pë. Në konferencën e dytë, jo që do ta them unë, po këtë e  
23 thonë edhe shokët e mi, se unë veç tu ja kam lënë edhe  
24 konferencën dy herë e kam ndërpre se isha shumë i sëmurë. Bile  
25 kam pi edhe ujë, që ma ka pru Taibja ujin nalt se më ka vërejt

1 në kamera që s'jam mirë. Kështu që, unë kam qenë pak i sëmurë  
2 atë ditë se kisha shumë dhimbt pi këmbës, se kisha një kohë që  
3 s'kisha përdorë terapinë për kombe. Po kur ishin në pyetje  
4 organizata dhe shokët e mi dhe pafajësia e të gjithë ato që  
5 mendoj unë për shokët e mi, mu dashtë që të dalë para mediave  
6 të mbaj një konferencë bashkë me Nasimin dhe me shokë tjerë.  
7 Py. Lidhur me vetë dokumentet, a mund të na thoni se në çfarë  
8 gjuhe ishin të shkruara këto dokumente?

9 Pë. Nëse s'gaboj, në dosjen apo paketën e dytë që dërguar  
10 Rrufeja 2 kanë qenë në gjuhën serbe, një pjesë e mirë e  
11 konsiderueshme e tyre dhe pjesa dërrmuese ka qenë në gjuhën  
12 angleze.

13 Py. A e dallove dot ti se për çfarë fliste ndonjë prej  
14 dokumenteve?

15 Pë. Po kanë qenë disa dokumente të Gjykatës Ndërkombëtare për  
16 Ish-krimet në Jugosllavi në atë kohë. E rasti i Fatmir Limajt  
17 që ka qenë. Kanë qenë disa dokument nga ato që të ish-gjykatës  
18 së mëparshme.

19 Py. Ditën e nesërme, domethënë më datë 17 shtator, ti u  
20 ktheve përsëri në zyrë; a është kështu? Është e saktë?

21 Pë. Po, si zakonisht, po. Po.

22 Py. Dy hetues nga ZPS-ja dhe një vëzhgues i pavarur mbërritën  
23 në zyrat tuaja; a është e saktë kjo?

24 Pë. Po, shumë e saktë është.

25 Py. A ju kujtohet sesa ishte ora kur erdhën këta dy persona?

1 Pë. Besoj mbas orës 10.00 kanë qenë atë persona në zyrën  
2 time. Shumë mbas orës 10.00.

3 Py. Një prej hetuesve ishte hetuesi, emrin e të cilit e  
4 përmendët më parë edhe të cilit i treguat këtë fotografinë që  
5 sërish e përmendëm më parë; a është e saktë kjo?

6 Pë. Po, me këtë hetues, që tash është i njoftun për ne dhe  
7 për të gjithë juve dhe opinionin, që kurr gjë s'ka të keqe pse  
8 është i njofur, s'jam kundra absolutisht kundër këtij hetuesi.  
9 Diçka personale s'kam kundër tina edhe pse s'po na lejohej ta  
10 përmend emrin. Po, ky ka qenë në zyrën time dhe kemi fol në  
11 gjuhën shqipe me të. Bukur mirë e ka ditë e ka ditë gjuhën  
12 shqipe.

13 Py. Foli shqip. Po hetuesi tjetër nuk foli shqip. Ishte  
14 oficer suedez; apo jo?

15 Pë. Po, suedez.

16 Py. Biseda juaj me oficerin e parë ishte në gjuhën shqipe  
17 vetëm; apo jo?

18 Pë. Shumë e vërtetë. Shumë e saktë.

19 Py. Oficeri që fliste shqip, a ju tha se i kishte ndjekur  
20 lajmet --

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar, nuk kam kundërshtuar  
22 disa nga pyetjet udhëheqëse që ka dhënë Mbrojtja, po tani po  
23 jep vetëm pyetje udhëheqëse, kështu që do i lutesha, ju i  
24 nderuar, që t'i kërkonit që të riformulojë pyetjet.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem,



1 mos e udhëhiqni dëshmitarin, zoti Rees.

2 Z. REES: [Përkthim]

3 Py. Çfarë tha oficeri që fliste shqip për lajmet?

4 Pë. Oficeri i nderum, në takimin e parë më ka përsëndet  
5 "Mirëdita", "Mirëdita". Më ka pyet "A je Hysni Gucati? I kam  
6 tregu se "Po, unë jam vetë". Ka hi mbrena është ulë dhe ja kam  
7 qitë një kafe për mirësjellje. Se ne shqiptarët e kemi zakon  
8 kur vjen miku mbrena i qesim dhe një kafe. Dhe kemi biseduar  
9 bisedën me të -- kemi fillu në bisedë e sipër dhe ai me pyet  
10 më thotë "Kam dëgjuar mbrëmë përmes lajmeve, televizionit që  
11 ka mbërri edhe paketa e dytë në Organizatën e Veteranëve të  
12 Luftës. Kjo ka qenë.

13 Dhe s'ka nevojë mu të më dirigjon Avokati se çka flas apo  
14 të ma prin punën, i nderum Gjyqtar.

15 Py. A ju tha gjë për emrat?

16 Pë. Singerisht, unë dua ta falënderoj tash pi këtuja pse  
17 s'kam dëshirë ta falënderoj, po do ta falënderoj shumë. Ai  
18 njeri më thotë "Unë të falënderoj ty edhe stafin tënd që asnjë  
19 emër s'e keni përmend të dëshmitarëve shqiptarë". Kjo ka qenë  
20 bukfalisht që ma ka thënë gjuhën shqipe [REDAKTUAR].

21 Py. Çfarë diskutuat me të për --

22 Pë. Ne me të diskutuam --

23 Py. -- për personat që kishin dorëzua dokumentet në OVL UÇK-  
24 në, në objektin e OVL UÇK-së?

25 Pë. Ai më sugjeroi mua se "Nëse vjen ndonjë paketë është mirë

1 që ju të na lajmëroni neve" dhe më sugjeroi mua që "Është mirë  
2 të mos merreni me këto dokumentacione dhe të mos bëhen publike  
3 këto dokumentacione". Me gojë më ka thënë. Dhe prapë po e  
4 përsëris, të jeni të kujdesshëm në deklaratat e tyre dhe në  
5 emrat e tyre. Kjo ka qenë shumë e sigurtë që më ka thënë ai  
6 mu. Unë, përgjigja ime ka qenë "Ne nuk jemi hetues. Ne nuk  
7 jemi polic. Ne s'punojmë në Gjykatën Speciale dhe ne s'e kemi  
8 obligim t'i ruajmë dokumentacionet e askujt. Çdo person apo  
9 çdo institucion e ka për obligim të ruajë dokumentacionin e  
10 vet".

11 Py. Pra, çfarë diskutuat me oficerin që fliste shqip për  
12 personat që kishin sjellë dokumentet në objektin e OVL UÇK-së?  
13 Çfarë diskutuat me oficerin që fliste shqip?

14 Pë. Ne me të që flitëm shqip, unë i tregova dhe i kërkova  
15 ndihmë. "Ju lutem ejani dhe zbuloni personin në fjalë. Kush po  
16 i sjell këto dokumente, nga po rrjedhin këto dokumente?" Ai më  
17 tha "Nuk është në kompetencën time që unë pa marrë urdhër prej  
18 së larti nuk mund të përcjelli askënd për këtë dokumentacione  
19 kush i sjellë në Organizatën e Veteranëve".

20 Py. A i bëtë ndonjë sugjerim për mënyrën sesi mund t'i kapte  
21 personat përgjegjës?

22 Pë. Po, se vendi ku ne punojmë, jetojmë nuk është vend i  
23 madh. Një kryeqytet i Evropës, një Berlin, një Londër apo  
24 ndonjë qytet me miliona. Po është vend shumë i vogël. Dhe aty  
25 ku jem ne, në atë objekt, është vetëm një rrugë që kalojnë

1 makinat me tri traka. Kështu që, ka qenë shumë punë e lehtë e  
2 çdo polici apo çdo hetuesi që ta kontrollon atë pjesë se kush  
3 po i sjellë ato dokumentacione. Se është edhe në vëzhgim të  
4 kamera. Të gjitha lokalet përreth kanë kamera.

5 Py. Ju keni kamera CCTV në objektin, kamera sigurie në  
6 objektin e OVL UÇK-së?

7 Pë. Po, e vërtetë është.

8 Py. A e ftuat oficerin që fliste shqip t'i merrte  
9 regjistrimet e kamerave të sigurisë?

10 Pë. Po, shumë e vërtetë. Fatoni është njeriu i parë që i ka  
11 thënë "I nderum nëse jeni të interesum ja ku i kem kamerat  
12 mundi t'i merrni të gjitha, çdo material që ju iu intereson".  
13 Dhe ai për momentin thotë "Nuk kam të drejtë të marrë unë  
14 kurrfarë kamere apo incizim pa e pyetur dikën më lartë se ai".

15 Py. A diskutuat me hetuesin që fliste shqip kalimin e  
16 dosjeve, për t'ia kaluar atij dosjet?

17 Pë. Oficeri që fliste shqip, ai tregoj se "Ne jemi ardhë të  
18 marrim dosjet". Ne i kemi thënë që "Dosjet nuk merren pa ardhë  
19 dhe Policia e Kosovës". Kështu ka qenë.

20 Py. Si iu përgjigj ai kësaj?

21 Pë. Këtu pa e mohu asnjë pikë asnjë presje, zotni në fjalë  
22 tha "Ju mund t'i mbani këto dosje edhe një muj ditë në  
23 tavolinat e juve, në zyrat e juve, po Policia e Kosovës nuk  
24 vjen të jetë vëzhguese në këto zyra për këto dokumente".

25 Py. Kush ishte tjetër i pranishëm gjatë këtij takimi me

1 hetuesin që fliste shqip, pra, kush ishte tjetër i pranishëm?

2 Pë. Është fjala nga Organizata e Veteranëve apo nga hetuesit?

3 Py. Nga organizata juaj.

4 Pë. Po. Isha unë, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Faton

5 Klinaku, nëse s'gaboju, Metush Kryeziu. Mund të jetë dhe Pren

6 Marashi, nëse s'gaboju gjithmonë, po besoj që edhe ai ka qenë.

7 Kështu që ishim një rreth i shokëve tonë, të kryesisë tonë,

8 gjithmonë që punojmë aty në atë organizatë dhe si jemi anëtarë

9 të këshillit drejtues.

10 Py. Hetuesi që fliste shqip, a i mori dokumentet në fund të

11 takimit?

12 Pë. Mbasi ka ardhë Tom Gashi, që është avokat i organizatës -

13 ka qenë - tu e falenderu punën e tij edhe veprat për neve që

14 ka punuar njeri dhe, me këshillën e Tom Gashit, ne në

15 prezencën e Avokatit kemi pranuar që t'ia japim

16 dokumentacionin.

17 Py. Pra, ai erdhi tek zyrat, ju dha këshillat dhe ju i

18 dorëzuar dokumentet. Më pas u bë një intervistë e shkurtër, ku

19 ishit i pranishëm, kur Tom Gashi i foli anëtarëve të shtypit;

20 a është saktë? A është kështu?

21 Pë. Po saktë. Unë dhe Tom Gashi kemi dalë para mediave dhe

22 kemi fol. Saktë është.

23 Py. Më 22 shtator, u kthyet në zyrë; e saktë?

24 Pë. E saktë.

25 Py. Kur e morët vesh që ishin dorëzuar paketa e tretë e

1 dokumenteve në zyrë?

2 Pë. Real më 22 shtator, atëherë nuk ka pasë paketë. Ka pasë,  
3 me sa kam pa gjithmonë në kamerë, personi ka dalë nga lifti  
4 dhe i ka gju dokumentet në korridor. Ka hjek pi palltos, prej  
5 një jakne që ka pasë. Dhe i ka pasë disa qindra dokumente. Jo  
6 shumë. Dhe i ka gju në korridorin e organizatës në tokë.  
7 Kështu që është edhe incizimi, besoj se e keni dhe ju. Shihet  
8 shumë qartë, shumë mirë si ka dalë nga lifti i ka gju ato  
9 dokumentacione në korridorin tonë në dysHEME.

10 Py. Si e mësuat ju si kishte ndodhur kjo? Nga e morët vesh që  
11 kishte ndodhur kjo?

12 Pë. E mora vesh nga punëtorët që punojnë brenda në  
13 organizatë. Se unë isha në zyrën time duke pritur një mysafir  
14 dhe isha në zyrë dhe kam marrë vesh nga punëtorët e  
15 organizatës.

16 Py. Kush tjetër i pranishëm në zyrat e OVL UÇK-së atë  
17 paradite kur erdhi dorëzimi i tretë, kur ndodhi dhe dorëzimi i  
18 tretë?

19 Pë. Me sa më kujtohet ishin të gjithë punëtorët atë ditë. Se  
20 shtator, tani filluam mbasi na ndodhën këto ndodhi papritma  
21 neve, kanë ardhë të gjithë punëtorët në zyrë që punojmë aty në  
22 Organizatë të Veteranëve edhe për shkaqe të sigurisë tonë kanë  
23 ardhur edhe kanë ardhur të gjithë. Kështu që, me emra muj të  
24 gaboj, po kanë qenë të gjithë. Prej Fatoni të gjithë kemi  
25 qenë. Dy sekretarët, pastruesja, punëtorë të tjerë, do të

1 thotë, kemi qenë të gjithë në punë atë ditë.

2 Py. A kishte ndonjë person tjetër të pranishëm që nuk është  
3 pjesë e OVL UÇK-së kur u bë dorëzimi i tretë?

4 Pë. Ka mundësi që të ishte. Nëse ka mundësi të ma përkujtoni  
5 shkrimin dikund po besoj se ka pasur.

6 Py. Shihni paragrafi 46 të dëshmisë suaj. Lexojeni vetë pak.

7 Pë. Po, është e vërtetë. Po në zyrën e Nasimit kanë qenë  
8 KFOR-i gjerman atë ditë. Ka qenë takim i rregullt që e mbajmë  
9 me KFOR-in gjerman. Se nga Organizata e Veteranëve është Nasim  
10 Haradini i ngarkum që mban takime me KFOR-in në Kosovë, me  
11 pjesëtarë të KFOR-it pa dallim se të cilit shtet janë. Është  
12 Nasimi. Po. Shumë e vërtetë.

13 Py. A e patë personin që bëri dorëzimin, pra, Rrufenë 3?

14 Pë. Jo, jo. Të jem i sigurtë vetëm përmes kamerave e kam pa.  
15 Përmes incizimit të kamerave tona që është në organizatë e kam  
16 pa.

17 Py. A dëgjohet gjë nga incizimet e kamerave të sigurisë? A  
18 dëgjuat gjë nga incizimet?

19 Pë. Besoj se diçka dëgjohet. Besoj se po. Se unë me kamera  
20 shumë jam në atë drejtim i dobët. Punon punëtori, se punëtori  
21 e njeh mirë këtë drejtim, këtë teknologji. Dhe po. E kanë pa  
22 edhe hetuesit e Gjykatës Speciale, i kanë pa kamerat të gjitha  
23 dhe i kanë marrë incizimet. [REDAKTUAR]. Më falni, hetuesi i  
24 ka marrë incizimet të gjitha.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I nderuar, dëshmitari ka

1 përsëritur për herë të tretë emrin pa ja pyetur, prandaj duam  
2 t'i kërkojmë të akuzuarit të mos përmendë në publik emrat e  
3 stafit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dua t'ju  
5 theksoj edhe njëherë se nuk duhet të përdorni emrat. Në qoftë  
6 se doni t'i përdorni duhet të redaktojmë dëshminë tuaj. Ju  
7 lutem, kushtoni vëmendje dhe mos përdorni emrat.

8 I AKUZUARI Gucati: Kërkoj falje.

9 Z. REES: [Përkthim]

10 Py. Çfarë tha burri që bëri dorëzimin e tretë, Rrufeja 3,  
11 çfarë tha kur bëri dorëzimin?

12 Pë. Gjithmonë flas ato çka kam dëgju pi dikujt, se jo që kam  
13 dëgju unë kështu afër, ai thotë që "Në të ardhmen do të sjelli  
14 CD". Kjo ka qenë fjala e tij e fundit që "Në të ardhmen do të  
15 sjelli CD". Dhe ku i merr ato CD, nuk e di unë. Ka i ka marrë  
16 nuk e di, po kështu thotë që "Në të ardhmen do t'ju sjelli  
17 CD".

18 Py. A i shqyrtoat materialet që kishte sjellë ai atë ditë me  
19 persona të tjerë në OVL UÇK?

20 Pë. Me u bë i singertë, nuk i kemi këqyrë shumë se dikur  
21 është bë ajo farë pune monotone, po në prezencën e KFOR-it  
22 gjerman po. Edhe KFOR-i gjerman ka fotografu një pjesë të  
23 tyne, jo shumë, shumë pak ka fotografu KFOR-i gjerman në zyrën  
24 time. Po e kemi këqyrë, një pjesë e kemi këqyrë. Po jo, do të  
25 thotë, dikund as 20 faqe se ajo çka u duk këtu kanë qenë

1 përmes televizionit që propozim Aktakuza, nëse s'gaboj, e zotit  
2 President, zotit Hashim Thaçi me shokë. Kështu që s'na ka hi  
3 në punë që të bëjmë diçka, ndonjë hulumtim. Me sa gjithë e  
4 kuptoj ashtu ka qenë.

5 Py. A mori ndonjë foto, imazhe të dokumenteve në atë fazë? U  
6 bëri njëri foto në atë fazë dokumenteve?

7 Pë. Mesa më kujtohet jo. Përjashtim KFOR-i gjerman që ka  
8 fotografu me ato dokumente. Dikush s'e di që ka marrë foto aty  
9 pi neve. S'ka marrë kërrkush.

10 Py. Çfarë vendosët të bëni me dokumentet?

11 Pë. Të njëjtë si me rastin e parë, me rastin e dytë. Të  
12 njëjtë kena vendosë. Kemi mbajtur konferencë për shtyp. I kemi  
13 qit në tavolinë. Kanë qenë mediat. Kanë fotografu mediat, kanë  
14 marrë. Kjo ka qenë e njëjtë. Rutina e njëjtë si në konferencën  
15 e parë dhe e dyta.

16 Py. Përveç anëtarëve të OVL UÇK-së dhe gazetarëve, a ishte  
17 njeri tjetër i pranishëm në konferencën për shtyp?

18 Pë. Të jem i sigurtë, unë s'e kontrolloj atë pjesë se kush  
19 hynë në organizatë për konferencë. Është i ngarkuar, që  
20 thashë, ne i kemi sekretarët. Unë kam rolin tim si kryetar.

21 Kështu që nuk e kam -- unë s'kam vërejtë, kështu dikush s'më  
22 ka thënë që ka qenë dikush jashtë mediave apo ndonjë mysafir i  
23 paftum.

24 Py. A ishte përgatitur gjë me shkrim para konferencës për  
25 shtyp që do të lexohej gjatë konferencës?



1 Pë. Jo. Ne zakonisht kur ftojmë mediat, kur kemi me media, ne  
2 nuk përgatisim diçka me shkrim se nuk i dimë pyetjet që do të  
3 na i bëjnë mediat. Asnjë seancë ka qenë diçka e përgatitun me  
4 shkrim. Kështu që kemi folur gjithmonë me hamendjen tonë, me  
5 ato që na kanë ndi zemra dhe truni që na ka punuar. Jo, nuk  
6 kemi pasë asgjë diçka të shkrueme. Jo, përgatitje s'kemi pasë  
7 diçka.

8 Py. Ku u vendosën dokumentet?

9 Pë. Po shifet shumë mirë, shumë qartë. Dokumentet janë  
10 vendosur në tavolinë. Kështu që kemi qenë transparencë. Ne nuk  
11 kemi dashe të mshefim asgjë. Asnjë letër, asnjë rresht të  
12 atyne. Të gjitha kanë qenë në tavolinë. Secili kush ka dasht  
13 pi dëshirës së vet merr çka donte t'i shikonte ato dokumente.

14 Py. A u morën shumë faqe nga gazetarët?

15 Pë. Të jem i singertë nuk e di sa kanë marrë. Kanë marrë një  
16 pjesë, po sa kanë marrë nuk e di. Një pjesë ka mbetur në  
17 Organizatë të Veteranëve. Po sa kanë marrë nuk e di dhe nuk e  
18 di kush ka mujt merr pi mediave diçka se s'e kam vërejtë. S'ka  
19 qenë në atë momendin tim që t'i përcjelli mediat se çka do të  
20 marrin apo çka janë të interesum të marrin prej tyne. Tonat  
21 kanë qenë ato pyetjet që na i kanë bë ata neve dhe ne si  
22 përgjigjemi.

23 Py. A patë kamera, pra, përfaqësuesit e mediave a kishin  
24 kamera?

25 Pë. Konferencën e tretë, salla ka qenë përplot kamera. Plot

1 video ka pasë. Ka pasë shumë. Po edhe medime ka pasë shumë.

2 Besoj që ka pasë edhe disa medime të huaja. Kështu që, po, ka  
3 pasë shumë. Është e vërtetë.

4 Py. A mori pjesë ndonjë nga ZPS-ja?

5 Pë. Me sa më kujtohet mu, jo. Jo. Jo, nuk e di. Nuk e besoj.

6 Jo, jo.

7 Py. Sa kohë pas konferencës për shtyp erdhën hetuesit e ZPS-  
8 së?

9 Pë. Mendoj dikun 30 minuta mbasi e kemi përfundue konferencën  
10 për shtyp, kanë ardhur prapë të njëjtit hetues në Organizatën  
11 e Veteranëve.

12 Py. Pra, hetuesi që fliste shqip, hetuesi suedez erdhën  
13 përsëri pak kohë më pas. A kishte ende ndonjë person të  
14 shtypit në atë fazë të pranishëm?

15 Pë. Muj të them me plotë përgjegjësi se po. Kanë qenë dikund  
16 mbi 70 për qind e atyne mediave kanë qenë aty prezent kur kanë  
17 qenë hetuesit. Është edhe transkripti, është edhe incizimi që  
18 muj me pa në korridorin e organizatës që ka qenë. Po, ka pasë  
19 bukur mirë medime të Kosovës apo edhe të huajat.

20 Py. Po i flisnit personave të shtypit, kur mësuat se kishin  
21 ardhur përsëri hetuesit e ZPS-së në zyra, në ambiente?

22 Pë. Po në fillim hetuesit kanë hi në zyrën time dhe mediat  
23 kanë hi në zyrën time. Dhe unë i kam qit përjashta për shkak  
24 se hetuesit s'pranojshin të folshin para mediave dhe i kam  
25 largu nga zyra ime mediat. Dhe kemi fol ne me hetuesit, unë,

1 Nasimi, Fatoni edhe disa kolegë mbrena që kemi qenë me [e  
2 pakuptueshme] shumë me hetuesit e Gjykatës Speciale.

3 Py. Çfarë ndodhi me materialet nga konferenca e shtypit? A  
4 mbetën me ju apo i morën oficerët e ZPS-së?

5 Pë. Mbas një debati që kemi pasë me ta, tu e falenderu edhe  
6 avokatin Tomën prapë, ne e kemi pranuar që t'jua japum ato  
7 dokumentacione të cilat kishin mbetur. Nuk kanë qenë shumë.  
8 Kanë qenë dikun nga 150 faqe muj të them. Ndoshta mund të jenë  
9 ma tepër. Nuk e di ma shumë. Po kështu që gjithë ai material  
10 që ka qenë aty, e kanë marrë hetuesit e Gjykatës Speciale.

11 Py. Më 25 shtator, atëherë ishit i pranishëm ku oficerët e  
12 ZPS-së erdhën përsëri në zyrat e OVL UÇK-së; apo jo?

13 Pë. Këtë datë s'muj ta harroj unë kurrë, as orën, as minutat  
14 e kësaj ore, as ditën e 25 shtatorit. Ditë e premte. Jo që  
15 kisha frikë, jo që e kisha diçka e ndijsha veten fajtor apo  
16 përgjegjës, po mënyra dhe ardhja e tyre nuk ka qenë e mirë në  
17 sy të opinionit në zyrat e Organizatës së Veteranëve.

18 Py. Çfarë kishte tek mënyra sesi erdhën dhe ju -- pse ça  
19 kishte të paharrueshme nga mënyra sesi erdhën tek ju?

20 Pë. Më datën 25 shtator, ata kanë ardhur pa paralajmërim. Mbi  
21 60 forca të armatosura të Njësisë Speciale të EULEX-it bashkë  
22 me hetuesin që fliste shqip dhe me zonjën Zdenka Pumper, e  
23 cila i printe atij aksioni dhe kanë hy në zyrën time dikun  
24 afër tetë vetë. Të gjithë kanë qenë me armë të gjata, me  
25 snajper automatik. Ku në atë orar unë e kisha një mysafir të

1 nderum, drejtorin e Institutit të Historisë të Kosovës.

2 Py. Thatë se më 25 shtator erdhën pa paralajmërim. A kthehemi  
3 pak hapa pas për në datën -- a kthehemi në datën 17 shtator. A  
4 e dinit ju se hetuesi që fliste shqip do të vinte në ambientet  
5 e OVL UÇK-së atë paradite?

6 Pë. Jo, s'kam besuar dhe s'kam menduar që do vjen.

7 Py. Pra, a kishit paralajmërim më përpara që do të vinin në  
8 datë 17 apo jo? Ju kishin njoftuar se do të vinin në datë 17  
9 shtator apo jo?

10 Pë. Jo, jo s'na kanë lajmëruar.

11 Py. Tani në datën 25 shtator, oficerë të ZPS-së erdhën tek  
12 zyrat. Po a ju thanë pse ishin të pranishëm aty?

13 Pë. Ata më thanë që unë isha i arrestum. Ma dërguan një ftesë  
14 që nga ky moment jam i arrestum nga Gjykata Speciale dhe kaq  
15 në fillim.

16 Py. Kush ishte tjetër i pranishëm kur u arrestuat, kur ju  
17 arrestuan?

18 Pë. Në zyrë vetëm unë kam qenë dhe drejtori i Institutit të  
19 Historisë së Kosovës. Askush tjetër. Për momentin. Ishin  
20 punëtorët në zyra të veta, po në zyrën time s'kishte.

21 Py. Çfarë ju thanë se ishin synimet e tyre sa i takon zyrave?  
22 A thanë që do bënë diçka tek zyrat?

23 Pë. Mbasi ma treguan fletë-arrestin mu, më tregun edhe një  
24 fletë tjetër, një dokument, që thanë "kena urdhër të bastisim  
25 Organizatën e Veteranëve të Luftës ta kontrollojmë dhe ta

1 ftojë unë, Nasim Haradinin, Tom Gashin që të jenë prezent në  
2 bastisjen e organizatës”.

3 Py. A ju thanë nëse ju lejohej ju vetë të ishit i pranishëm  
4 gjatë kohës që do të bëhej bastisja?

5 Pë. Jo. Mu më thanë nuk ke të drejtë të jesh i pranishëm këtu  
6 se je i arrestum. Dhe mu mbas 40 minutash, nëse s’e gaboje, më  
7 kanë largu nga zyra ime dhe më kanë çuar në zyrën e Nasim  
8 Haradinit, në zyrën e nënkryetarit.

9 Py. Tom Gashi ishte më pas i pranishëm gjatë bastisjes; apo  
10 jo?

11 Pë. Po ishte Tom Gashi dhe Faton Klinaku.

12 Py. Por juve ju larguan dhe ju çuan -- pastaj ju transferuan  
13 drejt Hagës; apo jo?

14 Pë. Po mu më larguan dhe më çuan në aeroportin e Prishtinës,  
15 në një qendër parandalimi dhe prej aty më dërguan në Hagë.

16 Py. A e mbështesni drejtësinë, e përkrahi drejtësinë?

17 Pë. Unë me shokë të mi, me të gjithë pjesëtarët e UÇK-s, me  
18 në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, kemi luftuar  
19 për padrejtësi dhe kemi luftuar për me pru drejtësi në vendin  
20 tonë, në Kosovën tonë, e cila ka qenë e shtypur dhe me plotë  
21 bindjen time jam që ta përkrahi drejtësinë deri në vdekje.

22 Po t’i kisha edhe 100 vjet ymër, mbas këtyne viteve që i  
23 kam 54, këtë Gjykatë, kam thënë me kohë, nuk e përkrahi për  
24 arsye që dihen, po drejtësinë do ta përkrahi deri në vdekjen  
25 time, se e di çka do të thotë fjala drejtësi dhe e di çka do të

1 vendoset me drejtësi. Për këtë arsye do ta përkrahi  
2 drejtësinë.

3 Py. Në fillim të gjykimit dëgjuat Prokurorin e Specializuar  
4 që tha, që ishte në rregull, është okej ta kritikosh, ta  
5 qortosh këtë Gjykatë dhe të thuash pse. Na thuaj pse e  
6 kritikoni këtë Gjykatë?

7 Pë. Nëse ne e kemi kriju për mendimin ndryshe dhe për fjalën  
8 e lirë, atëherë kam të drejtë ta shprehi fjalën e lirë.  
9 Mendimi im dhe i shokëve të mi dhe i qytetarëve të Kosovës  
10 është që kjo Gjykatë është duke bashkëpunuar me armikun e  
11 vendit tim, me armikun e kombit tim, është duke bashkëpunuar  
12 me kriminelët serbë të cilët i ndjek Interpoli. Kjo është  
13 arsyeja pse ne e kundërshtojmë këtë Gjykatë.

14 Pse kjo Gjykatë Speciale nuk e bën zbulimin e masakrave  
15 në Kosovë, Mejë, Qyshk, Prekaz, Likoshan, Qirez, Rrëzallë,  
16 Izbicë e shumë e shumë masakra në Kosovë, mbi 460 masakra. Po  
17 kjo Gjykatë nëse më bind mu edhe shokët e mi edhe qytetarët e  
18 Kosovës që bën zbulimin e të gjitha krimeve që kanë ndodhur në  
19 Kosovë, pavarësisht, kusht janë ata shqiptarë, serbë, romë,  
20 turq apo ashkali, unë do ta përkrahi me gjithë bindjen time.  
21 Por derisa kjo Gjykatë s'ka arrit që bindë mu edhe shokët e mi  
22 që s'është duke i zbuluar ato krime që i përmenda unë, atëherë  
23 si vallë ta përkrahi këtë Gjykatë unë, kur është Gjykatë e  
24 njëanshme.

25 Le të më tregojnë mu Prokurori i Gjykatës Speciale Jack

1 Smith nëse në univers ekziston një gjykatë e një etnia sot do  
2 ta nënshkruaj gabimin që e kam gabu unë për atëherë. Kaq kam.  
3 Py. A e pranoni se keni vepruar në mënyrë të paligjshme gjatë  
4 kësaj periudhe, pra, nga data 7 shtator deri në fund të  
5 shtatorit të vitit 2020?

6 Pë. Unë nuk besoj se kam gabuar. Për arsye unë s'kam lexuar  
7 deklaratat e asnjë dëshmitari. S'kam përmend asnjë dëshmitar,  
8 pavarësisht dy-tre serbëve që janë zyra publike, fytyra  
9 publike që janë dhe punojnë në zyrat e Serbisë, ata i kam  
10 përmend. Kështu që, unë besoj se plotësisht jam i pafajshëm.  
11 Unë dhe shokët e mi edhe Nasim Haradini jemi të pafajshëm, ne  
12 e kemi mbrojtur interesin e bashkëluftëtarëve tonë, interesin  
13 e vendit tonë dhe kombit tonë. Kështu që, unë prapë po them,  
14 nuk besoj që jemi të fajshëm në këtë drejtim.

15 Py. A keni kërcënuar ndonjë dëshmitar ju gjatë kësaj periudhe  
16 duke filluar me datën 7 shtator deri në fund të këtij muaji?

17 Pë. Jo unë, si Hysni apo si kryetar i veteranëve, po asnjë  
18 koleg i imi, asnjë anëtar kryesie, as Nasim Haradinaj, as  
19 Faton Klinaku, nuk ka dëshmitar që mundet të na del përpara.  
20 Dhe bëj thirrje nga kjo seancë këtu ku jam, le të vijnë ata  
21 dëshmitarë dhe le të thojnë që Hysni Gucati, Organizata e  
22 Veteranëve të Luftës më ka kërcënu. Ju bëj thirrje të gjithë  
23 atyre dëshmitarëve që kanë rrejtë para Gjykatës Speciale dhe  
24 Prokurorit Special, të vijnë dhe le të më thotë në prezencë të  
25 juve që "Hysni Gucati më ka kërcënu apo Nasim Haradinaj". Këtu

1 e ndi veten shumë i sigurt, shumë i pafajshëm unë dhe shokët e  
2 mi.

3 Py. A jeni hakmarrë kundrejt ndonjë personi lidhur me dhënien  
4 e provave prej tyre?

5 Pë. Kurrë në jetën time nuk ekziston në memorien time  
6 hakmarrja. As në familjen time nuk ekziston. Po të isha  
7 hakmarrë unë -- unë jam i plagosur më 2 qershor 1999. Serbët  
8 jetojnë në Kosovë kur të kisha dashë, kisha mujt të hakmerrem.  
9 Po nuk mendoj të hakmerrem. Unë kam qenë në luftë për çlirimin  
10 e vendit dhe hakmarrja nuk qëndron në trurin tim dhe të  
11 familjes time.

12 Py. A keni ndërmarrë veprime për të dëmtuar dëshmitarët?

13 Pë. Unë nuk besoj se kam marrë ndonjë veprim me dashje për ta  
14 dëmtu ndonjë dëshmitar. Unë kam marrë veprime që kam deklaruar  
15 këto dokumentacione pa përmend emër, pa e lexuar një deklaratë  
16 një dëshmitari. Në të gjitha mediumet, në të gjitha  
17 televizionet kam deklaruar që këto dokumentacione rrjedhin nga  
18 Gjykata Speciale dhe kam dashtë ta bindi opinionin tim, që ne  
19 që kemi thënë, që Gjykata Speciale është duke bashkëpunuar me  
20 kriminelë dhe me ordinerë që kanë qenë ndaj vendit tim dhe  
21 kombit tim.

22 Py. A keni nxjerrë ju identitetin e ndonjë dëshmitari?

23 Pë. Prapë po bëj thirrje, nëse një dëshmitar e ndjen veten që  
24 Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe shokët e mi kanë nxjerrë një  
25 emër dhe një mbiemër të një dëshmitari shqiptar apo një



1 dëshmitari rom, apo një turk apo një boshnjak që jetojnë në  
2 Kosovë, i bëj ftesë të lajmërohet në Gjykatën Speciale. Unë  
3 jam i hapur të ballafaqojna me atë. Kjo është përgjigja ime.  
4 Py. Atëherë, ju lutem, na jepni një përgjigje të  
5 drejtpërdrejtë. A keni nxjerrë ju identitetin e ndonjë  
6 dëshmitari; po apo jo?  
7 Pë. Unë [REDAKTUAR]. Këta janë  
8 emra të cilët i kam përmend, që  
9 [REDAKTUAR] është deputet i parlamentit serb, është  
10 kryetar i komisionit për krime lufte be Serbi. Vukçeviçi ka  
11 qenë prokuror i gjykatës speciale te Serbisë për krime lufte.  
12 Dhe emrat e ish-pushtetarëve te Serbisë te cilët kanë qenë  
13 komandant, apo kanë qenë prijës të masakrave në Kosovë. Këta  
14 janë që kam përmend emrat, 3-4 emra serbë. Kjo është reale.  
15 Emra shqiptarë, turq, romë, boshnjakë, nuk kam përmend kurrë  
16 në jetën time.  
17 Py. A keni synuar që ta nxisni ndonjë dëshmitar që të  
18 përmbahet nga dhënia e dëshmisë? Te mos japë dëshmi d.m.th.  
19 Pë. Jo. Te unë janë lajmëruar shumë veteranë që ka ftuar  
20 Gjykata Speciale për me japë dëshmi. Asnjë njeri nuk ka që,  
21 unë i kam mësuar apo kam dirigju ça të flet, a mos shkon të  
22 japë dëshmi në Gjykatën Speciale. Përkundrazi, në gazetatat e  
23 shkruame në Kosove elektronike, në gazetën "Epoka e re", unë  
24 baj thirrje atyne dëshmitarëve, për hir të shtetit tim, për  
25 hir të luftës, për hir të dëshmoreve, që të bashkëpunojmë në

1 këtë drejtim, për me i zbulu të gjithë ata kush ka kry krime.  
2 Kjo ashte reale. Gazetën e keni, mund edhe ta shihni. Jam edhe  
3 në transkriptet e televizionit që kam bo thirrje.  
4 Py. A keni ushtruat presion mbi gazetaret që të nxirrnin apo  
5 të botonin ndonjë informacion konfidencial?  
6 Pë. Kurrë në jetën time asnjë gazetar. Të gjithë i njoh. Të  
7 gjithë i njoh, që kam takime me ta, kam pas shumë. Cilido  
8 gazetar le të thotë që Hysni Gucati apo Nasim Haradinaj, apo  
9 dikush nga Organizata e Veteranëve, na ka vu një presion, apo  
10 një kërcënim, apo një shtytje, apo një elmosh, për të nxjerrë  
11 emra apo deklarata në gazetata e tyre, apo në portalet e tyre.  
12 Py. A menduat se, duke informuar shtypin përmes këtyre  
13 konferencave për shtyp lidhur me materialet, që kjo gjë mund  
14 të kishte ndikim negativ mbi dëshmitarët?  
15 Pë. Të jem i singertë nuk kam menduar në atë drejtim, për  
16 arsye se mbasi s'përmendi emrat e dëshmitareve dhe nuk kam  
17 lexu deklaratat e tyre, ka mendu që nuk e dëmtoj as Gjykatën  
18 Speciale, po as dëshmitaret. Se unë nuk kam lexu asnjë  
19 deklaratë të tyre, asnjë emër të tyre, asnjë adresë të tyre,  
20 asnjë fshat ku jeton, asnjë --. Nuk i kam përmend në të gjitha  
21 takimet televizive që kam pas. As unë, as Nasimi, askush.  
22 Kështu që s'ka qenë në domenin tim që unë te deklaroj apo të  
23 dëshmoj në televizione për dëshmitarë. Ajo le të jetë në  
24 ndërgjegjen e tijna dhe ndërgjegjen e Gjykatës ta zbulon të  
25 vërtetën, a është dëshmitar i vërtetë, apo dëshmitar që rren.

1 Kështu që me ato, jo s'jam merr. Nuk kam pas nevojë të merrem  
2 fare.

3 Py. A jeni përpjekur ndonjëherë që të dëmtoni ndonjë person  
4 përmes këtyre dokumenteve?

5 Pë. Të jeni të bindur, as që mendoj, se jo me u përpjek, por  
6 as që mendoj që ta dëmtoj ndonjë person apo ndonjë dëshmitar  
7 te Gjykatës Speciale. Po të kisha dashtë, e kisha mundësinë.  
8 Dhe kjo është arsyeja ime, s'është në interesim tim, as në  
9 interesin e Organizatës së Veteraneve të Luftës që ta dëmtojmë  
10 ndonjë dëshmitar që dëshmon në Gjykatën Speciale. Kështu që ne  
11 nuk kemi mendu fare në atë drejtim, hiç.

12 Py. Kur u krijuan Dhomat e Specializuara, si e kuptove ti sa  
13 i takon bashkëpunimit ndërmjet Zyrës së Prokurorit të  
14 Specializuar dhe autoriteteve serbe? Si menduat juve që do të  
15 ishte pozicioni, si do të realizohej ky bashkëpunim?

16 Pë. Real, ne e kemi kuptu qysh në vitin 2015, që do të  
17 formohet një Gjykatë Speciale për krime lufte dhe ne kemi  
18 mendu që kjo Gjykatë Speciale do të jetë në favorin e të  
19 gjithë qytetarëve të Kosovës. Dhe ne kemi mendu që kjo Gjykatë  
20 Speciale do të bëj zbulimin e të gjitha krimeve në Kosovë. Dhe  
21 ne na doli e kundërta, kjo Gjykatë Speciale na doli pa  
22 dëshirën tonë, pa vullnetin tone. Dhe kështu që ne u bindëm që  
23 kjo Gjykatë Speciale është në dëmin tone dhe është duke  
24 bashkëpunuar me kriminele serb dhe kjo është arsyeja që ne  
25 ishim kundërshtarë të sajna.

1 Py. A keni kërcënuar ndonjë anëtar të stafit te ZPS-se gjatë  
2 periudhës së shtatorit të vitit që shkoi?

3 Pë. Jo, më vjen shumë keq. Shumë keq më vjen. Se e thashë, po  
4 më imponohet të përmendi emrin e dëshmitarit, por prapë s'do  
5 ta përmendi, për hir të korrektësisë. Ne me hetuesit që kemi  
6 pas takime, falë zotit se ata janë gjallë dhe unë jam gjallë,  
7 Nasimi gjallë, nëse një hetues i Gjykatës Speciale apo një  
8 zyrtar i Gjykatës Speciale, e ndjen veten të kërcënum nga unë  
9 a Nasimi, pse s'vjen para kësaj Gjykate, takohemi mes katër  
10 syve dhe të më thotë që e ndiej veten të kërcënum nga Hysni  
11 Gucati apo Nasim Haradinaj, apo nga dikush tjetër. Absolutisht  
12 s'është e vërtetë kjo fare, që ne kemi tentu të pengojmë  
13 drejtësinë, pengojmë hetuesit e Gjykatës Speciale. Kurrfarë në  
14 jetë hiç. As që mendojna.

15 Py. Cili është shqetësimi juaj lidhur me DHSK-në dhe ZPS-në  
16 që marrin apo që kanë marrë prova që vijnë nga autoritetet  
17 serbe? Pse të shqetëson kjo gjë?

18 Pë. Të nderuar. Ka shumë argumente dhe fakte pse neve na  
19 shqetëson kjo puna e Gjykatës Speciale apo e Prokurorëve  
20 Specialë me kriminelët serbe. Kjo Gjykatë është e formuar nga  
21 vendi im, nga deputetët e Parlamentit tim dhe nga Qeveria ime  
22 e Kosovës. Kështu që kjo Gjykatë ishte mirë që të merret me të  
23 gjitha ato viktima dhe jo të merret me kriminelë të cilët  
24 rrejnë, bëjnë fabrikime të deklaratave të tyre, kanë marrë  
25 dëshmitarin dhe e kanë vra. Është rasti konkret ne Reçak që ju

1 tregova dhe tash deklarata e tij mund të përdoret për të keq  
2 këtu. Dhe kjo është shqetësimi jonë që kjo Gjykatë ka punuar  
3 direkt me persona që i ka marrë në pyetje, apo të japë elmoshë  
4 dhe sot nuk i gëzojnë ata njerëz. Dhe neve na shqetëson shumë  
5 ky rast dhe kjo Gjykatë. Kjo është arsyeja pse neve  
6 shqetësohemi nga kjo Gjykatë.

7 Po të punonte kjo me viktimat që supozohet, gjithmonë në  
8 thonjëza them, atëherë po. A po të punohet me njerëz tonë dhe  
9 të merren qytetarët tonë në pyetje në Prishtinë e jo në  
10 Beograd, Nish dhe Vranje, prapë unë do t'i kisha besuar asaj  
11 Gjykate. Për momentin që na i dërgon dëshmitarët në Serbi, në  
12 një vend që ka qenë okupues ndaj kombit tim dhe popullit tim  
13 dhe vendit tim, atëherë si t'i besoj unë kësaj Gjykate?  
14 Py. Dhe në qoftë se Rrufeja 1, 2 dhe 3, nëse nuk do t'i  
15 kishin sjellë dokumentet, t'i kishin bërë dorëzimet e  
16 materialeve në OVL e UÇK-se dhe le të themi në qoftë se do ja  
17 kishin vënë në dispozicion në mënyrë të drejtpërdrejtë  
18 personave që punojnë ose që flasin në televizione, a do i  
19 kishe thirrur ti këto konferenca për shtyp në këtë skenar?  
20 Pë. Jo, se s'ka qenë përgjegjësia e imja që t'i ftoj unë.  
21 Nëse shkojnë dokumentet në televizionet apo medime të  
22 ndryshme, unë nuk do të kisha thirr. Unë veç do të kisha reagu  
23 që do të kisha thënë, "Falë zotit që doli e vërteta në shesh".  
24 Kjo.

25 Py. Faleminderit z. Gucati. Ju lutem prisni pak se do të ketë

1 pyetje të tjera nga ZPS-ja.

2 Z. REES: [Përkthim] E kemi dorëzuar deklaratën për pranim  
3 sipas rregullës 154.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në  
5 rregull. Do të presim deri në fund të marrjes në pyetje, në  
6 mënyrë që të vendosim.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për konfirmim dua të them që ZPS-  
8 ja do të fillojë me marrjen në pyetje dhe besoj sipas urdhrin  
9 për procesin gjyqësor, mund të vijohet më tej me avokatin e të  
10 bashkëakuzuarit. Të paktën kështu thuhet në urdhrin e vendosur  
11 prej jush. Megjithatë në qoftë se ju thoni që duhet të vijojmë  
12 neve, nuk ka problem. Mund të vijojmë neve me marrjen në  
13 pyetje të zotit Gucati. Faleminderit.

14 [Anëtarët e trupit gjykues këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,  
16 duke marrë parasysh rrethanat, nuk e di se cila do të jetë  
17 përgjigja juaj, por thjesht dua të të pyes në qofte se  
18 dëshironi të bëni pyetje z. Gucati apo jo, në këtë moment?

19 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Duke marrë  
20 parasysh që nuk është se kam marre ndonjë udhëzim të duhur nga  
21 klienti im dhe duke qenë që nuk është se kam pasur qasje me  
22 klientin tim, do kërkoja që të bënte pyetjet më parë  
23 Prokuroria dhe pastaj të më rezervohet mua e drejta që të bëja  
24 pyetje.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në rregull. Neve mund të vijojmë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në

2 rregull. Mund të filloi zonja Prokurore.

3 Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici:

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

5 Py. Mirëdita z. Gucati. Mëngjesin e datës 7 shtator, ju nuk e  
6 dinit që do të silleshin disa dokumente në OVL e UÇK , është e  
7 saktë kjo?

8 Pë. E saktë.

9 Py. Dhe ju nuk bëtë asnjë lloj bisede me asnjë person sa i  
10 takon sjelljes së dokumenteve, apo jo?

11 Pë. Jo. Isha në zyrën time kur janë sjellë dokumentacionet.

12 Py. Ju personalisht, nuk keni folur me personin që i solli  
13 dokumentet?

14 Pë. Dëshira ime më e madhe ishte po të kisha fol e ta kisha  
15 njoft, për me jua pru juve për veshi atë këtu.

16 Py. Por nuk keni fol, e saktë është kjo?

17 Pë. Me sa unë përgjigjen e dhashë, ta kisha njoft personin,  
18 unë nuk isha këtu sot para juve, por ishte ai personi.

19 Py. Zonja Taibe Myftari erdhi dhe ju tha se çfarë i kishte  
20 thënë ky person dhe e vetmja gjë që kishte thënë ky person  
21 ishte që, çojani këtë kutinë me materiale personit që flet me  
22 median. A është e saktë kjo?

23 Pë. E saktë është. Edhe ma herët e thashë ashtu. Po.

24 Py. Dhe në mënyrë të ngjashme, në mëngjesin e datës 16  
25 shtator, as kësaj here ti nuk e dije se do të silleshin

1 dokumente në OVL e UÇK-se, a është e saktë kjo?

2 Pë. Singërisht, me singëritetin më të madh po them e saktë  
3 është, se nuk e kam ditur.

4 Py. Dhe nuk folët as kësaj radhe me personin që i solli  
5 dokumentet, apo jo?

6 Pë. Jo, jo.

7 Py. Ju thjeshte pate kurrizin, shpinën e këtij personi,  
8 ndërkohë që ai po largohej, e sakte?

9 Pë. Shume pak. Mund të them, shume pak, shume pak.

10 Py. Ne këtë kohe znj. Taibe Myftari ju tha që ky personi  
11 kësaj radhe nuk i kishte thënë askujt asnjë fjale, asgjë?

12 Pë. Me sa me kujtohet mua, jo. Ashtu ka qene.

13 Py. Dhe përsëri mëngjesin e datës 22, ti prapë nuk e pe  
14 personin që i solli dokumentet, e saktë është kjo?

15 Pë. Vetëm përmes videokamerave që kam pa, se jo, s'e kam pa.

16 Py. Ju nuk folët me të, apo jo?

17 Pë. Kurrë ne jetën time, as nuk e njoh.

18 Py. Dhe juve ju thanë që ai kishte thënë që herën tjetër do  
19 të sillte CD, apo jo?

20 Pë. Po, e vërtetë. E saktë.

21 Py. Kush ta tha ty këtë gjë? Kush e tha që ai kishte thënë që  
22 do sillte CD kur të vinte herën tjetër?

23 Pë. Kolegët e punës, të cilët kanë qenë ne zyrën e Taibes.

24 Dhe ai herën e tretë i ka lënë dokumentacionet në korridor,

25 nuk ka hy brenda. Ka hy prej liftit, ka dalë në korridor dhe i



1 ka gjujt, ka fol dhe ka ik.

2 Py. Kush ju tha juve që ai kishte thënë që herën tjetër do të  
3 sillte CD me vete?

4 Pë. Unë e thashë, koleget që e kanë pa atë, Taibja dhe gjithë  
5 kolegët që kanë qenë prezent duke përdorur kafe me Taiben në zyrën  
6 e Taibes. Se ajo është dera ballë për ballë me korridorit ku i  
7 ka e gjujt lënë dokumentacionin dhe ka bërë ai. Kjo është  
8 reale, që është edhe video që duket kur ka dalë prej liftit  
9 dhe i ka hjek dhe i ka gjujt. Kjo -- mund ta shihni në  
10 videokamer[.

11 Py. Pra Taibja të tha ty që ky personi tha që, "Kur të vij  
12 herën tjetër, do sjell CD-të".

13 Pë. Vetëm njëherë. Nuk më ka thënë direkt vetëm mua. Po ato  
14 kanë qenë 3-4 kolegë bashke me Taiben kur kanë thënë, ky  
15 zotnia i gjujti dokumentacionin në korridor dhe tha që herën  
16 tjetër do të bie CD. Kështu ka qenë. Unë nuk thashë që mu ka  
17 drejtu vetëm mua, por ajo ka tregu se çka ka një. Të jemi të  
18 kjartë shumë.

19 Py. Në rregull. Si e mësove ti, si e more vesh këtë  
20 informacion?

21 Pë. Tregova, nga shokët aty.

22 Py. Në rregull. Përveç Taibes, kush ishte tjetër?

23 Pë. Ishte Fatoni, ishte -- ishin shokët që punojnë aty në  
24 punë, sekretari teknik, pastruesja, të gjithë. Do të thotë 4-5  
25 veta kanë qenë aty në zyrë të Taibes.

1 Py. Në rregull. Po Çel Gashi, a ju tha juve që ky person kur  
2 të vinte herën tjetër do të sillte me vete CD?

3 Pë. S'e kam dëgju Çelën duke folur.

4 Py. A e mbani mend se ke keni dëgjuar ta këtë thënë këtë gjë?

5 Pë. Tash, po më vjen keq se kjo fare pyetje po bëhet shumë si  
6 bajat, kështu që themi ne në Kosove atje, e teprume. Unë po ta  
7 tregoj singëritetin tim, disa shokë bashkë me Taiben ato, kanë  
8 tregu këto fjalë. Këtë s'jam tu e qit unë prej veti, as tuj  
9 gënjye. Kjo ka qenë real. Një muaj të rrimë këtu, dy muaj këtë  
10 pyetje, këtë përgjigje ke nga unë. Kështu që vazhdo sa të  
11 duash.

12 Py. Taibja, a ka qenë e pranishme kur ty të thanë që personi  
13 kishte thënë që kur të vinte herën tjetër, do të sillte me  
14 vete CD-të?

15 Pë. Unë tregova, Taibja edhe shume shokë të tjerë aty kanë  
16 qenë edhe 4-5 vete.

17 Py. Pra, ajo ka qenë e pranishme kur ti e more këtë  
18 informacion, e more vesh këtë gjë? Apo jo?

19 Pë. Vetëm më vjen keq. Taibja, sekretarja teknike, ajo punon  
20 prej orës 9 në punë. Është real që Taibja dhe të gjithë ata  
21 kanë qenë në punë. Zotniu që e ka pru dokumentacionin e ka  
22 gjujt në korridor dhe ka fol, "dhe herën tjetër do t'ju bie në  
23 CD". Nuk kam përgjigje tjetër me të jap. Thashë, rrimë edhe 60  
24 ditë këtu dhe diskutojmë për këtë pyetje.

25 Py. Në rregull. Pra edhe Taibja e dëgjoji këtë informacion.

1 Këtë kuptova unë nga përgjigja juaj.

2 Pë. Jo, s'është e vërtetë që thashë unë vetëm Taibja. Unë  
3 thashë, 6 persona të tjerë me Taiben. Nuk është e vërtetë që  
4 unë e thashë vetëm Taibja. Të lutem. Mos e devijoni pyetjen  
5 time apo përgjigjen time. Të lutem. Unë e thashë, kanë qenë 5-  
6 6 persona të tjerë brenda me Taiben. Nuk thashë që Taibja me  
7 ka thënë. Kanë qenë ato, më kanë thënë 4-5 --

8 Py. Faleminderit për sqarimin. Pyetja ime është kjo: Taibja,  
9 a ishte e pranishme kur ti e mësove këtë informacion? A është  
10 e saktë kjo?

11 Pë. Thashë, kanë qenë Taibja dhe 5-6 persona të tjerë.

12 Py. Faleminderit. Për të qenë të qartë, të tria rastet kur u  
13 sollën dokumente në Shoqatën e Veteranëve të Luftës të UÇK, ju  
14 nuk bëtë asnjë bisedë me personat që i sollën paketat me  
15 informacion, as përpara sesa t'i sillni informacionin, as pasi  
16 i lanë paketat aty? A është e saktë kjo?

17 Pë. Nëse ka mundësi edhe njëherë pyetjen?

18 Py. Në të tria rastet kur u sollën dokumentet në OVL e UÇK-  
19 se, ju nuk keni bërë asnjë bisedë me personat që i sollën  
20 dokumentet, nuk keni folur me të, është e saktë kjo?

21 Pë. Nëse e keni fjalën me personin që ka pru dokumentacionin,  
22 unë thashë edhe ma herët, nuk e njof, nuk kam bisedu me të  
23 edhe të jeni të bindur që kurrë në jetën time atë person të  
24 pamë nuk e kam. Pavarësisht në videokamerë që e kam pa të  
25 maskuar, në video kamere që e kam pa. Kështu live s'e kam pa

1 kurrë në jetën time.

2 Py. Faleminderit. Dhe nuk keni bërë asnjë bisedë tjetër me  
3 asnjë person që pretendon të ishte përgjegjës për sjelljen e  
4 këtyre dokumenteve, a është e saktë kjo?

5 Pë. Jo, jo.

6 Py. Faleminderit. Sa i takon të tria dërgesave të  
7 dokumenteve, ju thatë që organizuat një takim me Nasim  
8 Haradinaj, me Faton Klinakun dhe anëtarë të tjerë të ngushtë  
9 të OVL së UÇK-së, pra të komitetit drejtues të Shoqatës së  
10 Veteranëve të Luftës dhe të tria herët kërkuat që të bëhej  
11 konferencë për shtyp, a ishte kështu?

12 Pë. Shumë e vërtetë.

13 Py. A diskutuat juve se cila do ishte mënyra më e drejtë për  
14 të vepruar edhe mbi bazën e kësaj pastaj morët vendimin tuaj,  
15 kështu ishte?

16 Pë. Ato që thashë ma herët po i përsëriti prapë. E drejta  
17 jonë ka qenë. Dhe ne tu u frigu që mos këto dokumentacione na  
18 kanë rënë...

19 Py. Z. Gucati, është një pyetje e thjeshtë. Ju diskutuat se  
20 çfarë do të bënit ndërmjet jush edhe vendosët se çfarë do  
21 bënit, a është e saktë kjo?

22 Pë. Ne diskutuam se çka do të bëjmë me këto dokumentacione  
23 dhe vendosem të ftojme opinionin e gjerë dhe mediat që këtu  
24 kanë -- na kanë ardh disa dokumentacione, nuk e dimë nga kush  
25 por figurojnë që janë apo supozohet që janë të Gjykatës

1 Speciale.

2 Py. Dhe askush nuk ju detyroi juve që të thërrisnit  
3 konferencat për shtyp dhe t'i ndanit dokumentet me median, a  
4 është e saktë kjo?

5 Pë. Vetëm Zoti mund të më detyron mua. Se unë jam Kryetar i  
6 asaj Organizatës të Veteraneve të Luftës. Asnjë njeri fuqi që  
7 ka, që më detyron mua që të mbaj konferencë për media për një  
8 punë të caktume. Këto nuk mundet, vetëm Zoti. Nëse besoni në  
9 Zot, kështu është mendimi jem dhe asnjë njeri tjetër.

10 Py. Dhe askush nuk duhej që t'ju bindte juve që të  
11 organizoheshin të tria konferencat për shtyp dhe t'i ndanin  
12 dokumentet me shtypin, a është e saktë kjo?

13 Pë. Unë thashë dhe një herë. Unë jam Kryetar i Veteranëve të  
14 Luftës dhe kam 2 nënkryetarë. Kështu që mua s'mund të më bindë  
15 dikush që të bëj këtë punë apo atë punë. Unë mund të  
16 këshillohem me shokë, brenda organizate, jashtë organizate. Me  
17 asnjë njeri nuk flas për punën time dhe qëndrimet e miya në  
18 Organizatën e Veteraneve të Luftës.

19 Py. Faleminderit. Kush është zëvendëskryetari i dytë i OVL së  
20 UÇK-së?

21 Pë. Dëshiroj që me se pari atij t'i -- që ai të jetë shëndosh  
22 e mirë. Është një shok i joni që është i sëmurë për momentin,  
23 ka pas sulm në tru. Është Migjen Shala, që nga ky moment i  
24 dëshiroj shërim sa më të shpejtë, që është i sëmurë dhe ana e  
25 majtë, dora, këmba dhe goja tash goja që s'mundet me fol.

1 Është Migjen Shala. Kështu që e respektoj e nderoj shumë për  
2 punën dhe veprat e tijna që ka bo në Organizatën e Veteranëve.  
3 Py. Ai nuk ishte i pranishëm me datë 7, 16 dhe 17 [sipas  
4 përkthimit] shtator 2020, apo jo?

5 Pë. Me 7 nuk e besoj se ka qenë i pranishëm. Me 16 po, se  
6 është i sëmurë. Ai është sëmurë dikun në fund të vitit apo  
7 fillim të vitit 2020, mund të gaboj tash. Në fund vitit 2019  
8 apo në fund të vitit dy mijë e -- në fillim. Është i sëmurë,  
9 kështu ai vjen ndërkohë, djemtë e bien ndërkohë tek ne. Ne  
10 shkojmë e marrim, sa për të mos e lanë në shtëpi, për arsye të  
11 mërzisë. Ne e marrim. Po, në 2016-n ai ka qenë ul në zyrën  
12 time, por ai nuk flet dhe nuk dëgjon mirë tash, si thashë edhe  
13 ma herët.

14 Py. Dhe me datë 16 shtator, ai ka qenë i pranishëm gjatë  
15 diskutimeve që bëtë juve brenda OVL lidhur me atë çfarë do të  
16 bënit me dokumentet, a e konfirmoni këtë gjë ju lutem?

17 Pë. Nuk jam i sigurt që mund ta konfirmoj, por me siguri mund  
18 të ketë qenë Migjeni. Siç ju thashë, mundeni me e pa Migjenin  
19 kushdo nga hetuesit e juaj me e vizitu. Migjeni është i  
20 sëmurë, nuk flet, nuk dëgjon dhe nuk mund me ecë. Kështu që  
21 nuk e kam problem atë punë, por me sa di, me sa më kujtohet,  
22 mund edhe të jetë. Nuk jam i sigurt në këtë, që të përgjigjem  
23 direkt për Migjenin që është i sëmurë.

24 Py. Pra, nuk ju kujtohet qartë se në cilat raste ka qenë i  
25 pranishëm?

1 Pë. Migjeni ka qenë i pranishëm ditën kur më kanë arrestu  
2 mua, ka qenë në kafe pranë organizatës, atë ditë e di. Por  
3 nëse s'gaboj, ka qenë edhe në datën 17 apo 22 shtator, tash  
4 mund të gaboj. Por e di që ka qenë, mrena muajit shtator ka  
5 qenë nja dy herë në zyrë të organizatës ka qenë.

6 Py. Faleminderit. Pas secilës herë që silleshin këto  
7 materialet, ju dhe zoti Haradinaj në mënyrë publike keni  
8 deklaruar se do të publikonit dhe do të shpërndanit të gjitha  
9 materialet që do vinin në OVL UÇK, apo jo?

10 Pë. Qysh e kuptoni ju shpërndarjen nuk e di, por unë dhe z.  
11 Nasim Haradinaj nuk kena bo shpërndarje të dokumentacionit  
12 fare. Ne e kemi lënë në organizate tonë, në tavolinën tonë, ku  
13 kanë ardhur mediat. Ne nuk i kemi thënë asnjë gazetari,  
14 "Merri" apo "Lëri". Ne nuk ia kemi dhënë asnjë qytetari ato.  
15 Unë kështu e kuptoj shpërndarjen. Ne s'kemi shpërnda  
16 dokumentacione të Gjykatës, askujt.

17 Py. Z. Gucati, pas këtyre tre herëve që u dorëzuan  
18 materialet, a keni thënë publikisht ju që, sa herë që të vinin  
19 materialet nga TPNJ-ja dhe ZPS-ja, Dhomat e Specializuara, do  
20 të vinin tek ju tek OVL UÇK-ja, ju do t'ia vinit në  
21 dispozicion shtypit? A e keni thënë këtë? Qe do t'ia vini në  
22 dispozicion shtypit?

23 Pë. Nëse është nevoja me miliona herë do ta them, nuk jam  
24 fajtor për dokumentacionin që kanë dalë nga zyrat e juve. Dhe  
25 sa herë të vine, ato do të bëhen publike. Unë nuk jam sigurim

1 që t'i ruaj dokumentacionet e askujt. Nuk punoj...

2 Py. Z. Gucati.

3 Pë. ...në sigurim, as polici.

4 Py. Z. Gucati, sa herë që vinin, ju i bënit publike dhe keni

5 thënë disa herë përballë medias që sa herë që do vinë

6 dokumente në OVL UÇK, ju do t'i bënit publike. A është e saktë

7 që e keni thënë?

8 Pë. Unë e dhashë përgjigjen time ma herët.

9 Py. A i keni thënë medias midis datave 7 dhe 22 shtator, a ia

10 keni thënë medias se do t'i bënit publike dokumentet që do të

11 vinin ne OVL UÇK?

12 Pë. Prapë e përsëriti, nuk jam sigurim i dokumentacioneve të

13 askujt, çdo dokument...

14 Py. Z. Gucati.

15 Pë. Më falni, më falni, mos ma ndërpre fjalën...

16 Py. Z. Gucati.

17 Pë. Mos më ndërpre, mos më ndërpre, të përfundoj unë. Do pres

18 edhe 10 vjet. Qe 15 muaj unë në burg, do të pres edhe...

19 Py. Mund t'i përgjigjesh kësaj pyetjes konkrete, kësaj

20 pyetjes konkrete. Është pyetje konkrete.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Gucati, po

22 ju bën një pyetje të drejtë për drejtë, që do "Po" ose "Jo"

23 përgjigjen.

24 Z. REES: [Përkthim] Mbase, në qoftë se ka ndonjë citim

25 konkret që dëshiron ta përmend, atëherë do të na ndihmonte me



1 shumë që të ecnim.

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të bëj pyetjen dhe pastaj do  
3 të citoj konkretisht, kur të vijë nevoja.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Gucati,  
5 do ju bëj një pyetje, ju lutem përgjigjuni me "Po" ose "Jo",  
6 nëse është e mundur. E kuptoni?

7 I AKUZUARI GUCATI: Unë edhe mund të heshti krejt, s'flas  
8 hiç. Përgjigja ime e thashë dhe nuk -- ne këtë temë nuk hyj  
9 ma. Nuk jam sigurim i dokumentacionit të juve. Unë e thashë,  
10 sa herë të ketë nevojë, unë do dal para mediave. Nuk jam  
11 sigurim i dokumentacionit të juve. Nëse doni, unë mujt me  
12 hesht krejt edhe mos me fol hiç fare.

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]  
14 Py. Z. Gucati, është një pyetje shumë e thjeshtë, kërkon një  
15 përgjigje shumë të thjeshtë. Midis datave 7 dhe 22 shtator, a  
16 i thatë ju në mënyrë publike medias se do të publikoni çdo  
17 material që do dorëzohej ne OVL UÇK? Po apo jo, e keni thënë?  
18 Pë. S'kam përgjigje për këtë d.m.th., unë jam përgjigj një  
19 herë.

20 Py. Nuk ju kujtohet të keni bërë një deklaratë të tillë për  
21 median?

22 Pë. Shumë jam i vetëdijsëm, unë e mbaj mend kur kam dezertu  
23 edhe datën nga ushtri jugosllave, me 28 korrik dhe nuk po e  
24 mbaj mend mrena një viti çfarë kam thënë. Unë t'u përgjigja...

25 Py. Nuk po ju pyes për datën kur dezertuat ushtrinë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Gucati,  
2 ju lutem. Z. Gucati, nuk po i përgjigjeni pyetjes.

3 I AKUZUARI GUCATI: Jo, jo. I jam përgjigj.

4 Z. REES: [Përkthim] Pyetja ka ndryshuar. Pyetja ndryshoi.  
5 Pyetja e parë ishte, a u bënë publike.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pyetja  
7 është pyetje me vlere dhe duhet t'i përgjigjet. Është pyetje e  
8 vlefshme.

9 Z. REES: [Përkthim] Pyetja e parë ishte, a u bë publik  
10 dhe pyetja e dytë ishte, a u publikuan. Mbase mënyra më e  
11 shpejtë është që zonja Bolici të citojë konkretisht që ai ta  
12 shohë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees,  
14 është radha e saj për të bërë pyetjet dhe ajo mund të bëjë  
15 pyetjet, kështu që klienti mund t'i përgjigjet me "Po" ose  
16 "Jo".

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]  
18 Py. Z. Gucati, midis shtatës 7 dhe 22 shtator, brenda këtij  
19 afati kohor, a keni bërë ju deklarata publike për shtypin të  
20 cilit i keni thënë se do të vazhdonit të publikonit, botonit,  
21 çdo material që do t'i dorëzohej OVL UÇK-së, po apo jo?  
22 Pë. Të nderuar, unë kam bo publike në të gjitha mediat  
23 televizive. Kam fol një herë dhe nuk e di sa herë duhet ta  
24 kthej ty përgjigjen, nuk i ruaj dokumentacionet askujt. Kush  
25 mi bjen në zyrë dokumentacionin, unë do ta bëj publike. Se

1 s'do ta le vetë fajtor. Kjo është...

2 Py. Z. Gucati, pra e keni thënë midis datës 7 dhe 22, është e  
3 saktë që e keni thënë?

4 Pë. Unë tregova njëherë, nuk di çka të tregoj më shumë.

5 Py. A është përgjigja jua, "Po"?

6 Pë. Tregova njëherë, nuk kam çka të tregoj ma shumë. Insisto  
7 sa herë të duash, s'është problem.

8 Py. Z. Gucati, kërkoj të jepni një përgjigje, s'mund ta  
9 shmangni. A është përgjigja jua "Po" apo "Jo"?

10 Pë. Shumë më vjen keq, po mendon se jam tuj u frigu. Jo.

11 Thashë s'jam tuj u frigu prej as punës time çka kam bo. Unë e  
12 thashë, çdo dokumentacion që vjen në zyrën time, në dëm të  
13 vendit tim, unë do ta bëj publike.

14 Py. Faleminderit. Dhe e keni thënë edhe këtë midis datave 7  
15 dhe 22 shtator. Midis datës 7 dhe 22 shtator, ju dhe Nasim  
16 Haradinaj, a inkurajuat publikisht personin që solli  
17 dokumentet t'ju sillte edhe më shumë dokumente? A është e  
18 vërtetë kjo?

19 Pë. Nuk është e vërtetë, se unë nuk e njoh personin ma së  
20 pari dhe nuk ka shans teorike që unë ta inspiroj dikën që të  
21 më sjellë dokumentacione dhe të hyj unë në burg. Unë -- kjo  
22 logjika nuk ta rrok, si ti thuash njërit, "Mi bien ti  
23 dokumentacionet, të hyjë unë në burg". Tregoma ti mua këtë  
24 logjikë. Qysh i them unë njërit, "Bjermë letra dhe të shkoj e  
25 të rri unë në burg të Gjykatës Speciale të Hagës". S'është e

1 vërtetë kjo, shumë e pa vërtetë. Nuk qëndron fare, hiç.

2 Py. Pra, ju nuk e bëtë një ftese të tillë përmes deklaratave  
3 publike me mediat, apo jo?

4 Pë. Kurrë në jetën time, kurrë në jetën time s'i kam thënë  
5 personit në fjale, që as nuk e njoh, as në ëndërr s'e kam pa,  
6 që t'i them, "Sillmë dokumentacione nga Gjykata Speciale" dhe  
7 të dal unë t'i bëj publike. S'është e vërtetë kjo, s'qëndron  
8 fare, s'qëndron kjo. Gjejma dikun nëse ke fakte, argumentoma  
9 mua dhe Gjyqtarëve të nderuar këtu që të me del përpara.

10 Py. Këtu i kemi. I referohem konferencës së tretë për shtyp,  
11 për të marrë dhe shembullin e parë.

12 Kjo është prova materiale P0035, faqja 2 e transkriptit.

13 Në këtë rast Nasim Haradinaj ka thënë përballë kamerave,  
14 me ju ulur në krah të tij:

15 "La një mesazh ku tha që tani e tutje do sillte CD dhe ne  
16 e mirëpresim sërish edhe nëse sjell CD-të".

17 A ju kujtohen këto rrethana, z. Gucati?

18 Pë. Shumë më vjen keq që s'e kam dëgju Nasir Haradinaj duke  
19 thënë këto kështu. Edhe, Nasimi është Nasim, Hysnia është  
20 Hysni. As unë, as Nasimi s'i kemi thënë zotnisë, të  
21 inkurajojmë atë që të na bjeri neve dokumentacione apo CD. Nuk  
22 është e vërtetë që unë i kam thënë atij zotnisë, "Të lutem  
23 bjerme materiale". Nuk është e vërtetë, kjo nuk qëndron fare.  
24 Qe unë i kam thënë atij, "Te lutem bjerme dokumentacione dhe  
25 CD".

1 Py. Nuk dëgjuat Nasim Haradinaj t'i përmendte këto fjale,  
2 ndërkohë që ishte ulur pranë jush në konferencën për shtyp?  
3 Këtë po thoni, nuk e keni dëgjuar kur i tha Nasim Haradinaj  
4 këto?

5 Pë. Me singeritetin ma të lartë po të them, se nuk kam nevojë  
6 të gënjej se jam babi i 8 fëmijëve dhe jam gjysh i 10 nipër  
7 dhe mbesa. Po të them me singeritetin ma të madh, nuk e kam  
8 dëgju unë Nasim Haradinaj duke thënë këtë fjalë. Se nuk ka  
9 nevojë Nasimi të gënjen, as Hysniu. Unë, edhe pse isha i  
10 sëmurë ato ditë, nuk ka mundësi që ta kisha dëgjuar.

11 Py. Gjatë të njëjtës konference për shtyp, më 22 shtator, në  
12 një pike bini dakord, pajtoheni me zoti Haradinaj se, nëse  
13 personi që sjell dokumente do të sillte përsëri dokumente, ju  
14 do t'i vinit një nofkë tjetër dhe do ta quanit këtë person,  
15 "burimi fluturues". Ai i mbani mend ju këto deklaratat përpara  
16 kamerave z. Gucati?

17 Pë. Nëse ka mundësi, pyetjen edhe një herë. Nëse ka mundësi.

18 Py. Gjatë konferencës së tretë për shtyp, Nasim Haradinaj tha  
19 më pas në vijim, "Premtimi i tij ishte" - i përmendem provës  
20 materiale P35 faqja 8.

21 "Premtimi i tij se do të sillte CD. Ne do t'ia ndryshojmë  
22 nofkën këtij personi, i nderuar kryetar nëse jeni dakord. Nëse  
23 sjell CD, do ta quajmë ndryshe, do të vendosim një pseudonim  
24 tjetër. A jeni dakord ju?".

25 Pë. Hera e parë që e dëgjoj. Ka mundësi që të ketë thanë

1 Hysniu apo dikush tjetër, apo Nasimi. Por unë me sa di, unë as  
2 i kam përmend ato "pjata fluturuese", asnjë emision, asnjë  
3 televizion. Si Hysni po flas gjithmonë. Por as Nasimin s'e kam  
4 dëgju. Nuk guxoj tash që këtu të rrëfhem para juve që të them  
5 -- veç a po të jem stoik të them se "po" kjo. Por gjithmonë  
6 them, zotnia ka thanë se do të sjelli CD. Por që kemi thanë  
7 ne, pjata fluturuese, kjo diçka s'është t'u ma marrë truri.  
8 Nuk më kujtohet ma, s'më kujtohet si rast, s'më kujtohet.

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja t'ju tregoj, nëse  
10 është e mundur, videon P0035 edhe koha 00:19:04 deri në  
11 00:19:40. Këtë ftesë ia drejtoj Sekretares së Gjykatës, nëse  
12 është e mundur.

13 [Luhet videoincizimi]

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ndërkohë që përgatitet videoja,  
15 kam dy pyetje të tjera për z. Gucati.

16 Py. Në të njëjtin rast, në të njëjtën ditë, pak minuta më  
17 pas, z. Haradinaj tha para kamerave:

18 "Një si kjo është e mirëpritur, pra është i mirëpritur.  
19 Po ju them, ne nuk do ia nxjerrim identitetin edhe nëse vjen  
20 pa maskë, pa vënë maskë".

21 Dhe ju iu përgjigjët:

22 "Jo, nuk është detyrimi ynë".

23 E mbani mend këtë bisedë që bëtë në konferencën e tretë  
24 për shtyp z. Gucati?

25 Pë. Nëse ka mundësi të më tregosh çka kam thënë "Jo, s'është

1 detyrimi im", për cilin fakt e ke fjalën që unë kam thënë,  
2 "S'është detyrimi ynë", nuk jam tuj e kuptu. Për çka kam thanë  
3 unë, "S'është detyrimi im".

4 Py. Përsëris. Gjatë konferencës së tretë për shtyp, Nasim  
5 Haradinaj duke iu referuar personit që kishte sjellë  
6 dokumentet tek OVL UÇK-ja tha fjalët:

7 "Një si kjo është e mirëpritur. Ai është i mirëpritur. Po  
8 jua them nuk do ia nxjerrim identitetin edhe nëse vjen pa  
9 mbajtur maske".

10 Dhe ju ndërhytë dhe thatë:

11 "Nuk është detyrimi ynë".

12 E mbani mend këtë bisedë, e mban mend që ta keni thënë  
13 këtë?

14 Z. REES: [Përkthim] Kjo nuk është lojë kujtese, nuk po  
15 bëjmë testim për kujtesën. Në qofte se zonja Bolici ka  
16 referencën, mbase thjesht mund ta vendosi ta shohim.

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do doja që dëshmitari t'i  
18 përgjigjej pyetjes.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Gucati,  
20 a mund t'i përgjigjesh pyetjes?

21 I AKUZUARI GUCATI: Ato që thua ti që ka thënë Nasimi,  
22 unë nuk ë -- shumë afër e kam Nasimin. Ka mujt mos me u kuptu.  
23 A pse s'është në domenin tonë ta zbulojmë njeriun, janë  
24 policia që paguhen more, prej taksave të qytetareve për me  
25 zbulu kush e ka pru dokumentacionin. Jeni ju hetuesit e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hysni Gucati (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 112

1 Gjykatës Speciale, s'jemi ne hetues. Unë po ta kisha dit  
2 personin, unë e kam bo ftesë publike në televizionet publike  
3 në Kosovë dhe private, "ejani të nxëm personin kush po i sjell  
4 dokumentacionin". Kjo ka qene. Edhe do ta shihni ku i kemi  
5 transkriptet, do t'i lëshojmë edhe ne. Kjo ashte përgjigja  
6 ime.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

8 Py. Ju dhe Nasim Haradinaj, e thatë apo s'e thatë para  
9 kamerave se, ky person do ishte gjithmonë i mirëpritur? A e  
10 keni thënë këtë?

11 Pë. Unë s'e besoj. Mund të jetë, por unë nuk e besoj. Me  
12 singëritetin ma [e padëgjueshme] nuk e besoj. Po mund të jetë.  
13 Edhe pse, edhe nëse është, kurrëgjë s'ka të keqe, se ne kemi  
14 dasht të dali një punë në shesh, të vërtetohet një send që,  
15 jeni duke bashkëpunuar me kriminelë serbë.

16 Py. Ju dhe z. Haradinaj, a thatë se personi që sillte  
17 dokumente tek OVL UÇK-ja ishte njësoj si t'ju sillte dikush  
18 bakllava? A keni thënë diçka të tillë?

19 Pë. Më vjen shumë keq. Në jetën time s'e kam përmend këtë  
20 fjalë. Kam dëshirë të shohin Gjyqtarët nëse i keni incizimin  
21 nëse kam thanë unë kështu, të shoh. Të shohin Gjyqtarët.

22 Py. Po, tani. Në qoftë se është gati, do ta shikojmë.

23 Pë. Nëse unë e kam thanë kështu që bakllava -- atëherë mbaj  
24 përgjegjësi unë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem



1 përsëriteni.

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në qoftë se është videoja gati,  
3 do ju lutesha ta nxirrnim në ekran që ta shohë dhe Trupi  
4 Gjykues transkriptin e konferencës së tretë për shtyp, që  
5 është P0035-ET.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A është  
7 publike kjo?

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kjo faqja është publike, por ne  
9 mund të përdorim versionin e redaktuar. Jo, nuk ka informacion  
10 konfidencial në pjesën që duam të tregojmë.

11 Faqja 8.

12 [Luhet videoincizimi]

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

14 Py. Ju kujtohet z. Gucati që keni diskutuar me z. Haradinaj  
15 këto para kamerave? Që, për herën tjetër që do ju sillte  
16 personi do e thërrisnit, "pjata fluturuese"?

17 Pë. Nëse e dëgjova mirë, e dëgjove zërin tim? Që unë kam fol?

18 Nëse më dëgjove me vëmendje, a kam fol apo veç kam qesh.

19 Këtë s'mundet të ma veshni mua. As kurrkujna, as Nasimit. Nëse  
20 unë kam fol, unë jam duke qeshur këtu.

21 Py. Vetëm Nasim Haradinaj duhet fajësuar për këtë? Ju po  
22 qeshni pranë tij, ju nuk e ndani deklaratën, nuk bashkoheni me  
23 deklaratën e Nasim Haradinajt?

24 Pë. Jo që unë dua ta lë fajtor Nasim Haradinaj, asnjë

25 milimetër Nasim Haradinaj s'është fajtor aspak. Pse Nasim

1 Haradinaj ka propozu për një pseudonim, një emër [e  
2 padëgjueshme] do të thotë fajtor qenka njeriu. Edhe mua mund  
3 të ma jap dikush një pseudonim.

4 Py. Z. Gucati, a e dëgjuat ju Nasim Haradinaj që tha ato që  
5 sapo ua tregova, a e dëgjuat?

6 Pë. Ti ne fillim the, "Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj e  
7 kanë thanë, 'do t'ia ngjisim pseudonimin pjata fluturuese'".  
8 Unë të thashë qe, s'kam thanë për pjata fluturuese fare.  
9 Thashë, ti qysh ke thanë në fillim. Tashti, se don t'i bësh  
10 kontekst dy pyetje dhe të mi ndërrosh pyetjet, është diçka  
11 tjetër. Unë thashë, nuk është diçka e madhe pse ka thanë, do  
12 t'ia ngjisim pseudonimin "pjata fluturuese". Çfarë do të ketë  
13 kjo problem.

14 Py. Ju e pranoni se gjatë kësaj konference për shtyp, kjo  
15 ndodhi. E pranoni pra që video është e saktë, që Nasim  
16 Haradinaj ju propozoi këtë pseudonimin dhe ju qeshët. A është  
17 e saktë?

18 Pë. Nëse ju mendoni se unë është dash aty me qajt si fëmija,  
19 për gabimet që kanë dalë dhe kanë ardh dokumentacionet atje  
20 dhe zotnia sjell CD, atë nuk e pranoj në jetën time kurrë këtë  
21 vepër, as këtë pune. Unë qesha për arsye se neve na ka befasu  
22 qysh doli ky dokumentacion apo CD nga Gjykata juve dhe na vjen  
23 ne Prishtinë.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja tani t'ju tregoj  
25 pjesën e videos që ka 00:21:28 deri në 00:21:42.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Para se të  
2 shkoni tek kjo pjesë, z. Cadman ka një pyetje.

3 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit.  
4 Ndjesë për ndërhyrjen, por ne nga larg nuk e shikojmë dot  
5 videon edhe nuk i shohim dot provat materiale. Kështu që kjo e  
6 komplikon më tej procedurën.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
8 Faleminderit z. Cadman. Besoj se keni transkriptin apo jo?

9 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo, nuk e  
10 kemi. Unë mbështetem tek transkripti, sigurisht që kemi  
11 transkriptin e videos, por ndërkohë që luhet video në Gjykatë  
12 si pjesë e procedurave për të marrë pjesë në -- edhe ekipi  
13 jonë duhet të jete në gjendje që ta shikojë këtë video.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
15 Faleminderit z. Cadman.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Thjeshtë dua të përmend që të  
17 gjitha videot janë ndarë, janë nxjerrë nga Prokuroria.

18 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Kjo nuk ishte  
19 pika që unë ngrita, i nderuar. Sigurisht që janë nxjerrë. Por  
20 nëse duam të marrim pjesë në procedura në mënyrë efektive,  
21 duhet të marrim pjesë në procedura.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman  
23 një moment.

24 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Çdo  
25 kundërshtim që bëj, nuk është se është i lehtë për mua, i

1 nderuar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,  
3 do jua dërgojmë. Ju këshillojmë që videot të dërgohen tek ju  
4 në mënyrë që ta shihni.

5 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit  
6 i nderuar.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më falni,  
8 atëherë mund ta shihni tani?

9 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po mund ta  
10 shoh tani. Po, mund ta shoh tani, po.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të doja t'i tregoja të  
12 akuzuarit përveç videos nga momenti 00:21:28 deri 00:21:42, do  
13 ti tregoja një pjesë të kësaj videos. Tek faqja 8, mbetemi tek  
14 faqja 8.

15 [Luhet videoincizimi]

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

17 Py. Z. Gucati, e dëgjuat z. Haradinaj që tha se, "Një si kjo  
18 është gjithmonë e mikpritur" dhe "nuk do ia nxjerr identitetin  
19 edhe sikur të vij pa maskë"? A e dëgjove?

20 Pë. Po, e dëgjova.

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për Trupin Gjykses, referenca  
22 është faqja 10 e transkriptit në gjuhën angleze.

23 Py. A ju përgjigjët se, nuk është detyrimi juaj --. Asaj që  
24 tha z. Haradinaj, iu përgjigjët ju gjatë konferencës për shtyp  
25 se, "Ky nuk është detyrimi juaj"?

1 Pë. Shumë është reale që unë e përkraha Nasimin në atë  
2 drejtim dhe e përkrah që "nuk është detyrim i yni t'i ruajmë  
3 hajnat nga vjedhin nëpër vende të ndryshme".

4 Py. Pra jeni, pajtoheni zoti Gucati se ju dhe Nasim Haradinaj  
5 e inkurajuat në fakt personin që solli dokumentet, të sillte  
6 më shume dokumente tek OVL UÇK-ja, apo jo?

7 Pë. Jo, jo, jo. S'është e vërtetë që ne e kemi inkuraju  
8 zotninë me na pru dokumentacione dhe me na bo një problem.  
9 S'është e vërtetë. Unë përkundrazi kam thënë, me mujt me e dit  
10 kush është, pse me na bo ne telash me na nxjerr probleme. Dhe  
11 unë që prej 15 muajsh jam këtu në burg dhe kjo nuk do të thotë  
12 që unë dhe Nasim Haradinaj atij i kemi thanë, "Shko ti vjedhi  
13 dokumentet në Holandë dhe bjerna neve në Prishtinë". Faktoma  
14 ti mua këtë punë që është e vërtetë, unë do jem pjesë e fajit,  
15 që unë dhe Nasim Haradinaj i kemi thanë zotnisë në fjalë,  
16 "Shko vjedhi dokumentet dhe bjemi mua në Organizatën e  
17 Veteraneve". S'është e vërtetë fare.

18 Py. Dhe kur ju dhe Nasim Haradinaj në mënyrë publike thatë  
19 para kamerave se, "Një si kjo është gjithmonë e mirëpritur". A  
20 deshët ju atëherë ta shkurajonit, ta dekurajonit që të sillte  
21 materiale të mëtejshme tek OVK UÇK-ja?

22 Pë. Po s'kisha nevojë unë atë zotninë të inkurajoj që të  
23 bien, ai i binte vetë pa i thanë kurrkush hiç. I ka pru herën  
24 e parë, herën e dytë dhe herën e tretë. Çfarë arsye kisha unë  
25 t'i thosha atij, bjer. Kur ai i ka pru pa me pyet mua fare, pa

1 e pyet Nasimin, pa pyet kurrkund. Pa ju pyet juve. Çfarë arsye  
2 kishim na. Tregoma arsyen ti mua, unë do të përgjigjja.

3 Py. Z. Gucati, ju a vazhduat të përsërisnit edhe pas  
4 konferencës së tretë për shtyp se, do të publikonit materiale  
5 që ky i panjohur do të sillte tek OVL UÇK-ja? A e keni  
6 përsëritur pra?

7 Pë. Me cilën datë, se unë me 25 jam burgos. Mbas konferencës  
8 se tretë. Cilën datë, cilën orë, cilën ditë, ju lutem.

9 Py. Pas konferencës se tretë për shtyp, a vazhduat ju të  
10 thonit publikisht para medias, para kamerave se do i  
11 mirëprisnit materiale të vinin, të silleshin tek OVL UÇK-ja?

12 Pë. Nuk po e di për cilën kohë je duke folur. Pas konferencës  
13 mund të jetë nesër, mbas nesër, mund të jetë mbas 5 orësh, 6  
14 orësh. Të lutem, nëse ke video na tregon orën e saktë dhe  
15 ditën e saktë. Atëherë mua më kujtohet kur kam fol. Se unë kam  
16 dhanë shumë intervista, kam qenë në shume takime, kam qenë në  
17 shume debate televizive. Kështu që është mirë me ma tregu.

18 Py. Z. Gucati, a e pranoni ju mundësinë se, ditët pas 22  
19 shtatorit dhe para arrestimit tuaj, ju vazhdonit të thonit  
20 para kamerave se do të mirëprisnit materiale të tilla, pra nga  
21 personi që solli materialet, dokumentet tek OVL UÇK-ja?

22 Pë. Nuk mund ta pranoj pa e pa faktin. Nëse e kam thanë, e  
23 kam thanë. Nëse s'e kam thanë, s'e kam thanë. Është mire ta  
24 dokumentoni nëse e kam thanë. Unë e kam thanë gjithmonë,  
25 zotnia që po bjen dokumentacione ka pru, ne e kemi ba publike

1 në tavolinën tonë në Organizatën e Vetëranëve. Po kam ba edhe  
2 thirrje hetuesve të juaj, ejani dhe zbuloni personin kush po i  
3 bjen. Te dyja kanë qenë. Kam thanë, zotnia po bjen  
4 dokumentacione, ejani zbulojeni. Por ka mundësi që kam thanë,  
5 është i mirëseardhur. Atëherë publikojeni. Ne këtu s'kemi  
6 diçka të fshehur asgjë.

7 Py. Pra e pranoni, e keni thënë?

8 Pë. Nuk jam duke e pranuar, mos ma vesh këtë.

9 Py. I referohem konkretisht një interviste që i keni dhënë  
10 Euronews Albania më 22 shtator dhe i referohem provës  
11 materiale P0029-ET dhe po lexoj faqen 2 të transkriptit. Që  
12 është publik në fakt. Keni thënë:

13 "Po, personi anonim që solli këto dosje në fakt tha se  
14 ditët e ardhshme do të sillte CD të ndryshme me disa materiale  
15 dhe sërish ne do të sillemi njësoj siç u sollëm sot dhe ditët  
16 e kaluara. Do të bëjmë të njëjtën gjë. Do të informojmë  
17 publikun e Kosovës dhe të gjithë shqiptarët në të gjithë botën  
18 kudo që janë. Do ju tregojmë se Dhoma e Specializuar  
19 bashkëpunon me gjykatat serbe, me Gjykatën Supreme serbe,  
20 bashkëpunojnë dhe marrin materiale nga Serbia kundër anëtarëve  
21 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

22 A e pranoni që e keni thënë diçka të tilla?

23 Pë. E thashë edhe sot paradite, e thashë. Te njëjtën fjalë që  
24 jam përpjekur unë sot paradite, që jeni duke bashkëpunuar me  
25 kriminelë serbe dhe me Vukçeviçin që ka qenë kryeprokurori i

1 Gjykatës Speciale për luftën ne Serbi. Dhe Dreçunin.  
2 Py. Pra është e vërtetë. Në fakt z. Gucati midis datës 7 dhe  
3 22 shtator ju vazhduat të thërrisnit, bënit thirrje që në OVL  
4 UÇK të vinin materiale të reja dhe keni inkurajuar që të  
5 sillnit materiale të tilla.  
6 Pë. Asnjë moment, asnjë sekondë s'kam bo thirrje personit në  
7 fjalë që të bjen dokumentacione në Organizatën e Veteraneve të  
8 Luftës. Të lutem, asnjë moment, asnjë sekondë nuk kam bo  
9 thirrje, "zotëri bjermë dokumente në organizate". Nuk kam  
10 thanë këtë fjale në jetën time. As unë, As Nasim Haradinaj,  
11 asnjë njeri në Organizatën e Veteraneve.  
12 Py. Z. Gucati, a është pozicioni juaj që të vazhdosh e të  
13 deklarosh këtë gjë, pavarësisht videove që sapo ju shfaqem  
14 sot?

15 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kundërshtoj. E  
16 kam thënë edhe me përpara, ky nuk është test kujtese. Në qoftë  
17 se ka pjesë të posaçme të regjistrimeve, atëherë zonja Bolici  
18 duhet që t'i shfaqë ato dhe t'i shohim të gjithë.

19 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A dëgjoni  
21 z. Gucati? Dëgjoni?

22 I AKUZUARI GUCATI: Shumë pak e kam dëgju para 2 minutash.  
23 Sa ishte tuj fol Prokurorja, shumë pak e dëgjova pyetjen.  
24 Përkthimi ka qenë shumë me zë të ulet, ka qenë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë,



1 mendoj që do përfitojmë nga ky moment edhe do ta përbyllim  
2 sot. Ka shkuar thuhetse ora 4.

3 Kështu që, z. Cadman shikoj që ka ngritur dorën. E di që  
4 z. Cadman nuk po ndihet mirë, kështu që z. Cadman merreni  
5 fjalën.

6 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Së pari, sapo  
7 kontrollova temperaturën dhe temperatura më ka shkruar 39  
8 gradë. Megjithatë, dua që të përfaqësoj në mënyrë sa më të  
9 denjë z. Haradinaj. Dua t'ju them që provat materiale nuk i  
10 kemi parë fare, nuk kemi pasur fare qasje dhe në qoftë se do  
11 të vazhdojmë si normal nesër, atëherë do të duhej që këto  
12 dokumente të na vihen ne dispozicion.

13 Nuk dua të ankojem gjatë gjithë kohës, por dua që këto  
14 dokumente të na vihen ne dispozicion.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]  
16 Faleminderit z. Cadman. Do të bëjmë më të mirën e mundshme.

17 Z. Haradinaj, a më dëgjon? Më ndjek z. Haradinaj?

18 I AKUZUARI HARADINAJ: [Përmes video lidhjes] Po, ju  
19 dëgjoj mirë fort.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E kuptoj  
21 që pavarësisht që keni mundësi që të vini nga pikëpamja  
22 mjekësore nesër këtu në seancën e gjyqit, ju preferoni që të  
23 qëndroni aty ku jeni dhe të na ndiqni përmes videolinkut?

24 I AKUZUARI HARADINAJ: [Përmes video lidhjes] Unë mendoj  
25 që për hir të të tjerëve që të mos bëjnë me rrezik edhe ne sa

1 të pushojmë, mbas nesër do të jem atje prezent. Vetëm për këtë  
2 hir, përndryshe. Thashë të mos i rrezikoj të tjerët. Kështu që  
3 mbas nesër do të jem atje.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,  
5 a jeni dakord me qëndrimin e zotit Haradinaj?

6 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E diskutuam  
7 shkurtimisht këtë pozicion pak më parë, pra z. Haradinaj e tha  
8 dhe vetë që nuk do që të vendosi në rrezik asnjë person tjetër  
9 dhe sa i takon procedurave mendoj që vendimi është goxha i  
10 rëndësishëm, d.m.th. pjesa e virusit është goxha e ndjeshme.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Domethënë  
12 po pyes thjesht nëse jeni dakord me pozicionin e zotit  
13 Haradinaj.

14 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po ju zoti  
16 Haradinaj?

17 I AKUZUARI HARADINAJ: [Përmes video lidhjes] Ta kem një  
18 konsultë tash besoj siç na u premtu në Zoom, se s'pata mundësi  
19 dhe ne na u desh me fol në një gjuhë tjetër me z. Cadman që ai  
20 nuk e kupton mirë, në gjuhën kroate, kështu që mbas diskutimit  
21 tonë që do ta bëjmë tash ne në Zoom, ne do të marrim vendim të  
22 saktë për procedurën e radhës. Mendimi im personal është  
23 njëherë për herë kështu.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dhe  
25 ndoshta mund të përdorni dokumente të shkruara për të përdorur

1 nesër, në qofte se vendimi është i ndryshëm. Jemi dakord zoti

2 Cadman, është ne rregull ky si pozicion?

3 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, ne

4 rregull zoti Kryetar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

6 Faleminderit.

7 Do ta mbyllim këtu sot. Nesër do ta fillojmë sërish në

8 orën 9.30.

9 Z. Gucati, ju kujtojmë se nuk duhet ta diskutoni

10 përmbajtjen e dëshmisë tuaj me askënd. Mund të flisni

11 sigurisht për çështje të tjera, por jo për detajet e kësaj

12 dëshmie.

13 Ju falënderojmë që ishit me ne sot të pranishëm në sallën

14 e gjyqit. Falënderojmë gjithashtu edhe përkthyesit dhe stafin

15 e Gjykatës. Do shihemi të gjithë nesër.

16 --- Seanca mbyllet në orën 16.03

17

18

19

20

21

22

23

24

25